



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**Qeveria –Vlada – Government**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije  
Ministry of Education Science & Technology

# **KURRIKULA BËRTHAMË**

**E ARSIMIT TË MESËM  
TË ULËT TË KOSOVËS**

**(Klasa VI, VII, VIII dhe IX)  
(E RISHIKUAR)**

gusht 2016



## MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

### **Këshilli redaktues:**

Kabineti i Ministrit, MASHT

Departamenti për zhvillimin e arsimit parauniversitar, MASHT

Divizionit për planprograme dhe tekste shkollore, MASHT

### **Redaktor gjuhësor:**

Sabit Jaha

### **Radhitja:**

Gëzim Duzha

### **Ballina:**

Gëzim Duzha

### **Shtypshkronja:**

"BLENDI"



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

---

Prishtinë, më 25 tetor 2016

Ref. Nr: 232/01 B


Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të rregullorës nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave (Gazeta Zyrtare, Nr. 1,18 prill 2001), nenit 5 dhe 24 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, merr këtë:

## V E N D I M

1. APROVOHET rishikimi i Kurrikulës Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (Klasa VI, VII, VIII dhe IX), të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, sipas vendimit nr. ref. 51/01B të datës 10 mars 2016, për rishikimin dhe finalizimin e dokumenteve kurrikulare.
2. Obligohet Departamenti për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar dhe të gjitha Divizionet e MASHT-it që janë të përfshira në këtë proces duhet t'i kontribuojnë zbatimit të kurrikulës së re.
3. Të gjitha Drejtoritë Komunale për Arsim dhe të gjitha shkollat e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës i fillojnë përgatitjet për fillimin e zbatimit të kurrikulës së re. Përgatitjet duhet të përfshijnë:
  - 3.1. Informimin dhe sensibilizimin e komunitetit arsimor të shkollës me kurrikulën e re;
  - 3.2. Riorganizimin e organeve profesionale të shkollës;
  - 3.3. Përcaktimin e mësimeve që do të punojnë në klasat ku fillon zbatimi i kurrikulës së re;

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



- 3.4. Përgatitjen e planeve specifike për përmbushjen e detyrimeve dhe autonomisë së shkollës në zbatimin e kurrikulës së re.
4. Shfuqizohet vendimi Nr. 291/01B, datë 22.10.2012.
5. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

## Arsyetim

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë dhe pas realizimit dhe zbatimit të vendimit nr. ref. 51/OB të datës 10 mars 2016, për rishikimin dhe finalizimin e dokumenteve, i cili proces ka qenë rezultat i analizës dhe vlerësimit të zbatimit të kurrikulës nga koordinorët e MASHT-it për kurrikula, nga inspektorët e arsimit, nga koordinorët e DKA-ve për kurrikula, nga koordinorët e shkollave, nga prindërit, nga trajnerët, nga bashkëpunimi me Institutin e Zhvillimit të Arsimit të Republikës së Shqipërisë, nga Projekti i Binjakëzimit, nga projekti i mbështetur nga GIZ, nga projekti BEP i mbështetur nga USAID dhe partnerë të tjerë zhvillimor, nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, nga vizitat e bëra në shkollat pilotuese, raportit të propozimeve për ndryshime kurrikulare, si dhe raportit mbi procesin e rishikimit dhe finalizimit të dokumenteve kurrikulare, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. dr. Arsim BAJRAMI, ministër



### Iu dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm, MASHT;
- Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
- Departamentit për Politikën e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
- Departamentit të Inspektimit të Arsimit, MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Arsimin Parauniversitar, MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve, MASHT;
- Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve, MASHT;
- Divizionit për Planprograme dhe Tekste Shkollore, MASHT;
- Institutit Pedagogjik të Kosovës;
- Të gjitha Drejtorive Komunale për Arsim;
- Arkivit, MASHT.



# **KURRIKULA BËRTHAMË**

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## SHKURTESAT

|  |    |
|--|----|
| I. HYRJE   | 11 |
| 1. Rëndësia e Kurrikulës Bërthamë                              | 12 |
| 2. Struktura e Arsimit Parauniversitar                         | 12 |
| 3. Qëllimet e Arsimit Parauniversitar                          | 14 |
| 4. Parimet e Arsimit Parauniversitar                           | 14 |
| 5. Çështjet e përbashkëta të Kurrikulave Bërthamë              | 14 |
| II. VEÇORITË E KURRIKULËS BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT | 16 |
| 1. Strukturimi i arsimit të mesëm të ulët                      | 17 |
| 1.1. Veçoritë e arsimit të mesëm të ulët                       | 17 |
| 2. Shkallët kryesore të Kurrikulës                             | 17 |
| 2.1. Përshkrimi i shkallëve të Kurrikulës                      | 18 |
| 3. Kompetencat kryesore e të nxëniet                           | 18 |
| 3.1. Rezultatet e të nxëniet për kompetenca për shkallë        | 20 |
| 3.2. Rezultatet e të nxëniet për shkallë 3                     | 20 |
| 3.3. Rezultatet e të nxëniet për shkallë 4                     | 23 |
| III. FUSHAT E KURRIKULËS                                       | 28 |
| 1. Fushat e kurrikulës - funksioni dhe organizimim i tyre      | 29 |
| 2. Gjuhët dhe komunikimi                                       | 30 |
| 3. Artet   | 36 |
| 4. Matematika  | 46 |
| 5. Shkencat e natyrës  | 55 |
| 6. Shoqëria dhe mjedisi  | 65 |
| 7. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti                        | 74 |
| 8. Jeta dhe puna   | 83 |
| 9. Lëndët mësimore dhe elementet e programeve mësimore         | 91 |

# KURRIKULA BËRTHAMË


E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

|   |     |
|---|-----|
| IV. KURRIKULA ME ZGJEDHJE   | 94  |
| 1. Hyrje  | 95  |
| 2. Qëllimi  | 95  |
| 3. Organizimi   | 95  |
| 4. Struktura e kurrikulës me zgjedhje                                   | 96  |
| 5. Procedurat e përzgjedhjes, hartimit dhe miratimit                    | 96  |
| 6. Zbatimi dhe vlerësimi  | 96  |
| V. PLANI MËSIMOR DHE LËNDËT   | 97  |
| 1. Plani mësimor për arsimin parauniversitar                            | 98  |
| 2. Plani mësimor dhe lëndët mësimore për shkollën e mesme të ulët       | 99  |
| 3. Autonomia e shkollës   | 100 |
| VI. METODOLOGJIA E PËRGJITHSHME – UDHËZIME                              | 101 |
| 1. Hyrje  | 102 |
| 2. Mësimdhënia dhe të nxënit me në qendër nxënësin dhe gjithëpërfshirja | 102 |
| 3. Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave        | 103 |
| 4. Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar                                | 104 |
| 5. Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar                              | 105 |
| 6. Çështjet/temat ndërkurrikulare                                       | 106 |
| 7. Veprimtaritë/aktivitetet jashtëkurrikulare                           | 108 |
| VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT                    | 110 |
| 1. Hyrje  | 111 |
| 2. Qëllimi i vlerësimit   | 111 |
| 3. Parimet themelore të vlerësimit                                      | 111 |
| 4. Llojet e vlerësimit të brendshëm dhe të vlerësimi i jashtëm          | 112 |
| 4.1. Llojet e vlerësimit të brendshëm                                   | 112 |
| 4.2. Llojet e vlerësimit të jashtëm                                     | 114 |
| FJALORTHI   | 115 |
| BIBLIOGRAFIA  | 122 |
| Hartuesit dhe kontribuesit në rishikim                                  | 124 |
| Lista e kontaktit   | 125 |




# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## SHKURTESAT

|               |  |
|---------------|--|
| <b>KB</b>     | Kurrikula Bërthamë   |
| <b>KK</b>     | Korniza Kurrikulare  |
| <b>KSNA</b>   | Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit                      |
| <b>MASHT</b>  | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë                   |
| <b>RN</b>     | Rezultatet e të nxënit   |
| <b>RNF</b>    | Rezultatet e të nxënit për fushë                                 |
| <b>RNK</b>    | Rezultatet e të nxënit për kompetenca                            |
| <b>SHK</b>    | Shkalla e Kurrikulës   |
| <b>TIK</b>    | Teknologjia e informimit dhe komunikimit                         |
| <b>UNESCO</b> | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë |




# **KURRIKULA BËRTHAMË**

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## I HYRJE

Rëndësia e Kurrikulës Bërthamë  
Struktura, qëllimet dhe parimet e arsimit parauniversitar  
Çështjet e përbashkëta të kurrikulave bërthamë

### 1. Rëndësia e Kurrikulës Bërthamë

Kurrikula Bërthamë është dokument që e bën të zbatueshme në shkollat e Kosovës Kornizën Kurrikulare, të miratuar nga MASHT-i, në gusht të vitit 2016. Me këtë dokument përcaktohen rezultatet për kompetenca dhe rezultatet e të nxënës për fusha kurrikulare, të shprehura në njohuri faktike dhe procedurale, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që duhet të zhvillohen te nxënësit përgjatë periudhave të caktuara kohore si dhe qasjet, metodologjitë e zbatueshmërisë, monitorimi dhe vlerësimi. Gjithashtu, ky dokument përcakton shpërndarjen kohore (orëve mësimore) për fushat e kurrikules dhe ndërlidhjen mes tyre, të cilat mundësojnë progres në zhvillimin e kompetencave te nxënësit.

*Kurrikula Bërthamë mbështet:*

- **nxënësin** në zhvillimin gradual të tij, në zhvillimin e kompetencave për arsimim tërëjetësor për integrim të lehtë shoqëror duke e përgatitur që të përballë sfidat e jetës;
- **mësimdhënësin** në planifikimin dhe realizimin me sukses të punës me nxënës – të aktiviteteve mësimore në klasë dhe jashtë klase;
- **prindin** në përcjelljen e nivelit të zhvillimit të fëmijës gjatë arritjes së kompetencave, në periudha të caktuara kohore, të shprehura në njohuri, sjellje dhe qëndrime që ata i shpërfaqin në situata të ndryshme jetësore në harmoni me rezultatet e të nxënës për fusha kurrikulare dhe për kompetenca.

### 2. Struktura e arsimit parauniversitar

Nivelet formale të arsimit parauniversitar të Kosovës përputhen me Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit (KSNA), të miratuar nga UNESCO-ja. Dallim ka në strukturën e Kurrikulat Bërthamë të KSNA 1, në kuadër të së cilës hyn klasa përgatitore, edhe pse është pjesë përbërëse e edukimit KSNA 0. Të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar janë ndarë në nën nivele formale me emërtim: - Shkallët kryesore të Kurrikulës, që kanë qëllime e funksione të caktuara dhe janë në funksion të emërtimeve të secilës prej tyre.

Kurrikula bërthamë është hartuar për secilin nivel të arsimit parauniversitar, si:

- Kurrikula Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme (lindje - 5 vjeç);
- Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor;
- **Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët;**
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë-gjimnaze dhe
- Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë-shkollat profesionale).

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS

Tabela: STRUKTURA E ARSIMIT E KOSOVËS

| Nivelet sipas KSNA |   | Nivelet formale të arsimit parauniversitar të Kosovës   | Shkallët e kurrikulës  | Kurrikula bërthamë  |
|--------------------|---|---|--|---|
|                    |   | Arsimimi i të rriturve/<br>Arsimimi gjatë tërë jetës në shkallë të gjerë (formal dhe joformal)  |  |   |
| KSNA 6             |   | Arsimi pasuniversitar   |  |   |
| KSNA 5             |   | Arsimi universitar  |  |   |
| KSNA 4             | <b>Niveli 5</b> Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve | Arsimi passekondar jouniversitar  |  |   |
| KSNA 3             | <b>Niveli 4</b> Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve       | <b>Arsimi i mesëm i lartë-</b><br>Arsimi dhe aftësimi profesional<br>Gjimnazet klasa X-XII<br>Shkollat profesionale (klasat X-XII)<br>Matura shtetërore | Shkalla 6:<br><b>Konsolidim dhe specializim-</b> klasa XI  | <b>Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë - gjimnaze</b>   |
|                    | <b>Niveli 3</b> Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve       | <b>Arsimi i mesëm i lartë-<br/>Arsimi dhe aftësimi profesional</b><br>Shkollat profesionale (klasat X-XI)   | Shkalla 5:<br><b>Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional</b> – klasat X, XI   | <b>Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë -<br/>Arsimi dhe aftësimi profesional/<br/>Shkollat profesionale</b> |
| KSNA 2             |   | <b>Arsimi i mesëm i ulët</b><br>Klasat VI-IX  | Shkalla 4:<br><b>Përforcim dhe orientim-</b> klasat VIII, IX<br>Shkalla 3:<br><b>Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim</b> –klasat VI, VII | <b>Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët</b>   |
| KSNA 1             |   | <b>Arsimi fillor</b><br>Klasat I-V  | Shkalla 2:<br><b>Përforcim dhe zhvillim-</b> klasat III-V<br><br>Shkalla 1   | <b>Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor</b>   |
| KSNA 0             |   | <b>Klasa përgatitore</b>  | <b>Përvetësim themelor-</b> klasa përgatitore, klasat I dhe II   |   |
|                    |   | <b>Edukimi parashkollor</b>   | Shkalla përgatitore e Kurrikulës:<br>Edukimi në fëmijërinë e hershme   | <b>Kurrikula Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme</b>  |

### 3. Qëllimet e Arsimit Parauniversitar

Të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar mbështesin nxënësit të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në harmoni me kërkesat/nevojat e shoqërisë demokratike, duke:

- kultivuar identitetin personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore;
- promovuar vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvilluar përgjegjësinë ndaj vetvetes, shoqërisë dhe mjedisit;
- aftësuar për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësuar për ndërmarrësi dhe për përdorim/shfrytëzim të teknologjisë;
- aftësuar për mësim gjatë gjithë jetës.

Më gjerësisht për qëllimet e arsimit parauniversitar, shih Kornizën kurrikulare.

### 4. Parimet e Arsimit Parauniversitar

Kurrikula Bërthamë siguron koherencë dhe qëndrueshmëri mes të niveleve formale të arsimit parauniversitar duke u mbështetur në këto parime:

**Gjithëpërfshirje**, që nënkupton ofrimin e mundësisë për përfshirje dhe qasje të barabartë të të gjithë e fëmijëve dhe të rinjve në arsim cilësor.

**Zhvillim i kompetencave** që reflektohet nëpërmjet rezultateve të nxënimit, që pritet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit.

**Mësimdhënie dhe nxënie të integruar dhe koherente**, që promovon të nxënimit e plotë, duke reflektuar ndërlidhjet dhe ndërvarësinë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me njohuritë dhe informacionin që ka nxënësi për to.

**Autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle**, në zbatimin e Kurrikulës Bërthamë dhe pjesës me zgjedhje, që reflektohen në planifikim, organizim dhe realizim të procesit mësimor dhe aktivitete jashtëkurrikulare.

**Përgjegjësi dhe llogaridhënie**, që reflektohen në krijimin e kulturës për vlerësim të vazhdueshëm të progresit në zbatimin e kërkesave të Kurrikulës përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt një paraqitjeje më të mirë në përmbushjen e kërkesave të Kurrikulës dhe ngritjes së cilësisë së arsimit.


Më gjerësisht për parimet e arsimit parauniversitar, shih Kornizën kurrikulare.

### 5. Çështje të përbashkëta të Kurrikulave Bërthamë

Kurrikula bërthamë të niveleve të arsimit parauniversitar kanë të përbashkët kompetencat kryesore, dhe fushat kurrikulare, siç janë të përcaktuara në KK.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## *Kompetencat kryesore<sup>1</sup>:*

- Kompetenca komunikim dhe të shprehur;
- Kompetenca të menduarit;
- Kompetenca të mësuarit;
- Kompetenca për jetë për punë dhe për mjedis;
- Kompetenca personale;
- Kompetenca qytetare.


## *Fushat e kurrikulës<sup>2</sup>:*

- Gjuhët dhe komunikimi
- Artet
- Matematika
- Shkencat e natyrës
- Shoqëria dhe mjedisi
- Edukata fizike, sportet dhe shëndeti;
- Jeta dhe puna.

Rezultatet e të nxënit për shkallë dhe rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare i bëjnë të dallueshme kompetencat dhe fushat kurrikulare nga secili nivel formal i arsimit dhe shkalle kurrikulare (shih seksionet II dhe III të këtij dokumenti).

<sup>1</sup> Informacione më të zgjeruara për kompetencat kryesore prezantohen në kapitullin e dytë.

<sup>2</sup> Detajet për fusha të kurrikulës ofrohen në kapitullin 3 të këtij dokumenti.



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## II Veçoritë e Kurrikulës Bërthamë arsimi i mesëm i ulët klasa VI - IX

Veçoritë kryesore të Arsimit të Mesëm të Ulët, klasa VI – IX  
Shkallët kryesore të kurrikulës dhe përshkrimi i tyre  
Kompetencat kryesore të të nxënit  
Rezultatet e të nxënit për kompetenca për shkallët 3 dhe 4



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## 1. Struktura e Kurrikulës Bërthamë e arsimit të mesëm të ulët

Kurrikula Bërthamë e arsimit të mesëm të ulët (AMU) përfshin klasat VI-IX, të cilat shtrihen në shkallët kurrikulare 3 dhe 4.

KB është dokument i detyrueshëm, i hartuar në bazë të Kornizës së Kurrikulës, në të cilin bazohen lëndët mësimore, përmbajtja sipas fushave kurrikulare, rezultatet e të nxëniet, mësimi me zgjedhje, ecuria e mësimdhënies, nxënies, metodologjisë dhe vlerësimit.

Tabela e strukturës e nivelit të dytë:

| Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit | Nivelet e sistemit formal të arsimit | Shkallët e Kurrikulës të AMU                                 | Klasat | Mosha |
|---|--------------------------------------|--|--------|-------|
| KSNA 2                                      | Arsimi i mesëm i ulët (klasat VI-IX) | Shkalla 4 e Kurrikulës:<br>Përforsim dhe orientim            | IX     | 14    |
|   |                                      |  | VIII   | 13    |
|   |                                      | Shkalla 3 e Kurrikulës:<br>Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim | VII    | 12    |
|   |                                      |  | VI     | 11    |

### 1.1. Veçoritë e Arsimit të mesëm të ulët

Në arsimimin e mesëm të ulët nxënësve u ofrohet mundësi gjithëpërfshirëse për zhvillimin e aspektit njohës, fizik, personal, social dhe moral. Kërshëria e tyre nxitet e natyrshëm për t'u siguruar që njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e zotëruara janë bazë e qëndrueshme për zhvillim në shkallët e tjera të arsimit.

Qëllimi kryesor i shkallës 3-4 është përgatitja e nxënësit për shkollim të mëtejshëm dhe orientim për karrierë, duke u përkrahur me mentorë/këshilltarë profesionalë.

Ky nivel, po ashtu, nxënësit i ndihmon që t'i zhvillojnë interesat personale dhe i definon pritjet e tyre për të ardhmen në mënyrë sa më të përshtatshme.

Realizimi i procesit mësimor zhvillohet në mënyrë të integruar bazuar në fusha kurrikulare, duke i ndërlidhur me punën dhe jetën e përditshme të fëmijëve, për t'iu mundësuar që ta kuptojnë drejt marrëdhënien e tyre me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu.

## 2. Shkallët kryesore të Kurrikulës Bërthamë e arsimit të mesëm të ulët

Korniza Kurrikulare definon shkallët e Kurrikulës si perioda 1–3 klasë që kanë karakteristika të përbashkëta të zhvillimit psikosocial dhe fizik të nxënësve.

Shkallët Kurrikulare paraqesin pikën referuese të progresit të nxënies, organizimin e aktiviteteve mësimore, qasjen dhe kriteret e vlerësimit për arritjen e kompetencave kryesore sipas KK-së. Shkallët kryesore të KSNA 2 janë dy. Ato janë nënperioda brenda nivelit KSNA 2.

Shkallët kryesore të KSNA 2 paraqesin specifikat e zhvillimit të nxënësve të kësaj moshe, apo

veçoritë të përbashkëta të zhvillimit socio-emocional dhe fizik të tyre.

Kurrikula bërthamë i arsimit të mesëm të ulët, përfshin dy shkallë dhe klasat:

- Shkalla 3, përfshin klasat VI-VII dhe
- Shkalla 4, përfshin klasat VIII-IX.

### 2.1. Përshkrimi i shkallëve kurrikulare të Arsimit të Mesëm të Ulët

Shkallët kurrikulare paraqesin pikat fillestare për përcaktimin e nivelit të kompetencave që duhet zotëruar nxënësit e klasave VI-IX. Ato definojnë kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave mësimore, qasjen dhe kriteret e vlerësimit si dhe institucionin përgjegjës për arritjen e tyre. Për qëllime praktike i kemi ndarë në dy shtylla si në vijim.

**Tabela: Përshkrimi i shkallës**

| Shkalla 3 – Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim (klasa VI dhe VII)  | Shkalla 4 – Përforsim dhe orientim (klasa VIII dhe IX)  |
|---|---|
| <p>Në shkallën 3 ndihmohet thellimi i njohurive nga fushat kurrikulare, duke vendosur bazën fillestare për orientim në karrierë.</p> <p>Nxënësi përgjatë kësaj shkalle aftësohet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të menduarit abstrakt dhe kompleks (p.sh., shkathtësi të larta intelektuale), që është i nevojshëm për ta njohur botën dhe veten si dhe për zgjidhje të problemeve;</li> <li>• kultivimin e interesimit për njohje më të thellë të vetes, të tjerëve dhe të mjedisit natyror e shoqëror;</li> <li>• zhvillimin e shkathtësive për vlerësim dhe vetëvlerësim;</li> <li>• zhvillimin e shkathtësive për komunikim efektiv, përfshirë edhe kodet matematike dhe shkencore;</li> <li>• zgjerimin e shkathtësisë për komunikim verbal dhe në të shkruar në gjuhën amtare, në gjuhën angleze dhe në një gjuhë tjetër të huaj/njërën nga gjuhët zyrtare;</li> <li>• zhvillimin e përgjegjshmërisë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe për mbrojtje aktive të mjedisit.</li> </ul> | <p>Në shkallën 4 nxënësit orientohen për mundësitë e ndryshme të karrierës.</p> <p>Në këtë shkallë ata përgatiten për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shfrytëzimin e burimeve të informacionit dhe për qasje kritike ndaj të dhënave të ndryshme;</li> <li>• zhvillimin e interesimit për jetën publike nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në aktivitete jashtëshkollore/shoqërore;</li> <li>• përballje me zgjidhjen e çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me tema nga jeta reale përmes projekteve që do t'u mundësojnë konsolidimin e dijeve të tyre dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive dhe të qëndrimeve;</li> <li>• familjarizimin me mundësi të ndryshme të studimit dhe orientimit në karrierë;</li> <li>• përgatitjen praktike dhe aktivitetet orientuese që u mundësojnë nxënësve të qartësojnë aspiratat e tyre;</li> <li>• përforsimin e shkathtësisë për vetëvlerësim dhe vlerësim;</li> <li>• përforsimin e kompetencave për punë të pavarur dhe ekipore;</li> <li>• për identifikimin e qartë të aftësive dhe talenteve të veçanta të nxënësit.</li> </ul> |

### 3. Kompetencat kryesore të të nxënit

Kompetencat përfshin një sistem të integruar dhe koherent të njohurive shkathtësive dhe i qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat i dëshmojnë se nxënësit janë aftësuar të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura.

Kompetencat burojnë nga qëllimi i përgjithshëm i arsimit parauniversitar, të cilat janë rezultat

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



i të nxënimit të njohurive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme përgjatë niveleve të caktuara të sistemit arsimor. Ato duhet të dëshmojnë se për çka janë të aftë nxënësit pas një periudhe të caktuar të të nxënimit.

*Këto kompetenca janë:*

1. Kompetenca komunikimi dhe të shprehurit
2. Kompetenca të menduarit
3. Kompetenca të mësuarit për të nxënë
4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
5. Kompetenca personale
6. Kompetenca qytetare.

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënimit, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të detyrueshëm.

Kompetencat *komunikimi dhe të shprehurit, kompetenca të menduarit dhe kompetencat për të mësuar* janë të natyrës instrumentale: ato janë bazë për kompetencat e tjera, të cilat më tepër janë të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën private, publike dhe profesionale.

## **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Komunikues efektiv)**

Me qëllim që nxënësit dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehin në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

## **Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ/krijues dhe kritik)**

Përveç aftësisë për të identifikuar dhe për t'iu qasur informatës/burimit të njohurisë së caktuar, nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë edhe kapacitete për t'iu qasur njohurive dhe për t'i përpunuar dhe gjykuar në mënyrë kritike, kreative dhe ndërvepruese.

## **Kompetenca e të mësuarit (për të nxënë) tërëjetësor (Nxënës i suksesshëm)**

Për një nxënës të suksesshëm shkolla angazhohet të kultivojë vazhdimisht kërkueshmëri dhe interesimin për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencat për të mësuar. Shkolla po ashtu duhet të vetëdijësohet për stilet dhe strategjitë efektive mësimore.

## **Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Kontribues produktiv)**

Shkolla angazhohet që nxënësi/ja të përgatitet të punojë në mënyrë të pavarur dhe të vetëdijësohet për rolin dhe përgjegjësinë e tij në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Për të zhvilluar këtë kompetencë nxënësi/ja përkrahen që të kuptojë në mënyrë të plotë ndërvarësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore. Njëkohësisht, duke e pasur parasysh arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, ai/ajopërgatitet që të ballafaqohet me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.

## **Kompetenca personale (Individ i shëndoshë)**

Shkolla përgatit nxënësit që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen që të vetëdijësohen

për veten dhe të kenë vetëbesim, por njëkohësisht të jenë të hapur dhe të kenë besim te të tjerët.

## **Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm)**

Shkolla përgatit nxënësin/en për të jetuar së bashku me të tjerët dhe për të tejkaluar sfida kryesore me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Kjo kompetencë siguron që nxënësi të jetë në gjendje të veprojë si qytetar i përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë të zhvillimeve në shoqëri.

### **3.1. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore për shkallë**

Kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënit për shkallë. Ato janë pjesë e Kurrikulave bërthamë dhe parashihet të arrihen nga të gjithë nxënësit me rastin e përfundimit të një shkalle kurrikulare. Rezultatet e të nxënit nuk mbulojnë gjithçka që nxënësit kanë mësuar apo është dashur të mësojnë gjatë një shkalle të caktuar. Ato shprehin kërkesat esenciale të arritjes kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të një shkalle të caktuar si dhe promovojnë integrim të mëtejshëm të fushave të kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me Kornizën kurrikulare.

Secila fushë e kurrikulës, si një tërësi e organizimit të procesit mësimor, ndihmon zhvillimin dhe arritjen e kompetencave kryesore nga nxënësit. Po ashtu edhe çështjet (temat) ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare (veprimtaritë jashtëkurrikulare) luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe arritjen e kompetencave kryesore, përkatësisht ndihmojnë nxënësit në arritjen rezultateve të kompetencave për shkallë kurrikulare.

Rezultati i të nxënit përkufizohet si: "Deklaratë që përshkruan atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një shkalle apo niveli". Ai shpreh një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat.

Rezultatet e të nxënit për kompetenca në nivel shkalle artikulojnë pritjet e mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve në fund të çdo shkalle të kurrikulës. Ato (REN) janë bazament për hartimin e programeve mësimore, organizimit mësimor në shkollë, hartimit të teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera mësimore.

### **3.2. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore**

| Nr. | Rezultatet e të nxënit për shkallën 3 dhe kompetencat kryesore  |
|-----|---|
| I   | <b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>   |
| 1.  | Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.                                       |
| 2.  | Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.                       |
| 3.  | Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim. |
| 4.  | Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.  |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS

|    |  |
|----|--|
| 5. | Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.   |
| 6. | Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.   |
| 7. | Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.   |
| 8. | Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. |

## Shkalla 3 – zhvillim i mëtejshëm dhe orientim (klasat VI dhe VII)

| II  | Kompetenca të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik  |
|-----|--|
| 1.  | Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.   |
| 2.  | Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.  |
| 3.  | Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).   |
| 4.  | Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.   |
| 5.  | Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.  |
| 6.  | Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.   |
| 7.  | Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.  |
| 8.  | Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.  |
| III | Kompetenca të mësuarit për të nxënë- Nxënësi i suksesshëm  |
| 1.  | Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. |
| 2.  | Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.                            |
| 3.  | Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.  |
| 4.  | Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.  |
| 5.  | Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.                               |

|    |   |
|----|---|
| 6. | Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.   |
| 7. | I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. |
| 8. | Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).   |

Rezultatet e kompetencave kryesore që pritet të arrihen nga nxënësit deri në fund të shkollës së tretë.<sup>3</sup>

| IV | Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv  |
|----|--|
| 1. | Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.  |
| 2. | Zhvillon një projekt individual ose në bashkëpunim me anëtarët e grupit, për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.  |
| 3. | Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.   |
| 4. | Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.   |
| 5. | Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.                               |
| 6. | Ndihmon në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve vullnetare apo humanitare në shkollë dhe në komunitet dhe shpreh pastaj përvojat dhe ndjenjat e veta me shkrim dhe forma të tjera të të shprehurit.  |
| 7. | Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).                                    |
| 8. | Merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi sportiv, shkencor, artistik etj., duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.   |
| V  | Kompetenca personale - Individ i shëndoshë   |
| 1. | Prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi a specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqim të shëndetshëm.  |
| 2. | Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative të paktën të tri llojeve të ushqimeve të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë.  |
| 3. | Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.  |
| 4. | Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.   |
| 5. | Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.  |
| 6. | Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupit. |

<sup>3</sup> Udhëzimet metodologjike për organizimin e procesit mësimor për arritjen e këtyre rezultateve janë dhënë në kapitullin VI – Metodologjia e përgjithshme.



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS

|     |   |
|-----|---|
| 7.  | Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor.   |
| 8.  | Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit.  |
| 9.  | Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.   |
| 10. | Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të fituara. |

| VI | Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm  |
|----|---|
| 1. | Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.  |
| 2. | Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.   |
| 3. | Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.  |
| 4. | Shfaq mirëkuptim për personat të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke ilustruar me shembuj nga jeta e përditshme nga mediet, të dhënat historike, personazhet nga romanet që ka lexuar apo nga filmat që ka parë në mënyrë që të mos përsëriten më.           |
| 5. | Shpjegon, në forma të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interesit.  |
| 6. | Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.  |
| 7. | Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.   |
| 8. | Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë. |

Mësimdhënësi me rastin e zbatimit të një rezultati të të nxënit për shkallë kurrikulare, duhet ta zërthejë në pesë nivele të arritshmërisë në mënyrë që të vërejë saktë arritjen e secilit nxënës për rezultatin e caktuar. Më pas, varësisht nga niveli i arritjes të secilit rezultat, planifikon aktivitete plotësuese për nxënësin që ka ngecje në arritjen e rezultatit të caktuar dhe planifikon aktivitete shtesë për nxënësin që i ka arritur të gjitha nivelet e arritshmërisë për rezultatin e caktuar

### 3.3. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore Shkalla 4 - Përforsim dhe orientim, (klasat VIII dhe IX)

*Kjo shkallë synon t'i orientojë nxënësit që të marrin parasysh mundësitë e ndryshme të shkollimit dhe të karrierës. Deri në fund të shkallës 4 të Kurrikulës (klasat VIII dhe IX), pritet që nxënësit të kenë zotëruar kompetencat si në vijim:*

# KURRIKULA BËRTHAMË


E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

| Nr.        | Rezultatet e të nxënit për shkallën 4 dhe kompetencat kryesore  |
|------------|---|
| <b>I</b>   | <b>Kompetenca komunikim dhe të shprehurit- Komunikues efektiv</b>   |
| 1.         | Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.   |
| 2.         | Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.  |
| 3.         | Diskuton për një temë të caktuar në gjuhën amtare, në gjuhën angleze ose në gjuhën e dytë të huaj në lëndë të ndryshme, duke respektuar rregullat e pjesëmarrjes efektive për këmbimin e informatave dhe të ideve.  |
| 4.         | Harton një tekst, deri në pesëqind fjalë, duke e vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar paraprakisht duke u bazuar në imagjinatën e vet.   |
| 5.         | Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërrshetur format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.   |
| 6.         | Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.  |
| 7.         | Identifikon burime të ndryshme të informacionit për arsimim, orientimin profesional dhe harton një plan individual për zhvillimin e karrierës në fushën e komunikimit (gazetar etj.).   |
| 8.         | Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore.   |
| <b>II.</b> | <b>Kompetenca të menduarit-- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>   |
| 1.         | Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.  |
| 2.         | Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.   |
| 3.         | Analizon një punim artistik ose joartistik (p.sh., artikull gazetaresk, pikturë... etj.) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm.   |
| 4.         | Përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar aktivitetet kryesore, përcakton qëllimin kryesor, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e atyre aktiviteteve si dhe parasheh pengesat e mundshme gjatë realizimit të tyre. |
| 5.         | Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi apo të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu.   |
| 6.         | Demonstron zgjidhjen e një problemi (matematik, linguistik ... etj.) bazuar në të dhënat tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale të detyrës e cila bëhet në klasë/shkollë apo jashtë saj duke arsyetuar me gojë zbatimin e ecurive përkatëse për arritjen e rezultatit.                      |
| 7.         | Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.   |
| 8.         | Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.  |



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



| <b>III</b> | <b>Kompetenca të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>   |
|------------|---|
| 1.         | Regjistron në formë të shkruar, grafike, me TI etj., informatat ose faktet për një temë të caktuar duke i veçuar, me anë të teknikave të ndryshme, pjesët e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të nevojshme për atë temë/detyrë të dhënë.                                    |
| 2.         | Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj.   |
| 3.         | Regjistron në skeda dhe teknika të tjera të veçanta, TI etj., informatat ose faktet a formulat për një temë të caktuar duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë mësimore të tyre.  |
| 4.         | I parashton pyetje vetes për çështjet që trajton dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare.  |
| 5.         | Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas këtë para të tjerëve.   |
| 6.         | Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.   |
| 7.         | Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënës të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të papaqarta.   |
| 8.         | Zbaton elementet e dosjes personale për identifikimin e anëve të veta të forta, i shfrytëzon ato për orientim në profesionin e ardhshëm si dhe për vetëvlerësimin e përparimit, qoftë përmirësimin apo ngecjen në fusha të ndryshme mësimore.                                   |
| <b>IV</b>  | <b>Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis-Kontribuues produktiv</b>   |
| 1.         | Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.   |
| 2.         | Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instalacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin.               |
| 3.         | Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe të biodiversitetit, paraqet në formë të shkruar, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje, por edhe organizon ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit. |
| 4.         | Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/ dhe publikimeve të ndryshme të shkollës.   |
| 5.         | Zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale, të familjes ose të klasës, arsyeton pastaj rëndësinë e krijimit të shprehisë për të planifikuar.  |
| 6.         | Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë.  |
| 7.         | Propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik etj., si anëtar jurie të ngritur në nivel klase, shkolle apo shoqërie civile.   |
| 8.         | Hulumton nevojat e shkollës ose të komunitetit (me anë të fotografive, videoprojektimit të të dhënave nga terreni) dhe në bazë të tyre organizon aksione vullnetare dhe humanitare për plotësimin ose përmirësimin e atyre nevojave.  |


# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS


| V  | Kompetenca personale -- Individ i shëndoshë  |
|----|--|
| 1. | Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.  |
| 2. | Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjua nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.  |
| 3. | Vlerëson domosdoshmërinë e kushteve të mira higjienike për përgatitjen dhe konsumimin e ushqimeve dhe pijeve dhe shpjegon rrethanat e mundshme të helmimit nga ushqimet dhe papastërtia.   |
| 4. | Zhvillon aktivitete fizike dhe sportive me karakter rekreativ apo garues, duke bërë përpjekje për arritjen e standardeve të caktuara, me angazhim dhe sjellje të pëlqyera, por edhe duke menaxhuar emocionet e veta gjatë paraqitjes së rezultateve.   |
| 5. | Analizon shkaqet e një reagimi konfliktuoz apo emocional nxënës-nxënës dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja, duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit.   |
| 6. | Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre.   |
| 7. | U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetentë, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.                                       |
| 8. | Përshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezantimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, lojë teatrale, performancë artistike etj.). |
| 9. | Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehitë negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj.  |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



| VI | Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm  |
|----|---|
| 1. | Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).  |
| 2. | Reagon, nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit, ndaj personave të cilët në ndonjë mënyrë shkelin, cenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve, duke ilustruar me shembujt e figurave të shquara historike, personazheve nga letërsia a filmat si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin. |
| 3. | Shpreh solidaritet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime/aksione konkrete për ofrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë.   |
| 4. | Merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e një votimi të zhvilluar në klasë ose në shkollë për një aktivitet të caktuar duke zbatuar rregullat përkatëse dhe raporton më pas me shkrim për rrjedhën e gjithë procesit.   |
| 5. | Reagon me maturi ndaj sjelljeve apo veprimeve jo të mira që ndodhin në klasë/shkollë apo jashtë saj, promovon sjelljet dhe veprimet e mira duke vënë në pah shkaqet dhe pasojat e manifestimit të tyre për individin dhe për të tjerët.   |
| 6. | Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.   |
| 7. | Përgatit një aktivitet me bashkëpjesëmarrje me të tjerët, duke përdorur tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet.  |
| 8. | Përshkruan, në forma të ndryshme të të shprehurit, procedurat dhe institucionet përgjegjëse për hartimin dhe ndryshimin e ligjeve duke argumentuar domosdoshmërinë e zbatimit të tyre në jetën e përditshme.  |
| 9. | Prezanton pa ngurrim të kaluarën e familjes, të rrethit shoqëror ose të personaliteteve dhe ngjarjeve kryesore të kombit të vet, për të krahasuar të tashmen me të kaluarën dhe për të nxjerrë përfundime për të ardhmen.   |



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## III FUSHAT E KURRIKULËS

Fushat e Kurrikulës – funksioni dhe organizimi i tyre  
Gjuhët dhe komunikimi  
Artet  
Matematika  
Shkencat natyrore  
Shoqëria dhe mjedisi  
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti  
Jeta dhe puna

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## Fushat e Kurrikulës

Fushat e kurrikulës përbëjnë bazën e organizimit të procesit mësimor-edukativ në shkollë, për çdo nivel arsimor dhe shkallët përkatëse të saj. Kurrikula e arsimit parauniversitar është e organizuar në shtatë fusha të kurrikulës. Fushat e kurrikulës përfshijnë një ose më shumë lëndë apo module. Lëndët dhe modulet bazohen në rezultatet e të nxënit, të përcaktuara për çdo fushë. Disa lëndë të fushës mund të jenë pjesë e disa shkallëve kurrikulare.

*Fushat e kurrikulës janë:*

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Artet
3. Matematikë
4. Shkenca e natyrës
5. Shoqëria dhe mjedisi
6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
7. Jeta dhe puna

*Për secilën fushë përcaktohen rezultatet e të nxënit, të cilat mundësojnë zhvillimin e kompetencave kryesore. Rezultatet e të nxënit sipas fushave sigurojnë:*

- Zhvillimin e kompetencave përmes një tërësie të përbashkët përvojash mësimore të ndërlidhura.
- Lidhjen ndërmjet lëndëve dhe veprimtarive mësimore, që realizohen në kuadër të një fushe të kurrikulës, me synim integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, që mundësojnë këto lëndë.
- Zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel shkolle.

*Secila nga fushat e kurrikulës, nga pikëpamja e organizimit të materialit, paraqitet sipas formatit të mëposhtëm:*

- Hyrja
- Qëllimi i fushës
- Konceptet e përgjithshme të fushës dhe përshkrimi i tyre
- Rezultatet e të nxënit të fushës
- Udhëzimet metodologjike
- Udhëzimet për vlerësim
- Materialet dhe burimet mësimore.



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## Gjuhët dhe komunikimi

Hyrje  
Qëllimi  
Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi  
Rezultatet e të nxënit të fushës  
Udhëzime metodologjike  
Udhëzime për vlerësim  
Materialet dhe burimet mësimore

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## 1. Hyrje

Kurrikula Bërthamë për këtë nivel (klasa 6-9), nxënësve u mundëson zhvillimin e aftësive të komunikimit si: përdorimin funksional dhe efektiv të gjuhës, thellimin e aftësive për lexim - shkrim, pasurimin e fjalorit, zhvillimin e shkathtësive gjuhësore, të kuptuarit përmes dëgjimit, të folurit në funksion të dhënies dhe marrjes së informacionit, lexim-kuptimin, të shkruarit sipas modeleve të dhëna, dallimin e elementeve të veçanta letrare e joletrare, njohjen dhe zgjerimin e formave të sistemit gjuhësor (fonetikë, morfologji, sintaksë), zhvillimin e shkathtësive të të shprehurit nëpërmjet mjeteve të ndryshme audio-vizuale; përdorimin e TIK-ut, formimin e përgjithshëm gjuhësor, letrar, kulturor dhe jetësor.

Fusha *Gjuhët dhe komunikimi* në nivelin e dytë (klasa 6-9), bazuar në Kornizën Kurrikulare, përmban këto lëndë: gjuhë amtare, gjuhë e parë e huaj (gjuhë angleze), gjuhë e dytë e huaj (gjuhë gjermane/frënge) si dhe gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare. Kjo fushë nxënësit i përgatit për komunikim efektiv, të qartë dhe përmbajtjesor.

Nëpërmjet lëndëve të kësaj fushe nxënësve u mundësohet t'i zhvillojnë dhe kultivojnë shkathtësitë kryesore të gjuhës: të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit, me qëllim të zhvillimit të kompetencave të cilat i përdor në jetën e përditshme.

## 2. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj fushe është avancimi i shkathtësive gjuhësore dhe të komunikimit në funksion të formësimit gjuhësor e të menduarit kritik e kreativ, të lexuarit dhe të kuptuarit e zhanreve të ndryshme, të shkruarit funksional dhe komunikimit me shkrim dhe me gojë në situata të ndryshme jetësore.

## 3. Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre

Konceptet për fushën gjuhët dhe komunikimi të cilat janë zhvilluar në nivelin e parë të arsimit vazhdojnë të zhvillohen dhe thellohen edhe në nivelin e dytë të arsimit, pra edhe në shkallën e tretë dhe të katërt të kurrikulës.

Konceptet e kësaj fushe që zhvillohen edhe në këtë nivel të arsimit janë:

- **Tekstet letrare dhe joletrare**

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohuritë më të thelluara për tema, autorë, fenomene, dukuri dhe ngjarje të ndryshme letrare e kulturore. Kjo i mundëson nxënësit të konsolidojë të kuptuarit për tekstet letrare dhe joletrare dhe nëpërmjet tyre të dallojë veçantitë e strukturës gjuhësore, letrare e stilistike. Tekstet letrare dhe jo-letrare përdoren me nxënës për zgjerimin e dijeve dhe të aftësive argumentuese, interpretuese e kreative.

- **Gjuha figurative dhe jofigurative**

Ky koncept përfshin njohuri të thelluara për gjuhën figurative dhe jofigurative, fantazinë krijuese në zhanre të ndryshme dhe format e caktuara shprehëse. Trajtimi i kësaj tërësie në këtë nivel të arsimit, i mundëson nxënësit në zhvillimin e fantazisë krijuese në zhanre të ndryshme dhe në identifikimin e formave të caktuara shprehëse të cilat ndihmojnë krijimin e individualitetit.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

- **Kritika, teoria, historia**

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohuritë më të thelluara për koncepte të kritikës, teorisë dhe historisë letrare. Njëpërmjet kritikës, teorisë dhe historisë, të nxënësi zhvillohen aftësitë për analizë dhe vlerësim të elementeve të teksteve të caktuara si personazhet, ngjarjet, individualitetet e modelet shprehëse, duke shpjeguar dhe debatuar mbi bazën e argumenteve për tema dhe autor.

- **Sistemi i gjuhës**

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohuritë më të thelluara për kategori gjuhësore nga fushat e fonetikës, morfologjisë, sintaksës, stilistikës, leksikut dhe drejtshkrimit. Përvetësimi i sistemit gjuhësor realizohet përmes zhvillimit të shkathtësive të komunikimit që lidhen me forma të teksteve letrare dhe joletrare. Kjo i mundëson nxënësit që të pasuron fjalorin, zhvillon njohuritë për veçoritë fonetike, morfologjike, sintaksore e stilistike; përdor rregulla drejtshkrimore dhe zhvillon forma të shkrimit narrativ, përshkrues e argumentues.

## 4. REZULTATET E TË NXËNIT


Rezultatet e të nxënësit janë hartuar mbi bazë të koncepteve të fushës. RN për fushën *Gjuhët dhe komunikimi* përmbajnë në vete kërkesat që nxënësi duhet t'i arrijë pas përfundimit të çdo shkalle. RN-të përmbajnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrime dhe vlera të cilat zhvillohen dhe thellohen gradualisht nëpër shkallë, duke pasur parasysh zhvillimin fizik dhe psikomotorik të nxënësve. Këto rezultate mundësojnë arritjen e gjashtë kompetencave të përcaktuara në Kornizën e kurrikulës. Rezultatet e nxënësit mundësojnë demonstrimin e shkathtësive të komunikimit, zgjidhje e një problemi, zbatimin e ideve abstrakte për situata konkrete, shfrytëzimin e teknologjisë së përshtatshme, aplikimin e parimeve etike për vendimmarrje, punën si një anëtar i ekipit për të arritur qëllimet e përbashkëta, bisedën për tema personale dhe kulturore.

| REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLËN 3 dhe 4   |  |
|---|--|
| Shkalla 3<br>Klasa VI, VII  | Shkalla 4<br>Klasa VIII, IX  |
| <b>I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT</b>  |  |
| <b>Të dëgjuarit dhe të folurit</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëguara, të shikuara a të prezantuara dhe reflekton për to.</li><li>• Merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.</li><li>Interpreton subjektin, idenë, rrëfimin, gjuhën e figurshme, vendin e hapësirën në letërsi.</li><li>Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme</li></ul> | <b>Të dëgjuarit dhe të folurit</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj.</li><li>Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore</li><li>Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme</li></ul> |



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



|  |   |
|--|---|
| <p><b>Të lexuarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.</li><li>• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.</li></ul> <p>Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme<br/>Pasuron fjalorin.</p>  | <p><b>Të lexuarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare.</li></ul> <p>Pasuron fjalorin.</p> <p>Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.</li><li>• Identifikon dhe analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.</li></ul>  |
| <p><b>Të shkruarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj.</li></ul> <p>Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara.</li></ul> <p>Shkruan për tema të caktuara;</p> <p>Shkruan për përvojat e veta dhe të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime, vjersha etj.</p> <p>Përdor materiale të ndryshme për të këmbyer porosi, nëpërmjet reklamave, shpalljeve, lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në medie.</p> <p>Përdor teknologjinë për të krijuar tekste grafike, tabela, skica, figura, fotografi animacione, skeçe etj.</p> | <p><b>Të shkruarit</b></p> <p>Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj.</p> <p>Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët.</li></ul> <p>Shkruan për tema të caktuara.</p> <p>Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit.</p> <p>Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në medie.</p> <p>Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.</p> |

## II. VLERAT DHE QËNDRIMET

- Komunikon mirë
- Merr pjesë në diskutim
- Bashkëpunon
- Kërkon dhe jep ndihmë
- Respekton mendimin e të tjerëve
- Kushton vëmendje
- Zhvillon personalitetin dhe humanitetin
- Merr iniciativa dhe tregon interesim për qasje të ndryshme
- Motivohet për zhvillimin e shkathtësive
- Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve
- Përdor teknologjinë informative
- Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe
- Respekton parimet e të tjerëve
- Tregon vetëbesimin për punë të pavarur
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin
- Është i pavarur në vendimmarrje dhe në veprime
- Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme
- Kritikon duke u mbështetur mbi argumente
- Tregon kureshtje për hulumtimin
- Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin

## III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja:

- Të komunikuarit
- Të dëgjuarit
- Të folurit
- Të shkruarit
- Të lexuarit
- Të kuptuarit
- Përdorimi i teknologjisë informative
- Zgjidhja e problemeve
- Aftësitë e të menduarit
- Përpunimi i informacionit
- Të menduarit krijues

## IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës

- Komunikim verbal dhe joverbal
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst.
- Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.
- Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare.
- Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
- Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim.
- Strofë, varg, rimë.
- Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet.
- Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim.
- Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë.
- Llojet e fjalive sipas intonacionit.
- Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta.
- Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit.
- Parafjalë, lidhëz.
- Shenjat e pikësimit.
- Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## 5. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Procesi i mësimdhënies për fushën *Gjuhët dhe komunikimi* duhet të bazohet në nevojat dhe interesat e nxënësve, në funksion të zhvillimit të individualitetit dhe kreativitetit të tyre. Nxënësit duhet t'i arrijnë kompetencat e tyre nëpërmjet mësimit dhe qasjes së integruar. Arritja e suksesshme e tyre bëhet nëpërmjet rezultateve të fushës. Metodot, format, mjetet, përmbajtjet mësimore si dhe strategjitë e teknikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë çelës kryesor për arritjen e këtyre kompetencave. Për arritjen e rezultateve për tema të caktuara ndërkurrikulare si: edukimi qytetar, edukimi për paqe, ndërvarësia, edukimi për media, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe diasporë, mësimdhënësi duhet të përzgjedhë metodën, formën dhe strategjinë e duhur. Në këtë nivel komunikimi efektiv arrihet nga nxënësit me metodën e bashkëbisedimit, por nuk duhet lënë anash as metoda tjera, gjithmonë duke pasur parasysh njohuritë paraprake, interesat dhe nevojat e nxënësve. Organizimi i mësimit duhet të jetë atraktiv dhe interesant në mënyrë që nxënësit të jenë në bashkëveprim gjatë gjithë kohës për të marrë njohurit reja.

## 6. UDHËZIME PËR VLERËSIM

Për fushën *Gjuhët dhe komunikimi* vlerësimi bëhet me qëllim të mbledhjes, sistemimit, evidentimit dhe raportimit të të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të mësimnxënies. Vlerësimi për këtë fushë nxënësve u siguron informacione për nivelin e përvetësimit dhe të arritjes së kompetencave.


Vlerësimi për këtë fushë në këtë nivel bëhet për kuptimin e leximit duke përdorur atë për të reflektuar mbi tekstet e shkruara për qëllime të caktuara. Vlerësimi në këtë fazë zhvendoset nga memorizimi i informacionit dhe dijeve të marra nga burime të caktuara në aftësinë për të kuptuar dhe reflektuar mbi to. Vlerësimi përqendrohet në gjetjen, përzgjedhjen, interpretimin dhe vlerësimin e informacionit që merret nga fusha e gjerë e teksteve (letrare dhe joletrare) të lidhura me situatën përtej klasës. Vlerësimi duhet të përqendrohet në njohjen e fjalëve dhe kuptimi i tyre në kontekst, në njohuritë nga gramatika, struktura gjuhësore dhe tekstuale gjatë paraqitjeve me gojë ose me shkrim.

Vlerësimi përqendrohet te shkrimet e pavarura për qëllime të caktuara, te përdorimi i të kuptuarit të asaj që dëgjon - lexon dhe reflektimi mbi të, si dhe angazhimi për të zhvilluar njohuritë, qëndrimet dhe sjelljet e fituara gjë që çon deri te integrimi social dhe zhvillimi personal.

Vlerësimi duhet të përfshijë raportimin e informacionit të marrë për performancën e dëgjimit aktiv, të leximit-shkrimit, duke përfshirë karakteristikat njohëse së bashku me ato të sjelljes në të lexuar/shkruar kreativitetin, në të shprehurit me gojë ose shkrim. Raportimi duhet të jetë motivues për zotërimin e të shprehurit me gojë dhe shkrim.

## 7. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Për arritjen e kompetencave në fushën *Gjuhët dhe komunikimi* është i rëndësishëm përdorimi i materialeve dhe burimeve të ndryshme mësimore për mësimdhënie dhe nxënie. Për realizimin e rezultateve të fushës dhe arritjen e suksesshme të rezultateve për shkallë, të gjitha mjetet dhe materialet mësimore duhet t'u përmbahen kërkesave të këtyre rezultateve për fushë dhe shkallë. Tekstet shkollorë janë vetëm disa nga burimet për marrjen e informacionit, prandaj ato nuk duhet të jenë burim i vetëm; përdoret edhe teknologjia informative. Informacionet mund të merren nga çdo burim i cili ndihmon arritjen e kompetencave.



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS


## Artet

Hyrje  
Qëllimi

Konceptet dhe përshkrimi  
Rezultatet e fushës  
Çështjet ndërkurrikulare  
Materialet dhe burimet mësimore  
Udhëzime metodologjike  
Udhëzime për vlerësim

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## 1. Hyrje

Artet (muzika, artet pamore, vallëzimi, drama) janë pjesë e kulturës dhe shërbejnë si mjet universal komunikimi e interpretimi të ideve e mesazheve dhe emocioneve individuale e kolektive. Artet përfshijnë krijimtarinë artistike autoriale por edhe elemente të trashëgimisë kulturore lokale, kombëtare e universale të manifestuar përmes kulturës, artefakteve, objekteve dhe krijimtarisë popullore (këngët, vallet, lojërat, legendat, përrallat, mitet, etj.).

Edukimi artistik u mundëson nxënësve që të kenë vizion, të planifikojnë dhe të caktojnë qëllime, të përcaktojnë metoda të ndryshme si t'i arrijnë ato qëllime të identifikojnë alternativat, t'i rishikojnë ato, të zgjedhin probleme, të imagjinojnë, të punojnë në grupe dhe të aplikojnë vetëdisiplinë, durim, përqendrim, guxim dhe iniciativë. Me të gjitha këto veprime në fushën mësimore - *Artet*, nxënësit përdorin tërë potencialin e tyre njerëzor, emocional dhe kreativ në mënyrë unike. Të mësuarit përmes arteve e mundëson një nivel të të menduarit më specifik, më kreativ dhe më të avancuar, të bazuar në gjykim, invencion dhe imagjinatë

Fusha kurrikulare Artet në nivelin e dytë përfshinë dy lëndë të obligueshme: Artin figurativ dhe Artin muzikor.

Shkolla inkurajohet që përmes Kurrikulës me zgjedhje (si lëndë të veçanta, module ose si aktivitete/ projekte) edhe në këtë nivel nxënësve t'u ofrohet mundësia që të marrin pjesë edhe në forma të tjera të shprehjes artistike përpos artit figurativ dhe muzikor siç janë: këndimi koral, orkestra, ansamblet muzikore, rock dhe pop-bendet e shkollës, drama, vallëzimi modern, fotografia, filmi, dizajni multimedial, videodizajni, uebdizajni etj.).

## 2. QËLLIMI I FUSHËS

Artet (muzika, artet pamore, vallëzimi, drama) janë pjesë e kulturës dhe shërbejnë si mjet universal komunikimi e interpretimi të ideve e mesazheve dhe emocioneve individuale e kolektive. Të mësuarit përmes arteve e mundëson një nivel të të menduarit më specifik, më kreativ dhe më të avancuar, të bazuar në gjykim, invencion dhe imagjinatë.

Edukimi artistik u mundëson nxënësve të kenë vizion, të planifikojnë dhe të caktojnë qëllime, të përcaktojnë metoda të ndryshme si t'i arrijnë ato qëllime të identifikojnë alternativat, t'i rishikojnë ato, të zgjedhin probleme, të imagjinojnë, të punojnë në grupe dhe të aplikojnë vetëdisiplinë, durim, përqendrim, guxim dhe iniciativë. Me të gjitha këto veprime në fushën mësimore - *Artet*, nxënësit përdorin tërë potencialin e tyre njerëzor, emocional dhe kreativ, në mënyrë unike.

## 3. Konceptet kryesore tematike të fushës dhe përshkrimi

Meqë artet e ndryshme kanë specifikat e tyre, janë identifikuar disa koncepte të përbashkëta tematike të fushës Artet-që janë të shtrira në gjithë sistemin arsimor nga klasa 0-12. Nga këto koncepte të përgjithshme rrjedhin edhe rezultatet e fushës (RNF) dhe temat e njësitë mësimore të ndryshme me të cilat arrihen rezultatet e të nxënit.

*Ato janë:*

- ❖ **Krijimtaria dhe performanca artistike** – këtu kemi të bëjmë me veprimtaritë artistike kryesore përmes të cilave nxënësit inkurajohen të krijojnë dhe performojnë në aktivitete artistike, individualisht ose në grup, sipas prirjeve, dispozitave dhe interesave të tyre.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

Ato janë:

- ❖ **Gjuha dhe komunikimi artistik** - Gjuha artistike ka mjetet (elementet) e ndryshme shprehëse (tingujt, vijat, ngjyrat, ritmi, melodia, harmonia etj.) dhe rregullat/parimet me të cilat nxënësit mësojnë të njohin, kuptojnë dhe të zbatojnë ato për komunikim artistik në mënyra dhe nivele të ndryshme.

*Teknikat* dhe proceset janë mënyra të ndryshme të përdorimit të mjeteve shprehëse artistike me qëllim të komunikimit në arte të ndryshme brenda gjinive, zhanreve e stileve të ndryshme artistike. (P.sh. teknike në muzikë mund të jetë: këndimi me nota, përdorimi i ritmeve për të krijuar një tërësi ritmike etj., kurse në arte pamore, p.sh.: vizatimi, pikturimi, modelimi, grafika, dizajni, etj., janë teknika të ndryshme në arte pamore).

Komunikimi dhe të shprehurit artistik - ka të bëjë me hapësirën që i jepet nxënësve për të njohur, kuptuar dhe përdorur gjuhën artistike me qëllim të komunikimit të lirë artistik për tema të ndryshme, idetë dhe ndjenjat personale.

- ❖ **Relacioni art-shoqëri** – këtu kemi të bëjmë me trajtimin e artit në kontekstin historik dhe shoqëror (lokal, regjional, kombëtar, global etj).

Nxënësit vërejnë dhe përjetojnë vepra artistike nga gjini, zhanre, stile, vepra, ngjarje, institucione artistike në periudha të ndryshme historike e në kontekste të ndryshme shoqërore (lokale, regjionale, kombëtare, globale etj). Në kuadër të temave e njësive mësimore nxënësit njohin edhe ndonjë krijues, interpret të shquar e zhvillime artistike kryesore që kanë lënë gjurmë në shoqëri, gjithmonë në përputhje me mundësitë përjetuese dhe moshës së nxënësve. Këtu kemi të bëjmë me koncepte që përshkruajnë gjini, zhanre, stile, struktura artistike në periudha të ndryshme stilistike si edhe krijues, interpretë, ngjarje, institucione artistike etj. P.sh instrumentet muzikore, ansamblet, formacionet, gjinitë (muzika vokale, muzika instrumentale, muzika skenike), zhanret dhe stilet (klasicizmi, romantizmi, impresionizmi etj). Brenda këtyre shquhen krijues interpretë, institucione etj.

Në arte pamore: gjini dhe teknikat (vizatimi, piktura, skulptura, arkitektura, grafika, dizajni, multi-media, instalacioni, portreti, peizazhi, kolazhi, mozaiku, dizajni, moda, enterieri etj), zhanre dhe stile (klasicizmi, baroku, impresionizmi, etj).

Në kuadër të kësaj nxënësit njohin krijimtarinë e përfaqësuesve më të denjë në nivel botëror dhe kombëtar duke i identifikuar specifikat dhe ngjashmëritë.

- ❖ **Çmuarja dhe vlerësimi estetik**- ka të bëjë me një proces të vazhdueshëm në mësimin artistik që përfshin çdo temë, njësi e orë mësimore dhe përmes së cilit synojmë t'i aftësojmë nxënësit që të përdorin konceptet e mësuara për të gjykuar dhe vlerësuar krijimin dhe performimin artistik vetanaka dhe të tjerëve.

## 4. REZULTATET E TË NXËNIT

Sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, secila fushë kurrikulare duhet të kontribuojë në arritjen e kompetencave kryesore (*komunikues efektiv, mendimtar kreativ, nxënës i suksesshëm, individ i shëndoshë, kontribues produktiv dhe qytetar i përgjegjshëm*).

*Përmes pjesëmarrjes së vazhdueshme të nxënësve në veprimtaritë krijuese dhe performuese artistike, artet kontribuojnë për arritjen e këtyre kompetencave të përgjithshme por edhe në zhvillimin e kompetencave të caktuara artistike:*

- a) komunikimin dhe të shprehurit gjuhësor por edhe artistik,
- b) kreativitetin dhe imagjinatën si shtysë e zhvillimit të mendimit krijues
- c) aftësitë e ndryshme muzikore (kompetencat artistike) që lidhen me njohjen dhe

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS

përdorimin e koncepteve, elementeve artistike dhe teknikave e proceseve krijuese dhe performuese artistike

- d) aftësitë dhe shprehjet e të nxënësve sistematik dhe të qëndrueshëm
- e) kontributin aktiv dhe produktiv në jetën artistike në shkollë dhe komunitet
- f) aftësinë për t'u sjellë me përgjegjësi, përkushtim dhe bashkëpunim.

*Fusha kurrikulare Artet në nivelin e dytë të arsimit kryesisht synon të përmbushë këto tre aspekte themelore:*

- a) Aftësimin e nxënësve për pjesëmarrje aktive dhe zhvillimin e shkathtësive të ndryshme artistike duke u shquar në një e më shumë aktivitete/veprimtari të ndryshme kreative/artistike (në muzikë, në arte pamore, në dramë e në vallëzim) sipas prirjeve dhe dispozitave individuale të nxënësit.
- b) Njohjen dhe të kuptuarit e përdorimit të drejtë të elementeve të gjuhës artistike dhe rregullave të komunikimit artistik
- c) Zhvillimin e aftësisë për të vërejtur, përjetuar, çmuar dhe për të vlerësuar të bukurën në art dhe në ambientin e përditshëm që i rrethon nxënësit (shkollë, shtëpi, natyrë, qytet etj.) duke zhvilluar edhe aftësinë për çmuarje dhe vlerësim kritik estetik.
- d) Zhvillimin e qëndrimit pozitiv ndaj artit dhe kulturës materiale e shpirtërore popullore si pjesë e shumësisë së identitetve (si identiteti personal, lokal, kombëtar, global etj.).

Rezultatet e të nxënësve në fushën kurrikulare Artet (RNF) shtrihen brenda vetë koncepteve kryesore të fushës. Ato janë dhënë në mënyrë më të përgjithshme në kuadër të fushës, por do të specifikohen më konkretisht në kuadër të kurrikulave lëndore për secilën prej lëndëve artistike të Kurrikules Bërthamë (art muzikor dhe arte pamore) dhe të atij me zgjedhje (dramë, vallëzim, dizajn, fotografi, kor, orkestër etj.).



## REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET PËR SHKALLËN 3 DHE 4

Shkalla 3, klasa VI, VII

Shkalla 4, klasa VIII, IX

### I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË

#### 1. KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

Shkalla 3, klasa VI, VII

Shkalla 4, klasa VIII, IX

**Demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim**

Ai/ajo:

- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal;
- Interpreton pjesë nga role /personazhe të ndryshme (dramë, komedi);
- Interpreton individualisht ose në grup vallëzime me karakter të ndryshëm.

**Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale**

Ai/ajo

- vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara;
- Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë;
- krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve;
- krijon lëvizje origjinale e kreative gjatë vallëzimit;
- Krijon elemente origjinale e kreative në rolet, dialogët sipas temës së caktuar.

**Shquhet me aftësi individuale performuese (interpretuese) në një apo në më shumë veprimtari artistike**

Ai/ajo:

- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë);
- Interpreton në tërësi role (karaktere) të ndryshme;
- Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).

**Krijon duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të arteve përkatëse**


Ai/ajo:

- vizaton, ngjyros, modelon peizazh, portret, kompozicione dy e tridimensionale etj., në mënyrë të lirshme ose me temë të caktuar;
- Krijon këngë dhe shoqërime instrumentale në zhanre të ndryshme (popullore, artistike, argëtuese);
- Krijon koreografi origjinale sipas muzikës, tekstit ose situatës së caktuar;
- Krijon dhe kontribuon në realizimin skenik të teksteve për shfaqje të ndryshme (dramë, komedi, mjuzikll).



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## 2. GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

- |   |   |
|---|---|
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta</li><li>2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.</li><li>3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike</li><li>4. Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audiencën të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).</li><li>5. Njohin traditën të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</li></ol> | <ol style="list-style-type: none"><li>1. Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.</li><li>2. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri para audiencave të ndryshme, duke kombinuar format dhe mjetet shprehëse të arteve edhe me ndihmën e teknologjisë (prezantime multimediale, instalacione etj.).</li><li>3. Dallojnë aplikimet e inovacioneve në teknika shprehëse dhe medime bashkëkohore të artit (si video arti, Instalacioni, Performanca etj.), në veprat e artit bashkëkohor.</li><li>4. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) për audiencën të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).</li><li>5. Analizojnë dhe krahasojnë traditat e ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</li></ol> |
|---|---|

## 3. RELACIONI ART – SHOQËRI

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

### Shkalla 3, klasa VI, VII

- Identifikon dhe emëron vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme;
- identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

### Shkalla 4, klasa VIII, IX

- njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror;
- demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasika, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).
- Prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## 4. ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIKO-ARTISTIK

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

### Shkalla 3, klasa VI, VII

- Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse
- Komenton krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve, duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate
- Çmon veprat e trashëgimisë kulturore –popullore në ambientin ku jeton

### Shkalla 4, klasa VIII, IX

- Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.
- Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë
- Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë

## II. VLERAT DHE QËNDRIMET QË PROMOVOHEN PËRMES ARTEVE

- Kërshëria
- Vetëbesimi
  - Dëshira për shprehje dhe komunikim në mënyrë të pavarur
  - Pjesëmarrja aktive
  - Shoqërimi
  - Bashkëpunimi
  - Respekti për veten dhe të tjerët


- Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës
- Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare
- Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia
- Përqëndrimi dhe durimi

## III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

- Të vërejturit/të dëgjuarit/aftësitë perceptuese (Aftësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë (tingullore, ngjyrash, formash, strukturash, karakteresh, lëvizjesh etj.)
- Aftësitë përjetuese artistike
- Vëmendja dhe memorizimi
- Vullneti dhe motivacioni
- Iniciativa dhe interesimi
- Imagjinata dhe kreativiteti
- Shkathtësitë muzikore
- Shkathtësitë lëvizore/
- Shkathtësitë shprehëse figurative
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar
- Shkathtësia për punë ekipore
- Të menduarit analitik, kritik dhe kreativ

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## IV. Konceptet kryesore që mësohen përmes arteve në nivelin e dytë:

### Mjetet shprehese artistike:

- Fjala
- tingulli
- Vija
- Ngjyra
- Harmonia
- tekstura,
- Forma
- Hapësira
- Lëvizja
- Ritmi
- Melodia

### Parimet dhe teknikat shprehese

- Kontrasti
- Simetria dhe asimetria
- Perspektiva
- Baraspesha
- gradacioni,
- proporcioni
- Përsëritja
- Ndryshimi (variacioni)
- Krahasimi
- Theksi
- Ekuilibri
- Tërësia
- Kompozicion (vizual)
- Kënga
- Pjesa instrumentale

### Formacionet, institucionet, gjinitë, zhanret, stilet

- Instrumentet muzikore, ansamblet, kori dhe orkestra
  - Muzika vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe muzika skenike
  - Muzika popullore, patriotike, festive, argëtuese, programore etj
  - Institucionet muzikore, festivalet
  - Shfaqjet, performancat, ekspozitat, muzete galerite, etj.
  - Format muzikore : Sonata , Simfonia, Koncerti, fuga, oratorio, opera etj.
    - Vallja
    - Drama
    - Komedia
    - Tragjedia
    - Grafika
    - Posteri, maketa
    - Enterieri, ornamente, veshje etj.
    - Peizazhi
    - Portreti
    - Dizajni
    - Natyra e qetë
    - Kolazhi
    - Mozaiku
- Stilet: Baroku, klasicizmi, romantizmi, impresionizmi, ekspresionizmi, etj.

## 1. Udhëzime metodologjike

Artet edukojnë në mënyrë të suksesshme vetëm kur aplikohet me saktësinë më të madhe metodologjia speciale përkatëse e mësimdhënies dhe e nxënies artistike në secilën prej disiplinave artistike (muzikë, arte pamore, dramë, vallëzim etj.).

Metodika e mësimdhënies në lëndët që rrjedhin nga këto disiplina përfshin teknikat mësimore dhe metodat specifike të mëimit të koncepteve, shkathtësive dhe njohurive që nxënësit duhet t'i arrijnë përmes këtyre lëndëve mësimore. Përjetimi artistik, kërshëria, imagjinata dhe liria e të shprehurit, janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve. Duke supozuar se është punuar shumë me përjetimin artistik në nivelin e parë, në këtë nivel në mënyrë graduale nxënësit njihen me konceptet e ndryshme, dukuritë dhe fenomenet artistike përmes mësimdhënies intuitive dhe qasjes konstruktive të të nxënit.

Në secilën lëndë të veçantë të fushës Artet, nxënësit njohin dhe kuptojnë proceset dhe teknikat krijuese, duke mësuar si t'i zbatojnë në praktikë mjetet e ndryshme të të shprehurit artistik për të realizuar veprat/interpretimet e tyre artistike. Në këtë nivel mësimin e realizojnë mësimdhënësit specialistë të lëndëve përkatëse artistike që me kujdes zhvillojnë shkathtësitë artistike të nxënësit sipas prirjes individuale dhe interesimit.

Artet ndërveprojnë mes vete, andaj edhe në procesin mësimor mund të ndërliken format e ndryshme të të shprehurit artistik, p.sh., kënga me lëvizjen dhe vallëzimin, muzika me shprehjen

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

figurative, muzika me shprehja letrare, shprehja figurative me shprehjen letrare, performanca artistike sinkretike etj. Sidomos në këtë nivel, mund të aplikohet qasja e integruar e kombinimit të shprehjeve artistike për tema të ndryshme.

Mirëpo, artet mund të ndërlidhen edhe me lëndët e tjera të fushave të tjera kurrikulare. Ndërlidhja e gjuhës (amtare dhe të huaj) me muzikën mund të jetë shumë e suksesshme. Artet mund të ndërlidhen suksesshëm edhe me lëndët e fushës kurrikulare Shkencat (natyrore dhe shoqërore), Matematika, Shëndeti dhe mirëqenia, Jeta dhe puna etj.

Çdo tematikë e veçantë dhe përmbajtje mësimore që përpunohet në këtë nivel bëhet më e qartë dhe më e kuptueshme kur shoqërohet me shprehje artistike (ilustrimet, grafikën, hartat, kënga, muzika, vallëzimet, videoklipi etj.) P.sh Nga perspektiva e fushës – Artet, në nivelin e dytë mund të trajtohen një varg çështjes që kanë të bëjnë me promovimin e edukimit për paqe dhe demokraci, të drejtat e njeriut, të çështjet e barazisë gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, parandalimi dhe luftimi i dukurive negative shoqërore, promovimi i paqes, dialogut, tolerancës etj.

## *Ndërvarësia*

Nga perspektiva e arteve, vetë veprimtaritë artistike grupore e trajtojnë këtë temë, ngase p.sh. kur duhet të realizohet një mural, mozaik, kolazh, ose maketë grupore, të gjithë pjesëmarrësit e kuptojnë që pa bashkëveprimin e secilit nuk mund të realizohet tërësia e përbashkët. Muzikimi në ansambël, kor, orkestër realizohet vetëm duke respektuar bashkëveprimin dhe ndërvarësinë.

## *Edukimi për media*

Nga perspektiva e arteve, këtu perfshihen çështjet e përdorimit të drejtë të teknologjisë dhe mediave për krijimin dhe shpërndarjen e veprave artistike, por edhe edukimin e shijes estetike për artin që përfaqësohet në media (imazhet, muzika e mirë dhe jo e mirë, shpërndarja e muzikës përmes medimeve (e drejta autoriale, copyright etj.) por edhe aplikimi i mediave për krijim artistik (fotografia, kolazhi etj.).

## *Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm*

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale bazuar në konventat ndërkombëtare mund të jenë objekt trajtimi i veprimtarive artistike (muzikës, dramës, vallëzimit, arteve pamore dhe teknikave të ndryshme (postere, grafike, pikturë etj.).

Përdorimi i shprehjes artistike (vizatimit, posterit, këndimit, dramës etj.), për të trajtuar të drejtën e fëmijës për shkollim, për liri e jetë të dinjitetshme, për dukuritë e ndryshme (p.sh. kampanja stop duhanit, stop dhunës ndaj fëmijëve, stop luftës, etj.).

Përdorimi i shprehjes artistike dhe lëndëve artistike për të trajtuar temat e zhvillimit të qëndrueshëm (mbrojtja e ambientit, hapësirave, rregullit, lobimi për jetë të shëndetshme etj.) është një mundësi shumë e mirë e trajtimit të çështjeve ndërkurrikulare edhe e integritetit ndërlëndor. Por edhe vete përdorimi i materialeve recikluese për të bërë art, kujdesi ndaj letrës, drurit, etj., janë pjesë e punës për vetëdijesimin për ambient të shëndoshë.

## **2. Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi në fushën kurrikulare të artit kërkon kujdes të veçantë dhe mbështetet në parimin e individualizimit, ngase çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



ndryshme të shprehjes artistike. Andaj, në vlerësim duhet të përfshihet interesimi dhe prirja e nxënësit për forma të caktuar të shprehjes, kuraja, imagjinata, shprehja origjinale dhe kreative, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi etj.

Arrijet në fushën e artit janë individuale, andaj edhe duhet të vlerësohen si të tilla, duke shfrytëzuar vlerësimin për motivim dhe inkurajim të zhvillimit të aftësive të tyre krijuese.

Në art duhet të vlerësohet interesimi dhe pjesëmarrja aktive (individuale dhe në grup) në aktivitete të ndryshme artistike që organizohen në klasë, në shkollë dhe në komunitet.

Grupet e ndryshme muzikore, teatrore etj., që marrin pjesë në shfaqjet e shkollës, në ekspozitat individuale dhe grupore duhet të përfshihen në vlerësimin e nxënësve më të talentuar.

Për nxënësit më pak të talentuar duhet vlerësuar interesimi dhe guximi për të provuar angazhimin e tyre në një nga format e ndryshme të të shprehurit artistik. Vlerësohet njohja, dhe zbatimi i elementit të gjuhës artistike, faktet historike për krijuesit, veprat etj.

Edhe në këtë nivel mund të përdoren një varg instrumentesh për vlerësim, lista kontrolli, portofolio, vlerësimi i performances, teste, kuize (muzikore, vizuale), prezantime, ese etj.

### 3. Materialet dhe burimet mësimore

Artet kanë mjetet e tyre shprehëse, teknikat dhe procedurat specifike që kushtëzojnë përdorimin e materialeve të ndryshme për realizimin e përmbajtjeve nga kjo fushë kurrikulare. P.sh. në artin figurative materiali mësimor përkon me materialin e punës, si: letra, pëlhura, plastelina, materiale organike etj. Përpos materialeve, shfrytëzohen edhe burime mësimore, si: teksti shkollor, fotografitë, videoja, interneti etj.

Në artin muzikor materiali kryesor është vetë tingulli muzikor që prodhohet nga zëri i njeriut ose instrumentet muzikore. Burimet mësimore përfshijnë edhe tekstin shkollor dhe burimet tingëllore (CD-të përkatëse, cd-të muzikore, dvd-të, incizimet nga interneti, tv-të, koncertet publike etj.).



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## Matematika

Hyrje  
Qëllimi i fushës  
Konceptet e fushës dhe përshkrimi i tyre  
Rezultatet e të nxënit për fushë  
Udhëzime metodologjike  
Udhëzime për vlerësim  
Materialet dhe burimet mësimore

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## 1. Hyrje

Fusha e matematikës përkufizon arsimimin matematik<sup>4</sup> që shpjegon mbështetjet teorike të matematikës dhe organizon materien duke përshkruar mënyrën se si janë të sistemuara njohuritë, proceset dhe aftësitë themelore matematike. Në të janë të përshkruara kontekstet në të cilat nxënësi përballet gjatë të mësuarit të matematikës dhe me problemet matematike në jetën e përditshme.

Fusha kurrikulare e matematikës u mundëson nxënësve që të zhvillojnë dhe t'i avancojnë aftësitë matematike, ndërsa mësimdhënësve u jep mundësinë të gjejnë mënyrën më të mirë të mundshme që t'i nxisin nxënësit e tyre për të mësuar.

Matematika përfaqësohet si fushë dhe lëndë mësimore që është organizuar në koncepte të përgjithshme të fushës, në rezultate për shkallë kurrikulare që përshkruajnë njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet që nxënësi duhet të përvetësojë në raport me moshën. Radhitja e koncepteve matematike reflekton veçoritë e nivelit dhe shkallës, duke shërbyer si bazë për programet mësimore për klasë.

## 2. Qëllimi

Fusha matematika ka si qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë për strukturat matematikore, si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve në jetën e përditshme. Nëpërmjet fushës së matematikës synohet zhvillimi intelektual, aftësimi për të gjykuar nga këndvështrime të ndryshme, si dhe zhvillimi i imagjinatës dhe aftësisë krijuese.

Karakteristikë e mënyrës së të punuarit dhe të menduarit matematik është përdorimi i saktë i gjuhës, zhvillimi i qartë i koncepteve, të menduarit logjik, argumentimi dhe kuptimi i varësive reciproke ndërmjet dukurive e proceseve matematikore, natyrore dhe shoqërore.

Fusha e matematikës në këtë nivel promovon *zhvillim të mëtejshëm, përforcim dhe orientim* në thellimin e njohurive, kryerjen e veprimeve themelore matematikore, njohjen me figura dhe trupa gjeometrikë, përdorimin e njësive dhe nënnyësive të matjeve, grumbullimin e të dhënave, leximin dhe paraqitjen e grafikëve si dhe vendosjen e një baze të njohjes mbi probabilitetin. Bën orientimin në përdorimin e matematikës për zgjidhje të problemeve nga jeta e përditshme.

Fusha e matematikës mundëson zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, zhvillimin e personalitetit të tyre, zhvillimin e shkathtësive për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen dhe inkurajimin e ndërtimit të njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integritit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Po ashtu edhe njëri nga qëllimet e fushës së matematikës është integrimi i saj me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare përmes së cilës zotërohen kompetencat kryesore.

<sup>4</sup> Arsimiti matematik është kapaciteti i individit për të formuluar, përdorur dhe interpretuar matematikën në një shumëllojshmëri të konteksteve duke përfshirë arsyetimet, përvetësimin e koncepteve, procedurat, faktet dhe mjetet matematike për zgjidhje të problemeve.



## 3. Konceptet e fushës dhe përshkrimi i tyre

Në fushën kurrikulare të matematikës zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- numrat, algjebra dhe funksioni;
- forma, hapësira, matjet dhe gjeometria;
- përpunimi i të dhënave dhe probabiliteti.

Në shkallën e tretë dhe të katërt trajtohen përkufizimet e koncepteve themelore dhe nxjerrja e koncepteve të reja për numrat, figurat gjeometrike, pozicionin në hapësirë, matjet dhe shkathtësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve.

Secili nga këto koncepte ka të bëjë me njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, shprehjet dhe qëndrimet matematike, të cilat përdoren për arritjen e rezultateve të të nxëniet të fushës për klasë dhe shkallë si dhe zotërimin e kompetencave kryesore.

### Numri, algjebra dhe funksioni

*Numrat:* Paraqitja e numrave dhe sistemeve numerike, përfshirë vetitë dhe veprimet aritmetike me numrat e plotë dhe racionalë. Natyra dhe vetitë e këtyre veprimeve si dhe konventat e shënuara që ndërlidhen me këto veprime. Aspektet relevante të numrave irracionalë, ashtu dhe sasi të dhe njësitë që i referohen dukurive si: koha, paratë, pesha, temperatura, distanca, syprina, vëllimi, si dhe sasi të nxjerra dhe përshkrimi i tyre numerik.

*Shprehjet algjebrike:* Interpretimet verbale të shprehjeve algjebrike dhe veprimet me to, duke përfshirë numrat, simbolet, veprimet aritmetikore, fuqitë dhe rrënjët e theshta.

*Ekuacionet dhe inekuacionet:* Ekuacionet, inekuacionet lineare dhe ekuacionet e thjeshta të shkallës së dytë si dhe metodat joanalitike të zgjidhjes së tyre.

*Sistemi koordinativ:* Paraqitja dhe përshkrimi i të dhënave, pozita dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

*Funksionet:* Koncepti i funksionit jo duke u kufizuar vetëm te funksioni linear, disa lloje përshkrimesh dhe paraqitjesh të tyre, zakonisht verbale, simbolike, tabelare dhe grafike.

*Përqindja, përpjesa dhe proporcionet (përpjestimet):* Përshkrim numerik i madhësive relevante dhe përdorimi i proporcioneve dhe logjikës së proporcioneve në zgjidhjen e problemeve.

*Supozimi:* Përafrimi i sasive dhe shprehjeve numerike me qëllim, përfshirë shifrat me shenjë dhe rrumbullakësimet.

### Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria:

*Kuptimet themelore gjeometrike (pika, drejtëza dhe rrafshi):* Lidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet pikave, drejtëzave dhe rrafshit. Përshkrimi dhe shkrimi simbolik i këtyre marrëdhënieve.


*Marrëdhëniet brenda dhe në mes të objekteve dy dhe tridimensionale:* Marrëdhëniet në mes të figurave dhe trupave gjeometrikë, lidhjen në mes të elementeve të figurave (p.sh. Teorema e Pitagorës) pozita relative, ngjashmëria, kongruenca, madhësitë dinamike që përfshijnë transformimin dhe lëvizjen e objekteve.

*Matja:* Shndërrimi në kuantitet (vlerë numerike) i vetive të formave dhe objekteve si: matja e këndeve, distancës, gjatësisë, perimetrit, syprinës dhe vëllimit duke i përdorur njësitë dhe



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



njësitë e matjes.

## Përpunimi i të dhënave (statistika) dhe probabiliteti

*Variabiliteti i të dhënave dhe përshkrimi i tij:* Konceptet si ndryshueshmëria, shpërndarja dhe tendencat qendrore e grumbullimit të të dhënave si dhe mënyrat për t'i përshkruar dhe interpretuar këto në terme kuantitative.

*Popullata dhe mostra:* Konceptet e mostrës dhe marrjes së saj nga popullata, përfshirë konkluzionet e thjeshta bazuar në vetitë e mostrës.

*Grumbullimi i të dhënave, paraqitja dhe interpretimi:* Natyra, gjeneza dhe grumbullimi i të dhënave të llojevë të ndryshme si dhe mënyrat e ndryshme për t'i prezantuar dhe interpretuar ato.

*Rasti dhe gjasa:* Nocioni i ngjarjeve të zakonshme, ndryshimeve të zakonshme dhe paraqitja e tyre, rastësia dhe frekuenca e ngjarjeve si dhe aspektet bazë të konceptit të gjasës – probabilitetit.

## 4. Rezultatet e të nxënit për fushë

Rezultatet e përgjithshme për fushën e matematikës përcaktohen si shprehje të njohurisë, shkathtësive dhe qëndrimeve, të cilat nxënësi i ka përvetësuar përgjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies. Përvetësimi i përmbajeve programore nga nxënësi demonstron si njohuri relevante që atij i parashtrohen. Shkathtësitë që i demonstroi nxënësi përfshijn aftësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive të përcaktuara nëpërmjet rezultateve të planifikuara. Qëndrimet e nxënësve ndaj matematikës i vendosin ata drejt angazhimit produktiv të tyre në matematikë.

| REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS SË MATEMATIKËS PËR SHKALLËT 3 DHE 4  |   |
|---|---|
| Shkalla 3, Klasa VI, VII<br>(11-13 vjeç)  | Shkalla 4, Klasa VIII, IX<br>(13-15 vjeç) |
| <b>I. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë që zhvillohen përmes përvojave mësimore që ndërliken me formimin matematik të nxënësve:</b> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Zgjidhjen e problemeve</li><li>2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike</li><li>3. Komunikimin në/përmes matematikës/s</li><li>4. Lidhjet matematike</li><li>5. Përfaqësimin matematik</li><li>6. Promovimin e modelimit matematik</li><li>7. Strukturimin e të menduarit matematik</li><li>8. Përdorimin e TIK-ut në/për matematikë</li></ol> |   |

### 1. Zgjidhja e problemeve

Zgjidhja e problemeve matematikore është proces që zhvillon njohuritë e nxënësve në matematikë përmes detyrave që rezultati dhe procedura e zgjidhjes nuk është e njohur më parë. Nxënësi ndërton njohuri, përshkruan dhe zgjidh situata problemore që krijohen brenda matematikës dhe në kontekste nga fushat e tjera si dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme. Përzgjedh, zbaton dhe përshtat një shumëllojshmëri të strategjive të përshtatshme për të zgjidhur problemet.

Nxënësi:

1. Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.
2. Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.
3. Përdor matjet në figurat 2D (D=dimensionale) dhe në objekte 3D (prizmave) për zgjidhjen problemore.
4. Kryen vrojtime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të gatshme.

1. Përdor koncepte, simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra realë.
2. Demonstron zgjidhjen problemore që lidhen me shprehjet algebrike dhe transformime gjeometrike.
3. Përdor matjet në figurat 2D dhe në objekte 3D për zgjidhjen e problemeve.
4. Kryen vrojtime, hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.
5. Përshkruan dhe modelon matematikisht situata problemore që krijohen me numra realë, shprehje algebrike, figura 2D, objekte 3D nga lëndët e tjera dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme.

### 2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike

Arsyetimi është një proces që zhvillon aftësitë matematike të nxënësve përmes ndërthurjeve matematike, nxjerrje e përfundimeve logjike, hipoteza dhe të menduarit të tyre kritik, justifikim idesh, analizim të provave dhe ndërtim argumentesh. Nxënësve iu mundësohet përdorimi i argumenteve për arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin e aspekteve themelore të matematikës.

Nxënësi:

1. Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara
2. Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.
3. Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.
4. Sugjeron formula të ndryshme dhe përshtatshme për zgjidhje të detyrave.
5. Konstruktin dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

1. Argumenton shndërrimet, direkte dhe indirekte, të zbatuara në veprimet me numra realë, transformime gjeometrike, matje, probabilitet dhe statistikë.
2. Zhvillon dhe zbaton shprehitë arsyetimit (dallimi i marrëdhënieve, përgjithësimi me anë të induksionit, deduksione të thjeshta, përdorimi empirik i kundërshebullit).
3. Hamendëson dhe gjykon hamendësime.
4. Planifikon dhe strukturon argumente matematike për përfundimet e gjetura.
5. Përdor kundërshebullin në rastet e mundëshme.


### 3. Komunikimi në/përmes matematikës/s

Komunikimi matematik është proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t'i shprehur idetë matematike sipas rrjedhës logjike që i justifikon ato në audiencë dhe në shoqëri përmes të folurit dhe shkruarit për atë që e bëjnë me simbole, terme, grafike, modeleve dhe shprehje matematikore. Nxënësve iu mundësohet përdorimi i komunikimit nëpërmjet shenjave, të folurit të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik. Pra, për të konsideruar matematikën si pjesë të kulturës njerëzore.

Nxënësi:

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



|   |   |
|---|---|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>Demonstron zbatimin e numrave racionalë në shprehje të ndryshme numerike dhe shkronjore.</li> <li>Kryen matje për figurat 2D dhe objektet 3D.</li> <li>Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.</li> <li>Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur:             <ol style="list-style-type: none"> <li>gjuhën e përditshme; simbole matematike</li> <li>fjalorin fillestar matematik;</li> <li>paraqitje të ndryshme.</li> </ol> </li> <li>Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale;</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>Grumbullon dhe ruan informacione nga burime të ndryshme që ndërlidhen me numrat realë dhe vetitë e tyre, shprehje algjebrike, statistikë dhe probabilitet.</li> <li>Përkthen nga gjuha natyrore në atë të matematikës dhe anasjelltas.</li> <li>Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur:             <ol style="list-style-type: none"> <li>fjalorin dhe simbolet matematike;</li> <li>paraqitje të ndryshme të përshtatshme.</li> </ol> </li> <li>Krijon shumëllojshmëri të paraqitjeve me vizatime apo me përdorimin e teknologjisë, të koncepteve matematike (numerike, gjeometrike, algjebrike, grafike).</li> <li>Krijon krahasime dhe zbaton paraqitje të përshtatshme në zgjidhjen e problemeve.</li> <li>Përdor burime të ndryshme për marrjen e informacionit.</li> <li>Gjeneron konkludime të përshtatshme matematike duke grumbulluar dhe përpunuar të dhënat.</li> </ol> |
| <p><b>4. Lidhjet në matematikë</b></p> <p>Lidhja matematike është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t'i lidhë idetë dhe njohuritë matematike, brenda fushës së matematikës dhe jashtë saj. Nxënësve iu mundësohet për të njohur dhe të përdorur lidhjet e ideve matematikore, për të kuptuar se si idetë matematikore ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe për të prodhuar një tërësi koherente si dhe zbatimi i matematikës në kontekste brenda dhe jashtë fushës së saj.</p> <p>Nxënësi:</p>  |   |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.</li> <li>Integron njohuritë e shprehitë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).</li> <li>Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.</li> </ol>  | <ol style="list-style-type: none"> <li>Lidh koncepte dhe modele të reja matematike me ato të përvetësuara më parë nga fusha e matematikës dhe fushat e tjera dhe kupton formimin e tyre.</li> <li>Përdor varësitë ndërmjet koncepteve matematike mbi njëri-tjetrin, për të formuar një të tërë;</li> <li>Integron njohuritë dhe shprehitë matematike me situata ose dukuritë marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet, arti dhe kultura, ngjarjet aktuale etj.).</li> </ol>   |
| <p><b>5. Përfaqësimet matematike</b></p> <p>Përfaqësimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të përfaqësuar objektet matematikore, veprimet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, duke përfshirë numra (konstante), ndryshore (variabla) dhe forma. Përfaqëson dhe analizon situatat dhe strukturat matematikore. Nxënësve iu mundësohet për të krijuar, përdorur përfaqësitë, organizuar, regjistruar dhe komunikuar idetë matematikore, zgjidh, përkthyer dhe zbatuar përfaqësimet që kanë të bëjnë me zgjidhje të problemeve matematikore, përdorur përfaqësimet për modele dhe interpretime të fenomene, sociale natyrore dhe matematikore.</p> <p>Nxënësi:</p>   |   |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</li> </ol>  | <ol style="list-style-type: none"> <li>Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numra; kupton përdorimin e ndryshoreve për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe nga jeta e përditshme.</li> </ol>  |
| <p><b>6. Modelimi matematik</b></p> <p>Modelimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të kuptuar format, modelet në kontekste të ndryshme, marrëdhëniet dhe funksionet, paraqitjen dhe analizimin e strukturave matematikore. Nxënësve iu mundësohet për të krijuar, përdorur, paraqitur modele të ndryshme, dhe caktuar rolin e tyre në kontekst të caktuar. Nxënësit përdorin modelet për të përfaqësuar dhe për të kuptuar marrëdhëniet sasiore, interpretuar fenomenet, sociale natyrore dhe matematikore.</p> <p>Nxënësi:</p>   |   |


# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

|   |  |
|---|--|
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. Identifikon vetitë e figurave dhe objekteve të ndryshme, klasifikon figurat dhe objektet sipas këtyre vetive.</li><li>2. Krijon modele të thjeshta të figurave gjeometrike dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme.</li><li>3. Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</li></ol>  | <ol style="list-style-type: none"><li>1. Përshkruan dhe krijon modele duke përdor veprimet themelore matematikore në situata të përditshme (p.sh. të ekonomisë familjare, statistika elementare për jetën, etj.), që lidhen me numrat, figurat 2D dhe objektet 3D.</li><li>2. Kupton përdorimin e ndryshoreve për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe jeta e përditshme.</li></ol> |
| <p><b>7. Strukturimi i të menduarit matematik</b></p> <p>Të menduarit matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të parashtruar pyetje/hipoteza dhe pritjet nga përgjigjet/rezultatet e mundshme. Nxënësve iu mundësohet për t'u ndërgjegjësuar për mënyrën, formën, qasjen dhe për llojet e pyetjeve që e karakterizojnë matematikën si dhe llojet e përgjigjeve të pritshme. Nxënësi:</p>   |  |
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. Identifikon ndryshoret dhe strukturat matematike në një problem të botës reale.</li></ol>  | <ol style="list-style-type: none"><li>1. Krijon ide për zhvillimin e ndryshoreve dhe krijon struktura matematike në një problem të botës reale dhe jep supozime për të nxjerrë konkludime.</li></ol>   |
| <p><b>8. Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë</b></p> <p>Përdorimi i teknologjisë zhvillon njohuritë dhe aftësitë e nxënësve për të përmbushur rezultatet e të nxënësit të fushës së matematikës dhe ta bëjë të suksesshëm edhe përtej shkollës. Nxënësve iu mundësohet për të përdorur teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione. Nxënësi:</p>   |  |
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.</li></ol>  | <ol style="list-style-type: none"><li>2. Përdor kalkulatorin ose pajisjet tjera teknologjike për verifikimin e saktësisë së zgjidhjeve matematikore.</li><li>3. Përdor kompjuterin dhe programet e nevojshme aplikative për hulumtime dhe për gjetjen sa më të shpejtë të zgjidhjes së problemeve nga lëmi të ndryshme matematikore (algjebra, gjeometria, statistika, etj.).</li></ol>  |
| <p><b>II. Qëndrimet dhe vlerat e strukturuar nga arsimimi përmes matematikës</b></p>  |  |
| <p>Gatishmëria për të angazhuar në matematikë - ka të bëjë me qëndrimet emocionale dhe besimit personal që e shpie nxënësin drejt përfitimit.</p> <p>Formimet relevante në këtë fushë janë përfshirë te:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kurioziteti;</li><li>• Motivimi për mësim;</li><li>• Imagjinatat në kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;</li><li>• Insistimi, këmbëngulja dhe fuqia në fokusimin e problemeve;</li><li>• Pavarësia në mendime dhe veprime;</li><li>• Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme;</li><li>• Organizimi i të menduarit;</li><li>• Besimi në forcat vetjake;</li><li>• Besimi në përdorimin e teknologjisë;</li><li>• Dëshira për njohuri matematike;</li><li>• Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit;</li><li>• Kritikta konstruktive;</li><li>• Pavarësia në mendime;</li><li>• Gatishmëria për bashkëpunim;</li><li>• Prania e kritikave dhe gatishmëria për kritika konstruktive;</li><li>• Gatishmëria për gara fer;</li><li>• Kuraja për të kërkuar përkrahje/ndihmë;</li><li>• Qëndrimi i hapur ndaj përkrahjes së të tjerëve;</li><li>• Qëndrimi ndaj pyetjeve dhe kërkesave;</li><li>• Vullneti;</li><li>• Toleranca;</li><li>• Respekti për saktësinë, përpjekjet personale dhe ato në grup.</li></ul> |  |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## III. Aftësitë dhe shkathtësitë matematike

- Identifikim;
- Përshkrim;
- Zbatim;
- Njehsim;
- Matje;
- Vlerësim;
- Skicim;
- Krijim modelesh;
- Qasja e problemeve nga perspektiva të ndryshme.

IV. Njohuritë dhe konceptet që promovohen nga fusha e matematikës: (numrat, algjebra dhe funksioni, forma, hapësira, matja dhe gjeometria, përpunimi i të dhënave dhe probabiliteti).

- Numrat racionalë, iracionalë dhe numrat real;
- Veprimet themelore me numra realë;
- Ekuacionet, inekuacionet dhe funksionet;
- Shprehjet numerike dhe shkronjore;
- Kuptimet themelore gjeometrike (pika, drejtëza dhe rrafshi);
- Forma e figurave të rregullta (trekëndëshi, paralelogramet, trapezi, deltoidi, shumëkëndëshat e rregullt dhe rrethi);
- Shndërrimet gjeometrike;
- Hapësira – objektet gjeometrike dhe trupat e rregullt gjeometrikë (kubi, kuboidi, piramida, prizma, cilindri, koni dhe sfera);
- Matjet (e gjatësisë, perimetri, syprina dhe vëllimi), figurave të rrashta dhe vëllimi i trupave;
- Të dhënat (elemente bazë të statistikës) grumbullimi dhe përpunimi, interpretimi, mostra, prova, tendencat qendrore.

## 5. Udhëzimet metodologjike

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallë, me bazën didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes.

Mësimdhënësi është i lirë të përdor metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodatat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, të jenë në funksion të arritjeve të rezultatit të të nxënësve dhe të zbatimit në jetën e përditëshme.

*E tërë kjo kërkon nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me nevojat e nxënësve si:*

- zotërimi i kompetencave kryesore të të nxënësve përmes matematikës;
- lidhja e matematikës në ruajtjen e koherencës vertikale dhe horizontale të saj;
- zbatimi praktik i matematikës, brenda dhe jashtë klasës me situata të jetës reale;
- formimin dhe forcimin e aftësive matematikore bazuar në hetimin;
- zgjidhja e problemeve dhe shumëllojshmëria e strategjive për zgjidhjen e tyre;
- veçoritë e punës individuale, në ekip dhe grup;
- përdorimi i burimeve të shumëllojshme të informacionit (nga librat dhe interneti);
- të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- qëndrimi pozitiv ndaj lëndës së matematikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj në gjitha fushat duke përfshirë edhe arsimin për zhvillim të qëndrueshëm;
- nxitjen e bashkëveprimit mësimdhënës-nxënës, nxënës-nxënës duke pasur parasysh gjithëpërfshirjen.



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

*Matematika dhe mësimdhënia e saj duhet të ketë parasysh të zhvillojë edhe çështjet ndërkurrikulare përmes temave që janë në interes për shoqërinë për një ndikim në formimin e personalitetit të nxënësit:*

- zhvillim personal dhe shkathtësi për jetë, për një edukim qytetar, që matematika i ofron përmes temave të ndryshme si zgjedhjet, forma e eksponatave kulturore, vendimmarrja, planifika i buxhetit etj.;
- zhvillim për edukim për paqe, arrihet përmes temave që paraqesin shkakun dhe pasojnë me ndikim në tolerancë, barabarësi, menaxhimi i burimeve natyrore dhe ato shoqërore në zgjidhjeve e problemeve;
- krijim të një kulture të punës në grupe përmes temave dhe projekteve si mbërojtja e ambientit, ekonomia familjare, shëndeti, ndikimi i teknologjisë, zhvillimi ekonomik i vendit sigurohet përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore e biologjike etj.;
- formim personal për përdorim të mediave të shkruara dhe ato digjitale në sigurimin e informatave relevante, krahasimi i të dhënave, komunikimi dhe arsyetimi i problemeve.
- formimi personal në arsim për zhvillim të qëndrueshëm, me ndikim në ndryshimet klimatike, në ngrohjen globale, në llojlojshmëri biologjike, dhe zhvillimi i teknologjisë përmes vetëdijesimit ekonomik, përfshirjes sociale, demografike dhe migrimit, mësimi elektronik, krijimit të modeleve, shembuj problemesh për mjedisin, energji e pastër, ambientit, popullacioni dhe ekosistemi, problemi i ruajtjes së shëndetit dhe varfëria globale.

## 6. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi si proces përfshin qëllimin, planifikimin, mbledhjen, sistemimin, evidentimin dhe raportimin e informacioneve që shërbejnë për të gjykuar mbi arritjen e rezultateve të të nxënësit. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi, duhet të ketë parasysh rezultatet e të nxënësit për klasë dhe arritjen e rezultateve për këtë shkallë. Po ashtu ai duhet ta konsiderojë vlerësimin si pjesë të pandashme të mësimi, t'i angazhojë nxënësit në procesin mësimor dhe t'i aftësojë ata për punë të pavarur.

Në këtë nivel, vlerësimi duhet të përqendrohet në matjen për marrjen e gjykimeve në përvetësimin e nocioneve dhe koncepteve bazë të matematikës.

Gjatë vlerësimit mësimdhënësi është i pavarur në zgjedhjen e llojeve, metodave dhe instrumenteve të vlerësimit, gjithmonë duke i pasur parasysh parimet dhe kriteret e vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë në funksion të sigurimit të informatave kthyes/ raportimit me qëllim të përmirësimit të të nxënësit, motivimit të nxënësve për nxënie, të përcaktojë shkaqet e ngecjes apo të përparimit, përmirësimit të mësimdhënies dhe të zhvillimit individual të nxënësit.


## 7. Materialet dhe burimet mësimore

Gjatë mësimi të matematikës mësimdhënësi, gjeneron dhe transferon informacione duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësi gjeneron informacione duke iu qasur të mësuarit përmes të pamurit, të dëgjuarit, të lexuarit, të prekjes etj. Po ashtu mësimdhënësi gjatë transferimit të informacione përdor gjuhë të pastër, fjalë dhe fjali të sakta, njëkuptimore, mjete vizuale, teknologji të nevojshme, vizatime, modelime, jep ndihma të veçanta, adapton shembuj të ndryshëm, krijon ambient për aktivitete alternative etj. E gjithë kjo nënkupton se ai/ajo siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve adekuate që përkon me moshën dhe mundësinë e nivelit të të nxënësit të nxënësve.

Mësimdhënësi u ofron mundësi nxënësve që të krijojnë, modelojnë dhe prazantojnë materiale të ndryshme mësimore.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## Shkencat e natyrës

Hyrje

Qëllimet e të mësuarit të shkencave

Konceptet themelore të fushës Shkencat e natyrës dhe përshkrimi

Rezultatet e të nxënit e fushës Shkencat e natyrës

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

## 1. Hyrje

Fokusi kryesor i të mësuarit të shkencave të natyrës është thellimi i të kuptuarit të koncepteve dhe ideve përmes lëndëve kimi, biologji dhe fizikë. Kjo u ndihmon nxënësve që t'i kuptojnë ndërlidhjet mes këtyre lëndëve dhe koncepteve për t'i argumentuar dukuritë shkencore si tërësi dhe ndikimin e tyre në funksionimin e shoqërisë dhe të natyrës.

Nxënësit duhet t'i zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë dhe shkathtësitë për dijet, metodat, proceset për përdorimin të arriturave shkencore në jetën e përditshme. Ata inkurajohen të kuptojnë se si shkenca mund të përdoret për të shpjeguar se çka ka ndodhur rreth tyre si dhe t'i analizojnë shkaqet dhe pasojat.

Fusha kurrikulare *Shkencat e natyrës* ndihmon zhvillimin e integruar të kompetencave, të cilat ndihmojnë përgatitjen e nxënësve në aspektin social, shëndetësor e ekonomik dhe që lidhen me çështje të ndryshme në nivel kombëtar dhe global.

## 2. Qëllimet

*Qëllimet e të mësuarit të shkencave të natyrës janë:*

- Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes eksplorimit të proceseve njerëzore, natyrore dhe fizike në mjedis.
- Zhvillimi i qasjes shkencore në zgjidhjen e problemeve e cila ndihmon të kuptuarit dhe të menduarit kritik e krijues.
- Inkurajimi i nxënësve të eksplorojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë idetë dhe konceptet shkencore përmes disajnit dhe aktiviteteve praktike.
- Inkurajimi i nxënësve të vlerësojnë kontributin e shkencës dhe teknologjisë në mjekësi, ekonomi, kulturë dhe dimensione të tjera në shoqëri.
- Kultivimi i kujdesit dhe respektit për diversitetin e qenieve të gjalla dhe jo të gjalla, varësinë dhe bashkëveprimin mes tyre.
- Inkurajimi i nxënësve të sillen me përgjegjësi për të mbrojtur, përmirësuar dhe dashur mjedisin duke u involvuar në identifikimin, diskutimet dhe aktivitetet për problemet mjedisore që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
- Gatishmëria e nxënësve të komunikojnë idetë, prezantojnë punën dhe raportojnë të gjeturat e hulumtimeve përmes medieve të ndryshme.
- Zotërimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për grumbullimin, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave gjatë hulumtimeve në shkenca.

## 3. Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre

*Konceptet e përgjithshme të fushës shkencat e natyrës janë:*

1. Materia, vetitë dhe shndërrimet
2. Proceset fizike
3. Bota e gjallë
4. Toka, mjedisi dhe gjithësia


### **Materia vetitë dhe shndërrimet**

Nënkuptojnë njohjen, përshkrimin, klasifikimin dhe krahasimin e objekteve, trupave, lëndëve të



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



cilat i rrethojnë në bazë të strukturës përbërjes, formës, madhësisë, ngjyrës, gjendjes agregate dhe shëndërimeve kimike;

## Proceset fizike

Kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e llojeve të ndryshme të lëvizjeve, të ligjeve të bashkëveprimit të forcave në mekanikë, të punës, të energjisë dhe ruajtjes së saj, të fuqisë, të punës dhe nxehtësinë së gazeve, të lëkundjeve, të valëve dhe zërit, të ligjeve të elektricitetit, të magnetizmit, të burimeve të dritës dhe strukturës së lëndës, me qëllim të shfrytëzimit në jetën e përditshme.

## Bota e gjallë

Ka të bëjë me proceset jetësore që përfshijnë dallimin dhe shpjegimin e njohurive për biodiversitetin si kompleks, përshtatshmëritë dhe llojllojshmërinë, lidhjen strukturore dhe funksionale të komponenteve të ekosistemit, të kuptuarit e faktorëve të ekologjikë, sjelljet e organizmave në mjedisin e tyre jetësor, riprodhimi i organizmave të gjallë, roli i njeriut në ekosistem.

## Toka, mjedisi dhe gjithësia


Nënkupton njohjen dhe shpjegimin e gjeocentrizmit dhe heliocentrizmit, (Ptolemeu, Koperniku, Kepleri dhe Njutoni) të lëvizjes së dukshme të Diellit nëpër ekliptikë dhe rrjedhojat e kësaj lëvizje, të lëvizjes së dukshme dhe të vërtetë të planeteve rreth Diellit, të ligjeve të lëvizjes së vërtetë të trupave të sistemit diellorë, të pozitës së Diellit në Galaktikë dhe largimin reciprok të galaktikave.

## 4. Rezultatet e të nxënit

| SNKA / ISCED 2   |   |   |
|--|---|---|
|  | Shkalla 3, Klasa VI,VII (mosha 12-13 vjeç)  | Shkalla 4, Klasa VIII, IX (mosha 14-15 vjeç)  |
| <b>I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËRMES PROCESIT TË TË NXËNIT:</b>   |   |   |
| <p>1. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë</p> <p>2. Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike në Tokë dhe Gjithësi)</p> |   |   |
| <p><b>1. Shkathtësitë hulumtuese në shkenca</b></p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>I kushton kujdes saktësisë, precizitetit dhe produktit gjatë punës.</li> <li>Ofron hipoteza të bazuara në një numër vëzhgimesh dhe të dhëna të vlefshme</li> <li>Propozon ide ose teori të thjeshta të cilat mund të demonstrohen me eksperimentet.</li> <li>Grumbullon informata dhe të dhëna nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë klasës dhe nga TIK-u.</li> <li>Zabton rregullat e sigurisë gjatë punës praktike (duke përfshi edhe shenjat e rrezikut).</li> <li>Prezanton shpjegime të arsyeshme, duke përfshi të dhënat nga parashikimet dhe hipotezat.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerëson rrezikun para fillimit të punës praktike nga mjedisi dhe mjetet të cilat i përdorë.</li> <li>Planifikon dhe kryen eksperimente të thjeshta me dy-tre ndryshore (variabla) dhe i kontrollon ato për të arritur rezultatet e detyrës.</li> <li>Identifikon mënyra të ndryshme të qasjes së problemit dhe krahason rezultatet e provave të ndryshme.</li> <li>Përdor koncepte matematike për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve.</li> <li>Prezanton konkluzionet e hulumtimit/eksperimentit duke i arsyetuar me dëshmi të mjaftueshme.</li> </ul> |
| <p><b>2.1. Materia, vetitë dhe shndërrimet</b></p>   | <p>Dallon dhe klasifikon lëndët sipas përbërjes, strukturës, vetive fizike dhe kimike, shndërrimeve dhe përdorimit të tyre në jetën e përditshme.</p>   | <p>Përshkruan dhe analizon elementet kimike që hyjnë në përbërjen e komponimeve inorganike dhe organike, strukturën e këtyre komponimeve, vetitë fizike e kimike, funksionimin dhe ndërlidhjen e tyre në botën e gjallë dhe jo të gjallë dhe ndikimin e tyre afatgjatë në mjedis</p>  |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



|  |  |   |
|--|--|---|
| <b>2.2. Bota e gjallë</b>                | <p>Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</p> | <p>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke ju referuar biodiversitetit të qenjeve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</p> |
|  | <p>Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësor të njeriut.</p>  | <p>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</p>   |
| <b>1.3 . Proceset fizike</b>             | <p>Përshkruan vetitë e lëndës, lëvizjen, forcat e bashkëveprimit energjinë dhe shndërrimet e saja, ligjet e ruajtjes, lëvizjen kinetike dhe termike me qëllim të ngritjes së njohurive shkencore.</p>  | <p>Shpjegon burimet e energjisë, format dhe shndërrimet e valëve mekanike, të zërit, ligjeve elektrike dhe magnetike, burimeve të dritës, relativitetit të levizjeve, strukturës së bërthamës, radioaktivitetit të saj, me qëllim të shfrytëzimit të tyre në jetën e përditshme.</p>  |
| <b>1.4 . Toka, mjedisi dhe Gjithësia</b> | <p>Shpjegon përbërjen e litosferës, hidrosferës, atmosferës, biosferës, proceset në to dhe ndërrimet e thjeshta të pozitës së trupave gjatë kohës.</p>   | <p>Analizon përbërësit e ndërtimit të kores së Tokës, resurset natyrore e në veçanti ato të Republikës së Kosovës dhe lidhshmërinë hapësirë-kohë, tregon lëvizjen e dukshme dhe të vërtetë, ndërtimin e sistemit diellor dhe të galaktikave.</p>  |

### III. Qëndrimet dhe vlerat e strukturuar nga arsimimi përmes fushës Shkencat natyrore

Nxënësi pritet të manifestojë:


- Qëndrim pozitiv për studimin shkencor në përgjithësi.
- Tolerancë ndaj opinionëve të shprehura nga të tjerët.
- Kureshtje për simulim dhe modelim të dukurive natyrore përmes eksperimentit.
- Motivim për studimin e shkencës si fushë e rëndësishme në jetën shoqërore dhe profesionale.
- Iniciativë dhe interesim për t'iu qasur detyrave të ndryshme.
- Interesim për përdorimin e koncepteve dhe metodave specifike shkencore në zgjidhjen e problemeve shkencore në jetën e përditshme.
- Kujdes për kualitetin dhe ruajtjen e mjedisit.
- Të menduarit kritik dhe pozitiv, ndershmëri dhe tolerancë.
- Interesim në zbatimin e dijes në jetën e përditshme.
- Interesim për arritjet e reja dhe përparimet në shkencë.
- Respekt ndaj diversitetit natyror dhe njerëzor, ruajtje dhe mbrojtje të mjedisit

### IV. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË NË SHKENCAT NATYRORE

- Identifikim
- Përshkrim
- Formulim
- Arsyetim
- Zbatim
- Njehsime
- Matje
- Skicime
- Krijim modelesh
- Ndërtim
- Përdorim burimesh dhe informacionesh
- Shkathtësi bashkëpunimi
- Shkathtësi komunikimi
- Aftësi psikomotorike
- Kreativitet
- Shkathtësi të mendimit kritik
- Shkathtësi në teknologji të informatikës
- Shkathtësi numerike
- Shkathtësi të zgjidhjes së problemeve
- Shkathtësi menaxhimi
- Shkathtësi studimi

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



|  |  |
|--|--|
|  | <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>V. KONCEPTET DHE LËNDËT E FUSHËS SHKENCAT NATYRORE</b></li></ul>  |
|  | <ul style="list-style-type: none"><li>• Shkenca natyrore</li><li>• Kimi</li><li>• Fizikë</li><li>• Biologji</li><li>• Gjeografi</li><li>• Gjeologji</li><li>• Astronomi</li><li>• Reaksione kimike</li><li>• Eksperiment</li><li>• Laborator</li><li>• Acide</li><li>• Baza</li><li>• Kripëra</li><li>• Okside</li><li>• Diversitet</li><li>• Evolucion</li><li>• Trashëgimi</li><li>• Ekosisteme</li><li>• Atom</li><li>• Molekulë</li><li>• Jone</li><li>• Strukturë</li><li>• Funksion</li><li>• Lidhje kimike</li><li>• Kohë</li><li>• Hapësirë</li><li>• Sistem</li><li>• Fotosintezë</li><li>• Ligje</li><li>• Hipoteza</li><li>• Teori</li><li>• Parime</li></ul> |

## 5. Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare po ashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënit për fushë (RNF-të) – Shkencat e natyrës, gjegjësisht rezultatet lëndore (RNL) – paraqesin jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve por edhe për përzgjedhjen e metodologjive duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacioni i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike e të tjera.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore, të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera për të përballur sfidat jetësore.

Shkencat e natyrës janë shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

*Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:*

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënës në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënës përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura. Çështje ndërkurrikulare

Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare në fushën e shkencave të natyrës i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

## 6. Mësimdhënia dhe të nxënës e integruar

**Integrimi i koncepteve të përbashkëta në shkencat natyrore (biologji, kimi, fizikë):**

- lënda dhe energjia në zhvillimin e jetës, interpretimi i proceseve dhe dukurive natyrore dhe ndikimi i tyre te njeriu, qeniet e gjalla dhe në mjedis, shndërrimet e lëndës, ndërveprimet mes lëndës, trupave dhe qenieve të gjalla, atomet, molekulat, ligji i ruajtjes së masës dhe energjisë, tretësit, fotosinteza, frymëmarrja, ushqimi i shëndetshëm.

**Integrimi në metodën shkencore hulumtuese:**

- vëzhgimi, klasifikimi, matja, modelimi, parashtrimi i hipotezës, eksperimenti, prova, përdorimi i instrumenteve për matje, planifikimi dhe projektimi i hulumtimeve të thjeshta shkencore, përpunimi i rezultateve, siguria gjatë punës në laborator.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## Ndërlidhja e shkencave natyrore me fushat e tjera

-Shkencat e natyrës jo vetëm se janë të ndërlidhura në mes veti, meqë e studiojnë natyrën në aspekte të ndryshme, por janë të ndërlidhura edhe me fushat tjera sudimore, veçanërisht me gjuhët në funksion të ndërtimit të terminologjisë dhe komunikimit.

### - Komunikimi dhe të shprehurit

-Komunikon në gjuhë amtare dhe në gjuhë të huaja gjatë punës në grup, pasuron fjalorin e gjuhës me shprehje e simbole të reja përmes diskutimit, raporteve me shkrim, të punëve praktike, hulumtimeve dhe matjeve.

## Matematika

-Përdor formulat, për vendosje të raporteve në mes madhësive që e karakterizojnë natyrën për dukuri të caktuar si dhe për ndërtimin e modeleve dhe njehsimit të rezultateve të fituara gjatë matjeve eksperimentale në shkenca të natyrës.

## Shoqëria dhe mjedisi

- Trajton mjedisin natyror-shoqëror si një pasuri, e cila duhet të ruhet dhe të shfrytëzohet për të mirat e shoqërisë.

## Shëndeti dhe mirëqenia

-Mbron shëndetin duke respektuar rregullat e higjienës, të ushqimit, të lëvizjeve trupore dhe të organizimit të pushimit dhe vetëdijesohet për t'u mbrojtur nga alkooli, duhani, drogat, HIV/AIDS dhe nga shtatzënia e padëshiruar.

## Jeta dhe puna

-Respekton parimet e punës në grup dhe bashkëpunon në mënyrë aktive në arritjen e objektivave të përcaktuara duke shfaqur shkathtësi manovruese në përdorimin e veglave, pajisjeve dhe teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të marrë informacione gjatë hulumtimeve.

## 7. Temat ndërkurrikulare

*Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:*

- Edukimi për medie;
- Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm

## 8. Edukimi për media

I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur me publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë



në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

## 9. Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/ nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si: aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor. Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

### 6. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në rezultatet e të nxënësve të programit lëndor dhe shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në shkencat e natyrës.

Metodat e vlerësimit që duhet të përdoren në shkencat e natyrës:

- Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)
- Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës),
- Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale
- Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte
- Vlerësimi i portfolios
- Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore
- Vlerësimi i detyrave të shtëpisë

Vlerësimi i nxënësve për të gjitha format e lartshënuara mund të realizohet edhe në formë elektronike.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore, për shkak të specifikave që ka fusha, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere, i hartuar nga vetë mësimdhënësit, në harmoni me planin zhvillimor të shkollës, me vendimmarrjen e DKA-ve dhe me politikat e MASHT-it.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktiviteti profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit).

### 7. Materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave dhe koncepteve kryesore në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

Si burim i informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj.), interneti (materiale tekstuale, fotografi, programe interaktive, video etj.), enciklopedi, atlase etj.


Për të rritur interesimin dhe kureshtjen e nxënësve është e domosdoshme të përdoren mjete të ndryshme si: tabelë shkrimi, tabela interaktive, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike, televizori, videoprojektori, kompjuteri, telefoni, tableti etj.

Për arritje të rezultateve në shkencat e natyrës është e domosdoshme sigurimi i mjedisit të përshtatshëm mësimor. Sipas mundësive përveç klasës, mësimi duhet të zhvillohet edhe në mjedise të tjera (laborator, punëtori, natyrë, ferma etj.).



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## Shoqëria dhe mjedisi

Hyrje

Qëllimi

Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre

Rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

## 1. Hyrje

Fusha kurrikulare *Shoqëria dhe mjedisi* në nivelin e dytë, realizohet përmes mësimit lëndor. Lëndët mësimore të kësaj fushe në këtë nivel janë: historia, gjeografia dhe edukata qytetare. Meqenëse kjo fushë realizohet përmes mësimit lëndor, mësimeve duhet t'i kenë parasysh qëllimet e përbashkëta të fushës, të cilat do të realizohen përmes përmbajtjeve lëndore duke synuar mësimin e integruar. Fusha *Shoqëria dhe mjedisi* i ndihmon nxënësit për të njohur dhe për të kuptuar më mirë konceptet, proceset dhe zhvillimet historike në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe botëror, duke përfshirë lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve të ndryshme si dhe ngjarjet dhe personalitetet e rëndësishme nga kohët më të lashta deri më sot. Kjo fushë ndihmon nxënësit për të thelluar njohuritë mbi vendet dhe hapësirën, sistemet fizike e humane, rajonet dhe karakteristikat e tyre. Gjithashtu, ndihmon krijimin e shprehive, vlerave dhe qëndrimeve në raport me diversitetin kulturor, identitetin social trashëgiminë kulturore dhe natyrore, organizimin shoqëror, liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe rolin dhe funksionimin e institucioneve demokratike.

## 2. Qëllimi

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi*, në shkallën e tretë dhe të katërt kurrikulare, ka për qëllim zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve, për të qenë qytetar i përgjegjshëm, për të zhvilluar identitetin personal dhe për të njohur më mirë atë kolektiv (social, kombëtar, shtetëror, etnik, fetar, racor, gjinor, kulturor, regjional). Kjo fushë ndihmon zhvillimin e aftësive për të gjykuar drejt dhe për të marrë vendime të përgjegjshme në jetën e përditshme, kultivimin e shprehive dhe marrjen e nismave për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi* në këtë nivel ndihmon nxënësit për të zhvilluar e për të përforcuar më tej njohuritë e tyre duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik dhe orientim në karrierë.

## 3. Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre

*Konceptet e përgjithshme të kësaj fushe janë:*

1. Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore
2. Proceset shoqërore dhe natyrore
3. Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë
4. Vendimmarrja dhe institucionet
5. Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Në këtë nivel konceptet e përgjithshme të fushës zërthehen më gjerësisht dhe në nivel më të thelluar.

### 1. Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore

Ky koncept përfshin njohuritë për rolin e individit si dhe për strukturat dhe marrëdhëniet e grupeve shoqërore. Gjithashtu përfshin edhe zhvillimin e aftësive dhe shprehive të nxënësit për rol aktiv në ndërtimin e raporteve të qëndrueshme shoqërore, si në familje, në grup shoqëror, ashtu edhe në bashkësi dhe në shoqëri në përgjithësi.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## 2. Proceset shoqërore dhe natyrore

Ky koncept përfshin njohuritë për proceset, fenomenet e dukuritë shoqërore e natyrore, zhvillimet dhe ndryshimet në të kaluarën dhe në të tashmen në vend, në rajon dhe në botë.

Koncepti përfshin edhe njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet lidhur me ecuritë e popullsisë, vendbanimeve, migrimëve, proceset socio-ekonomike, si dhe diversitetit kulturor dhe natyror, komunikimit kulturor, teknologjisë dhe çështjeve të globalizmit.

## 3. Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohuritë për normat dhe rregullat shoqërore në mjedisin jetësor si dhe bashkëveprimet njeri-mjedis. Gjithashtu ky koncept, në këtë nivel, përfshinë edhe njohuritë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e tyre, përgjegjësinë ndaj vetes, ndaj familjes, ndaj shkollës, ndaj rrethit ku jeton dhe më gjerë. Kjo nënkupton edhe vetëdijesimin për barazinë gjinore, tolerancën, mirëkuptimin, solidaritetin, reagimin ndaj dukurive negative (diskriminimi, paragjykimi, etj.) nevojën për bashkëpunim dhe komunikim me të tjerët.

## 4. Vendimmarrja dhe institucionet

Ky koncept, në këtë nivel, përfshin njohuritë për kompleksitetin e vendimmarrjes personale, grupe e institucionale, dikur dhe aktualisht, si dhe kultivimin e vetëbesimit, përgjegjshmërisë dhe arsyeshmërisë së vendimmarrjes në rastet e caktuara duke u mbështetur në informata, ide dhe argumente të qëndrueshme. Në këtë kuadër hyjnë dhe njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet për rëndësinë e vendimmarrjes së drejtë e të argumentuar, të dobishme për individin dhe për mjedisin shoqëror e natyror, duke mundësuar kultivimin e bashkëndjenjës për proceset shoqërore dhe mjedisore.

## 5. Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Kjo tërësi përfshin njohuritë më të thelluara për raportin e njeriut dhe mjedisit jetësor, lidhjet dhe ndikimet e tyre reciproke, shkaktarët që ndikojnë në dëmtimin e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij. Gjithashtu, përfshin edhe njohjen dhe vetëdijesimin lidhur me gjeosferat, resurset, ekosistemet, biodiversitetin, nevojën e ruajtjes së mjedisit, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm (sociale, ekonomike dhe ambientale).


Ky koncept përfshin edhe njohuritë mbi hapësirën (Tokën dhe Sitemin Diellor), dukuritë dhe proceset natyrore dhe socio-gjeografike, të regjioneve, si dhe njohuritë për monumentet e trashëgimisë natyrore e kulturore dhe kujdesin për to.

## 4. Rezultatet e të nxënit

| Shoqëria dhe mjedisi<br>SNKA / ISCED 2  |   |
|---|---|
| Shkalla 3, Klasa VI, VII (11-13 vjeç)   | Shkalla 4, Klasa VIII, IX (13-15 vjeç)  |
| <p><b>I. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathhtësitë përmes të cilave nxënësi:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Njeh strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to.</li> <li>Hulumton objektet, dukuritë, proceset historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre.</li> <li>Kupton dhe mëson të zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.</li> <li>Përfshihet në dhënien e ideve, propozimeve dhe merr vendime në mënyrë të përgjegjshme.</li> <li>Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.</li> <li>Shfrytëzon në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) dhe teknologjitë tjera bashkëkohore.</li> </ol> |   |
| <p>1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to</p>  |   |
| <p>1.1. Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.</p> <p>1.2. Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.</p> <p>1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimt, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.</p>  | <p>1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.</p> <p>1.2. Dallon faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë).</p> <p>1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.</p> |
| <p><b>2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p>  |   |
| <p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasë parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>   | <p>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.</p> <p>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik te një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti</p>  |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



|   |   |
|---|---|
| <b>3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</b>   |   |
| <p>3.1. Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p> <p>3.2. Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p>                                       | <p>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme</p> <p>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm,</p> |
| <b>4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</b>  |   |
| <p>4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme</p> <p>4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p> | <p>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.</p> <p>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</p>  |
| <b>5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm</b>  |   |
| <p>5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.</p> <p>5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.</p>  | <p>5.1. Prezanton shembuj se si, si një individ dhe si një anëtar i një grupi, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.</p>   |
| <b>6. Përdor në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore</b>   |   |
| <p>6.1. Përzgjedh dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve digjitale që kanë të bëjnë me raportet shoqërore dhe dukuritë natyrore e mjedisore.</p> <p>6.2. Përdor teknologjinë adekuate për moshën për të prezantuar idetë e tij para të tjerëve.</p>   | <p>6.1. Kategorizon dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve mediale për të analizuar ngjarje shoqërore e historike si dhe dukuri gjeografike e mjedisore.</p> <p>6.2. Përdor teknologjinë për prezantime të ndryshme që kanë të bëjnë me çështje shoqërore, historike, natyrore e mjedisore.</p>   |
| <b>II. Qëndrimet dhe vlerat e strukturuar nga arsimimi përmes fushës Shoqëria dhe mjedisi</b>   |   |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Respekti për të tjerët</li> <li>▪ Vetërespekti</li> <li>▪ Bashkëndjenja - empatia</li> <li>▪ Barazia</li> <li>▪ Toleranca</li> <li>▪ Gjykimi i drejtë</li> <li>▪ Bashkëpunimi</li> <li>▪ Mirëkuptimi</li> </ul>  |   |

### III. Aftësitë dhe shkathtësitë e fituara nga fusha Shoqëria dhe mjedisi

- Përdorimi i informacioneve
- Hulumtimi i thjeshtë
- Shfrytëzimi i burimeve të thjeshta
- Përdorimi i skicës , planit, hartës, globit dhe busollës
- Grumbullimi dhe dokumentimi informacioneve
- Zbatimi i fjalorit të mësuar
- Ndërtimi dhe leximi i grafikëve, diagrameve, tabelave dhe hartave
- Përcaktimi i vendndodhjes në hapësirë, harta, atlase dhe glob i vendeve dhe rajoneve
- Formulimi i pyetjeve të thjeshta për të marrë informacion
- Evidentimi i ngjashmërive dhe ndryshimeve
- Realizimi i matjeve të elementeve klimatike dhe elementeve në harta
- Analiza e të dhënave numerike, tekstuale dhe grafike.

### IV. Konceptet specifike të fushës Shoqëria dhe mjedisi

|               |                      |               |                     |                    |                       |
|---------------|----------------------|---------------|---------------------|--------------------|-----------------------|
| Shoqëria      | Iluminizëm           |               |                     |                    |                       |
|               | Ligje                | Meridiane     | Relievi             | Resurset           |                       |
| Individi      | Toleranca            | Popullsia     | Mot                 | Tërmet             | Burim                 |
| Shteti        | Kronologjia          | Paqe          | Orientimi           | Erozion            | Lumë                  |
| Mbretëria     | Dëshmia              | Rregulla      | Busulla             | Nataliteti,        | Oqean                 |
| Republika     | Koha e gurit         | Kolonializëm  | Vendi/Hap-ësira     | Gjinia             | Erë                   |
| Koha          | Koha e metaleve      | Kryqëzata     | Harta               | Mortaliteti        | Det                   |
| Antikitët     | Dyndje e popujve     |               |                     |                    |                       |
|               | Lufta e Madhe        | Atlasi        | Migrimi             | Liqen              |                       |
| Liria         | Revolucion           | Familja       | Gjeosfera           | Shkretëtirë        | Valë                  |
| Barazia       | Abolicionizëm        | Institucionet | Klimë               | Akullnajë          | Salanitet             |
| Demokracia    | Absolutizëm          | Komunikimi    | Gjerësi gjeografike | Baticë dhe zbaticë | Faunë                 |
| Mesjeta       | Parlamentarizëm      | Qeverisje     | Toka                | Vullkan            | Planifikimi hapësinor |
| Totalitarizëm | Qytetari demokratike | Paralele      | Gjatësi gjeografike | Vendbanimi         | Akumulim              |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## 5. Udhëzime metodologjike

Për të realizuar qëllimet e Kurrikulës përmes fushës Shoqëria dhe mjedisi preferohet përdorimi i metodave të ndryshme që e plotësojnë njëra-tjetrën dhe që mundësojnë zhvillimin e mendimit kritik e kreativ të nxënësi, për zbatimin e njohurive në situata të ndryshme.

Mësimdhënësi është i lirë të zgjedhë metodologjinë e punës duke vlerësuar drejt kushtet, rrethanat dhe mundësitë të cilat i ka në dispozicion. Duke u bazuar në udhëzimet e KK-së, duhet të marrë parasysh mësimin e bazuar në arritjen e kompetencave, mësimin me nxënësin në qendër, gjithëpërfshirjen, mësimin e diferencuar, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënës si dhe Mësimin e Bazuar në Projekte (MBP), i cili zhvillon shkathtësitë praktike të parashtruara në KK.

*Sa i përket metodologjisë për këtë fushë dhe për këtë nivel, sugjerohet shfrytëzimi:*

- I intervistës dhe historisë gojore (rrëfimet, kujtimet) për mbledhjen e të dhënave për ngjarjet, vendet, personalitetet dhe mënyrën e jetesës. Këto rrisin shkathtësinë e përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit.
- I debatit sepse krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese, socializim.
- Vrojtimi dhe kontakti i drejtpërdrejtë me mjedisin dhe natyrën, organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve zhvillojnë te nxënësit aftësitë e hulumtimit dhe vëzhgimit, interpretimit dhe diskutimit për dukuri të ndryshme natyrore dhe mjedisore.
- Shfrytëzimi racional i TIK-ut nga nxënësi në bashkëpunim ose sugjerim të mësimdhënësit dhe prindit ndihmon në kompletimin e marrjes së informacioneve dhe përgatitjen e tij për të qenë i suksesshëm.
- Bashkëveprimi brenda grupit zhvillon aftësitë për komunikim, organizim, menaxhim si dhe të dallojë dhe të vlerësojë situata të ndryshme nga e kaluara dhe e tashmja dhe të dijë të nxjerrë përfundime.
- Bashkëpunimi me institucionet, grupet e interesit dhe me shoqërinë civile, janë forma të tjera të punës që realizohen edhe jashtë hapësirës shkollore. Përshkrimi i ngjarjeve si dhe i vendeve të ndryshme, mbledhja e të dhënave dhe materialeve të tjera hulumtuese si dhe prezantimi i punës së vet dhe të grupit para të tjerëve, e ndihmojnë nxënësin në arritjen e kompetencave.

Vëmendje të veçantë mësimdhënësi duhet t'i kushtojë edhe çështjeve ndërkurrikulare. Realizimi i tyre u mundëson nxënësve që të kuptojnë më mirë marrëdhëniet, proceset dhe raportet që ndodhin në shoqëri dhe mjedis. Duke trajtuar çështjet ndërkurrikulare ndihmohet në zhvillimin dhe arritjen e kompetencave të parapara në kurrikul. Në këtë nivel, në kuadër të fushës *Shoqëria dhe mjedisi*, gjegjësisht lëndëve të kësaj fushe, të gjitha temat/çështjet ndërkurrikulare të parapara me KK mund të trajtohen.



### *Pra temat:*

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media, dhe
- Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm,

janë të ndërlidhura me disa nga rezultatet e fushës, andaj duhet t'i kushtohet kujdes trajtimit adekuat edhe në programet lëndore. Kërkohej që mësuesin që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, temat dhe njësitet mësimore se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi sa më i mirë i këtyre çështjeve, por njëkohësisht dhe mësuesin e integruar.

## 6. Udhëzime për vlerësim

Zbatimi i Kurrikulës, ndër të tjera, përfshin ngritjen e një kulture të vlerësimit të vazhdueshëm për ndjekjen e progresit dhe mbledhjen e të dhënave për identifikimin dhe dokumentimin e sfidave për gjetjen e zgjidhjeve më të mira për realizimin e qëllimeve të përgjithshme të kurrikulës, atyre specifike të fushave, si dhe shkallë sipas kompetencave.

Vlerësimi është i lidhur ngushtë edhe me metodologjinë e mësimit dhe kërkon pajtueshmëri (kompatibilitet) dhe konsistencë në gjithë procesin. Vlerësojmë atë që synojmë, atë që e vëmë në objektiv.

Vlerësimi në fushën *Shoqëria dhe mjedisi* për nivelin e dytë, përveç që bëhet me lloje të ndryshme të testimit, si: testimi verbal, joverbal, teste objektive e subjektive, teste të përgatitura nga mësuesin, vlerësimi i nxënësve në tabelë, i punës me projekte etj., mund të bëhet edhe me vëzhgimin e përvetësimit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve dhe shkallës së rritjes së shkathtësive dhe aftësive për të zbatuar rezultatet e parapara në Kurrikulën Bërthamë për këtë nivel.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen nxënësit, pikë referimi janë rezultatet specifike për fushë në nivel klase si dhe ato për kompetenca në nivel shkollë. Mësuesin, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve të tyre. Në këtë kuptim përvojat e deritanishme të secilit mësues dhe ato të praktikuar në përgjithësi në sistemin arsimor kosovar për vlerësim janë një bazë fillestare e cila duhet të pasurohet në harmoni me ndryshimet në KK.

Kërkesat e Kurrikulës së re në kompetenca, synojnë vlerësimin e asaj se çka është në gjendje të bëjë nxënësi, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtutjeshme me nxënësit është e domosdoshme. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të vlerësohet edhe përmes teknikës, që njihet si buletini i pjesëmarrjes ose edhe asaj që quhet lista e kontrollit etj.

Gjatë vlerësimit të nxënësve në këtë nivel, duhet të kihet parasysh lidhja dhe varësia e nxënësit me mësuesin, rëndësia etikës së vlerësimit dhe synimi që ai të jetë përkrahës dhe motivues në mënyrë që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synojë arritje sa më të larta.

Po ashtu është e rëndësishme të kultivohet shprehja e vetëvlerësimit, e cila mund të realizohet me mbajtjen e dosjeve të nxënësve, në të cilat ata ruajnë punimet e tyre reprezentative, që lidhen me rezultatet e parapara për këtë nivel.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS

## 7. Materialet dhe burimet mësimore


Për formimin kompetent në fushën mësimore *Shoqëria dhe mjedisi* përdoren burime të ndryshme mësimore që motivojnë nxënësit në arritjen e progresit të përvetësimit të shprehive dhe shkathtësive, që do t'i përdorin në të tashmen dhe në të ardhmen.

Përveç teksteve mësimore, nxënësit kanë qasje edhe në burime të tjera të njohurive. Tekstet mësimore dhe burimet e tjera i shërbejnë mësimdhënësit për të realizuar procesin mësimor.

Për njohje të qëndrueshme të fushës mësimore *Shoqëria dhe mjedisi* përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, fletoret e punës, broshura, atlase, globe, enciklopedi, literaturë, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës, vizita të ndryshme njohëse, si p.sh. objekteve shoqërore, kulturore dhe natyrore.

Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatshme mësimore, p.sh.: rezultatet e projekteve nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë dhe të krijojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e produkteve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.



# KURRIKULA BËRTHAMË


E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## **Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti**

Hyrje  
Qëllimi i fushës  
Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre  
Rezultatet e fushës  
Udhëzime metodologjike  
Udhëzime për vlerësim  
Materialet dhe burimet mësimore

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## 1. Hyrje

Fusha kurrikulare *Edukate fizike, sportet dhe shëndeti* siguron që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, të kuptuarit, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për mirëqenien e tyre mendore, emocionale, sociale dhe fizike. Kjo fushë i përgatit nxënësit për mundësitë, përgjegjësit dhe aftësimin për jetë si vlerë kryesore për rritje dhe zhvillim cilësor individual dhe kolektiv. Kontributet edukative dhe formuese të edukimit fizik dhe shëndetit të nxënësit, janë tashmë të gjithë pranuar dhe kjo bën një fushë të rëndësishme me ndikime të padiskutueshme në rritjen dhe zhvillimin e njeriut.

Fusha e edukimit fizik, sportit dhe shëndetit do të ofrojë qasje të integruar të edukimit fizik dhe sporteve, me edukatën shëndetësore, që në shkallën e parë e deri në shkallën e gjashtë.

## 2. Qëllimi i fushës

*Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti* duhet t'i aftësojë nxënësit me njohuri, shkathtësi dhe t'i përgatisë ata drejt jetës së shëndetshme në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin përgjegjësi për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe të tjerëve. Gjithashtu kjo fushë promovon aktivitet të rregullt fizik, edukimin e mënyrës së jetesës së shëndetshme dhe aktive si dhe arritjen e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme përgjatë gjithë jetës. Fusha e edukimit fizik, sporte dhe shëndetit nxënësve u mundëson:

- Përforcimin e mëtejshëm të njohurive dhe shkathtësive teknike e taktike të fituara në disiplinat sportive dhe zbatimin e tyre në jetën e përditshme;
- Zbatimin në veprimtaritë fizike e sportive të rregullave teknike të disiplinave sportive;
- Zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë aktiviteteve fizike, sportive dhe aplikimin mënyrave të dhënies së ndihmës së parë në raste të lëndimeve dhe traumave;
- Zbatimin në jetën e përditshme të parimeve të Olimpizmit, Filozofisë Olimpikë dhe Fair-Play-t, si dhe krijimin e edukatës e të ushtruarit sistematik, disiplinës, vullnetit, vetëvlerësimit dhe konkurrencës së ndershme;
- Pajisje me informacione për mënyrat dhe veprimet që përmirësojnë mirëqenien e tyre mendore, emocionale, sociale dhe fizike;
- Përforcimin dhe zgjerimin e njohurive dhe praktikave për ushqimin shëndetshëm, shtesat dhe ndikimin e substancave që shkaktojnë varshmëri;
- Ndërgjegjësimin për shërbimet shëndetësore në dispozicion dhe për mënyrat e marrjes së shërbimeve shëndetësore racionale.
- Kuptojnë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në krijimin dhe ruajtjen e mjedisit të shëndetshëm, dhe tregojnë iniciativë dhe veprim drejt arritjes së saj dhe
- Balancojnë punën, pushimin dhe kultivojnë qëndrime kritike për shfrytëzimin e teknologjisë.

## 3. Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre

Konceptet e fushës së kurrikulës *Edukate fizike sportet dhe shëndeti* që janë zhvilluar në nivelet I dhe II vazhdojnë të zhvillohen edhe në nivelin e tretë të arsimit, përkatësisht në shkallët 5-6 të kurrikulës. Konceptet e kësaj fushe janë si më poshte:

- Mirëqenie plote fizike, psikike, emocionale dhe sociale;
- Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike dhe sportive;
- Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm të jetës;
- Vetëdijesimi për ndikimin e përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri;
- Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

## **Mirëqenia e plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale**

Mirëqenia fizike, psikike, emocionale dhe sociale u mundëson nxënësve të ruajnë dhe të kultivojnë shëndetin, të zhvillojnë respektin për vetveten dhe për të tjerët gjatë aktiviteteve rekreative dhe sportive në shkollë dhe komunitet. Kjo do të rrisë besimin në arritjet e tyre, do t'u ndihmojë të menaxhojnë ndjenjat dhe emocionet e tyre si dhe do t'i përgatisë për të përballuar situatat e ndryshme jetësore.

## **Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike dhe sportive**

Edukimi fizik u ofron nxënësve platformë nga e cila mund të ndërtojnë shkathtësi për të përmirësuar aspektet fizike që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive personale dhe ndërpersonale. Ajo u mundëson nxënësve të zhvillojnë konceptet dhe aftësitë e nevojshme për pjesëmarrje në një gamë të gjerë të aktiviteteve fizike, sportive, kulturore, që ndikon në rritjen e mirëqenies së tyre fizike dhe i përgatit për jetë aktive dhe të shëndetshme. Përmes edukimit fizik dhe sporteve u mundësohet nxënësve përforsimi i njohurive dhe përdorimit të shumë elementeve e kombinacioneve tekniko-lëvizore që përfshihen në lojërat sportive.

Nëpërmjet lojërave sportive (basketboll, volejball, futboll, etj.), nxënësit krijojnë e fitojnë kompetenca shumë të rëndësishme për jetën, zhvillojnë më tej cilësitë fizike, aftësitë e komunikimit dhe të punuarit në ekip, duke e konsideruar sportin si mundësi për karrierë, zhvillojnë aftësitë për pranimin dhe ndarjen e përgjegjësisë, si dhe gëzimin e suksesit, mësohen të respektojnë rregullat e lojës dhe fair-play-t në aktivitete sportive në shkollë e jashtë saj, që në vetvete përbën një model të respektit ndaj rregullave demokratike të jetës qytetare, si dhe formimin e kulturës së të ushtruarit sportiv përgjatë gjithë jetës.

## **Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm të jetës**

Të ushqyerit e shëndetshëm kontribuon në krijimin e shprehive të drejta për mënyrat e të ushqyerit të nxënësve përmes promovimit të vlerave ushqyese që u mundësojnë atyre të bëjnë zgjedhje të shëndetshme. Kjo i ndihmon nxënësit në formimin kritik të aftësive, në zgjedhjen e ushqimeve, respektit të zakoneve për të ngrënë e të tjerëve, formimit të aftësive për marrjen e vendimeve duke krijuar një model të shëndetshëm jetese, e cila do të sjellë efekte të duhura për jetë.

## **Vetëdijesimi për ndikimin e përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri**


Nxënësit informohen dhe edukohen për ndikimin e përdorimit, keqpërdorimit të substancave të ndryshme dhe pasojat që bartin në shëndetin e tyre individual dhe kolektiv. Ata vetëdijesohen për të marrë vendime të cilat janë të bazuara në informata të drejta të cilat ndikojnë në shëndetin e tyre.

## **Edukimi për mjedisin**

Edukimi për mjedisin ndihmon nxënësit të bëhen të ndërgjegjshëm për mjedisin dhe të mund të mbrojnë veten dhe të tjerët nga faktorët e rrezikshëm. Ndërgjegjësimi mjedisor përfshin zhvillimin e ndjenjës së informimit dhe të përgjegjësisë për ruajtjen dhe përdorimin racional të resurseve të mjedisit.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MËSËM TË ULËT TË KOSOVËS



## 4. Rezultatet e të nxënit

| REZULTATET MËSIMORE PËR SHKALLËT 3 DHE 4  |  |
|---|--|
| Shkalla 3<br>Klasa 6,7 (mosha 11-13)  | Shkalla 4<br>Klasa 8,9 (mosha 13-15)   |
| <b>Mirëqenia e plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale.</b>   |  |
| 1. Shpjegon dhe analizon veprime konkrete për ruajtjen e mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale të tij/saj dhe të tjerëve (në familje, me koleget dhe anëtarët e komunitetit) në situata të ndryshme.   | 1. Identifikon persona dhe shërbime në mjedisin ku jeton dhe di ku të kërkojë shërbime dhe mbështetje profesionale për të ruajtur mirëqenien fizike, psikike, sociale dhe emocionale.  |
| <b>Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike</b>   |  |
| 1. Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përfunduar shkathtësitë psikofizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes. | 1. Merr pjesë aktive në disiplina të ndryshme sportive (atletik, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) dhe aplikon përvoja e fituara në mënyrë të rregullt përmes aktiviteteve fizike dhe krijon kombinime lëvizore me përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes. |
| 2. Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.  | 2. Përshkruan, zbaton dhe ndërlikon rregullat e sporteve kolektive duke përfunduar shprehitë motorike dhe shkathtësitë lëvizore gjatë ushtrimit të taktikave të sportet kolektive.   |
| <b>Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm të jetës</b>   |  |
| 1. Hulumton sistemin e klasifikimit të ushqimit të etiketuar, kupton që njerëzit kanë nevojë të ndryshme për ushqim dhe nevojat e tyre ndryshojnë në etapa të ndryshme të jetës se si duhet të ushqehen.  | 1. Identifikon nëpërmjet aktiviteteve praktike, përbërësit kryesorë të ushqimit, prejardhjen (burimin) e tyre, funksionin dhe përshkruan lidhjen në mes të energjetikës, ushqimit dhe shëndetit fizik.   |
| <b>Vetëdijësimi për ndikimin e përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri</b>  |  |
| 1. Njeh dhe dallon situatat e rrezikshme dukuritë dhe shprehitë negative (substancat negative duhani, alkooli dhe drogat) dhe kupton mënyrën për parandalimin e tyre.   | 1. Kupton efektet pozitive që disa substanca mund të ketë në mendjen dhe trupin, por gjithashtu është i vetëdijshëm për pasojat negative dhe të rënda fizike, mendore, emocionale, sociale dhe juridike që ka keqpërdorimi i substancave.                            |
| <b>Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm</b>  |  |
| 1. Njeh burimet natyrore, rregullat e sjelljes, në natyrë, në kampe dhe shfrytëzon ato për zhvillim të aftësive fizike.   | 1. Përdor burimet natyrore për zhvillimin e aftësive fizike dhe shëndetit, duke u kujdesur për respektuar mjedisin ku vepron.  |

## II. Njohuritë dhe shkathtësitë

- Njeh veten dhe të tjerët
- Kupton veten dhe të tjerët
- Tregon për veten, për familjen dhe për mjedisin
- Identifikon rreziqet e ndryshme
- Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative
- Shpjegon ndikimin e aktiviteteve sportive
- Emërton pjesët e trupit
- Shpjegon emocionet
- Shkëmben përvojat
- Diskuton
- Pjesëmarrje aktive
- Ushtron të drejtat e veta
- Shpjegon
- Menaxhon emocionet
- Demonstron sjellje, veprime, shprehi
- Zbaton principet
- Përkrah llojet e ushqimit, aktivitetet fizike
- Qëndrim të drejtë trupor
- Praktikon ushtrime
- Ndërton bashkëpunim
- Harton rregullore
- Hulumton


## III. Qëndrimet, vlerat dhe besimet

- Respekton veten dhe të tjerët
- I përgjegjshëm
- Tolerant
- Respektim i diversitetit
- I përkushtuar
- Qëndrim pozitiv
- Bashkëpunues
- Respekton kodin e mirësjelljes
- Respekton kodin e veshjes
- Respekton rregulloret
- Gatishmëri
- I sigurt



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## IV. Njohuritë dhe konceptet

- Elementë të lëvizjes
- Lëvizje manipulative
- Lëvizje lokomotorë
- Lëvizje jolokomotore
- Lojë lëvizore
- Rregulla të lojës
- Lojë tradicionale (popullore)
- Morali i lojës
- Lojëra sportive
- Marshim në natyrë
- Higjiëna personale
- Veshja e përshtatshme
- Drejtqëndrime
- Rregullat e sigurisë
- Ndihma e parë
- Mënyra të të ushqyerit
- Shëndetësore
- Edukimin fizik,
- Shëndet mendor
- Shëndet emocional
- Shëndet social
- Shëndeti personal
- Zakonet/shprehitë e të ushqyerit
- Përmirësimi i shëndetit
- Stilet e shëndetshme jetësore
- Edukim olimpik - "Fair-Play"
- Substanca që krijojnë varshmëri
- Mënyra të drejta të përdorimit të substancave
- Mjedisi që na rrethon
- Planifikim
- Karrierë

## 5. Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti* mund të përdoren metodat e ndryshme të punës me qëllim të arritjes e rezultateve të kompetencave të cilat metoda janë të përbashkëta për të gjitha fushat përfshi edhe fushën *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti*. Në kuadër të kësaj fokusi i mësimdhënësit duhet të jete në zbatimin e metodologjive të cilat sigurojnë një mësimdhënie gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit siç janë:

- Mësimdhënie dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja;
- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar;
- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave;
- Mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar;
- Çështje/tema ndërkurrikulare dhe
- Në çështje jashtëkurrikulare.

Për arritjen e rezultateve të kompetencave të fushës përveç metodave të përbashkëta secila lëndë mësimore ka edhe veçantitë e saja për organizimin e punës mësimore.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave dhe teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, duke pasur gjithnjë parasysh dhe sigurinë e nxënësit.

Organizimi i mirë i procesit të mëimit të kësaj fushe do të thotë që nxënësit të vendosen edhe në situata konkrete praktike ku zhvillojnë dhe zbatojnë elementët lëvizorë e sportivë. Aktiviteti lëvizor, (loja dhe sporti) janë një punë serioze, që dominon shumicën e jetës së tyre shkollore dhe jashtë saj, duke u zënë pjesën më të madhe të kohës e të energjisë, duke krijuar aftësi, shkathtësi dhe formuar sjellje shoqërore, si kontribut themelor në kërkesën për rritjen e shpejtë dhe të shëndetshme.

Në orët e mëimit të edukimit fizik duhet t'i vihet theks i veçantë në mbajtjen e higjienës, pjesëmarrja në to i mëson nxënësit se si të ruajnë pastërtinë dhe të kujdesen për higjienën e trupit gjatë dhe pas aktivitetit fizik. Gjatë këtyre orëve mësohen praktika të sigurt, të cilat, nëse ndiqen nga nxënësit gjatë gjithë jetës së tyre, do t'i parandalojnë ata nga sëmundjet.

Duke marrë pjesë në procesin mësimor të edukimit fizik dhe sporteve, nxënësit kanë filluar të mësojnë shumë gjëra për jetën. Ata fitojnë në disa lojëra dhe humbasin në disa të tjera, kjo i bën ata të kuptojnë se fitorja dhe humbja janë pjesë e jetës dhe duhet të pranohen si të tilla. Gjithashtu, pjesëmarrja në praktika lëvizore e sportive mundëson zhvillimin mendor e intelektual të nxënësve në mënyrë argëtuese dhe të drejtpërdrejtë.

Edukimi fizik dhe sportiv e gjen veten mjaft mirë si komponent i edukimit artistik, sepse janë të ndërlidhur me njëri - tjetrin. Edukimi fizik dhe sportiv vë në lëvizje gjithë trupin e njeriut të vallëzimi e muzika që e shoqëron atë. Sinkronizimi dhe ritmizimi si aftësi koordinative, janë pjesë përbërëse të edukimit fizik e artistik, të cilët së bashku ndihmojnë në një zhvillim dhe formim më të plotë të nxënësit.

Trajtimi i çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të fushës është një aspekt me shumë rëndësi pasi mundëson integrimin e fushave kurrikulare dhe lëndëve mësimore me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të kuptojnë dhe interpretojnë drejt proceset shoqërore dhe natyrore që ndodhin në shoqëri. Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare do të ndihmojë zhvillimin dhe plotësimin e përmbajtjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave KKK.

*Disa nga çështjet ndërkurrikulare që i ndihmojnë nxënësit në këtë nivel janë:*

- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për medie
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm
- Edukimi për qytetari demokratike
- Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm

Në përgjithësi rezultatet e fushës i prekin çështjet nderkurrikulare, andaj kujdes do t'i kushtohet trajtimit adekuat edhe në programet lëndore. Megjithatë parësore është puna e mësimdhënësit i cili gjatë punës së tyre të kushtojnë kujdes çështjeve ndërkurrikulare që në fazën e planifikimit gjithmonë të analizojnë, tema apo njësi mësimore, me të cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhet në mënyrë që të sigurohet mësimdhënie e integruar e cila synon përfshirjen e të gjitha aspekteve të rëndësishme shoqërore të trajtohen nga lëndë të ndryshme dhe me këndvështrime të ndryshme e cila mundësohen edhe arritjen e kompetencave të përcaktuara me KKK.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## 6. Udhëzime për vlerësim

Fusha e kurrikules *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti*, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e shëndetit, konceptet dhe praktikimin e sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje të vazhdueshme dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Gjithashtu, edhe për edukimin shëndetësor, për shkak të specifikave që ka, do të ishte e vlefshme që, përveç vlerësimit numerik, të aplikohet në masë të madhe vlerësimi përshkrues, pasi puna në grup, projektet, aftësitë motorike, aftësia e të folurit etj., nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor dhe që mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Qëllim i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Mësimdhënësi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si për shembull:

Fusha e kurrikulës *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti*, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e shëndetit, konceptet dhe praktikimin e sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje të vazhdueshme dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Gjithashtu, edhe për edukimin shëndetësor, për shkak të specifikave që ka, do të ishte e vlefshme që përveç vlerësimit numerik të aplikohet në masë të madhe vlerësimi përshkrues si puna në grup, projektet, aftësitë motorike, aftësia e të folurit etj., nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor dhe që mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Qëllimi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve.

*Mësimdhënësi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi si:*

- Përshkrim gojor të lëvizjeve që duhet përmirësuar.
- Përdoren fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit.
- Testi me shkrim i standardizuar
- Pjesëmarrja aktive gjatë orës mësimore
- Ese ( hulumtim individual apo grupor për temat e edukimit shëndetësor )
- Video incizimet.

*Ndërkaq, te edukimi fizik dhe sporteve fokusi i mësimdhënësit duhet të jetë në vlerësimin e këtyre elementeve:*

- Përdoren fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit.
- Korrigjim me takt i lëvizjeve të gabuara.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

- Me zgjedhjen e nxënësve më të mirë në vegla.
- Me zgjedhjen e nxënësve për ekipin shkollës (basketboll, volejball, futboll etj.)
- Me shpalljen e lojtarëve më të mirë.
- Koha në sekonda e realizimit të veprimit lëvizor mbi bazën e aftësive individuale.
- Sasia në herë e përsëritjeve të veprimit lëvizor mbi bazën e aftësive individuale.
- Distanca në metra e arritur nga veprimi lëvizor mbi bazën e aftësive individuale.
- Me kompleks ushtrimesh dhe me pikë.
- Me sistem pikësh për ushtrimet e veçanta.
- Me sistem pikësh për vallëzimin e kompozuar.
- Me teste e pikë për kombinacionet teknike.
- Me teste për njohuri mbi edukimin shëndetësor.
- Me pikë për veprime teknike individuale.
- Me pikë për veprime individuale.
- Me pikë për skemat lëvizore të vrapimeve të ndryshme.

Këtyre vlerësimeve mund t'u shtohen edhe vlerësimet mbi aktivizimin në veprimtaritë e ndryshme sportive. Të gjitha këto duhet të reflektohen në kartelat e matjeve antropometrike dhe atyre fiziko lëvizore.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet, ndërsa demonstroi arritjet e tij, duke u shfaqur nëpërmjet veprimtarish e produkteve të tjera, si: merr pjesë në veprimtari të ndryshme sportive, apo sportive–artistike që organizon shkolla etj. Në angazhimin e nxënësve me grupe apo skuadra të vogla, mësuesi parashton peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënësi në veçanti. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim.

## 7. Materialet mësimore dhe burimet për mësimdhënie dhe nxënie


Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën mësimore *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti* është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që t'i motivojnë nxënësit dhe të stimulojnë progresin e tyre në mënyrë që të përvetësojnë shprehje dhe shkathtësi të nevojshme për jetë. Meqenëse tekstet shkollore janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të të nxënësit, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet të kufizohet vetëm në tekstet shkollore, por edhe në burime të tjera të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizimin më të suksesshëm të fushës mësimore *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti* duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe libra të tjerë.

Mësimdhënësit dhe nxënësit mund të angazhohen në hartimin dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore, p.sh.: rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## Jeta dhe puna

Hyrje

Qëllimi

Konceptet e përgjithsme dhe përshkrimi i tyre

Rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

## 1. Hyrje

Përmes kësaj fushe të Kurrikulës, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Nxënësit do ta zhvillojnë vetëdijesimin dhe vetëbesimin për përdorim të teknologjive të TIK-ut, zhvillimit të ekonomisë familjare, orientimit profesional, zhvillimi i ndërmarrësisë dhe edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

Nxënësit do të mësojnë edhe vetë të punojnë, të hulumtojnë e të krijojnë, të zhvillojnë aktivitete praktike në fushën e teknologjisë.

### 1. Qëllimi

Në fushën kurrikulare *Jeta dhe puna* nxënësit zhvillojnë njohuritë, ushtrojnë punën praktike, përdorimin e Teknologjisë dhe TIK-ut, ushtrimin e zhvillimit të ndërmarrësisë si dhe arrijnë e kompetencave për vendimmarrje lidhur me orientimin profesional si dhe zhvillim të qëndrueshëm.

### 2. Konceptet dhe përshkrimi

- Teknologji duke përfshirë TIK-un
- Puna dhe edukimi për ndërmarrësi
- Këshillim dhe orientim në karrierë
- Edukim për zhvillim të qëndrueshëm

#### Teknologji duke përfshirë TIK-un

Teknologjia u mundëson nxënësve përvetësimin e njohurive dhe të shkathtësive të nevojshme nga aspekti i zhvillimeve tekniko-teknologjike. Nxiti të menduarit në fushat e caktuara tematike dhe zgjon ndjenjat e caktuara pozitive si dhe të menduarit e konkluduarit logjik.

Nxënësve u mundësohet t'i zbulojnë të panjohurat për materialet, veglat, makinat, komunikimin elektronik dhe shkallë-shkallë të njohin krijime dhe pajisje të ndryshme teknike. Përmes këtij koncepti zhvillohet lidhja e teknologjisë me TIK-un me lëndët tjera, që mundëson arrijnë e rezultateve të fushave kurrikulare.

#### Puna dhe edukimi për ndërmarrësi

Përfshirja e nxënësve në aktivitete praktikimi – simulimi lidhur me përgatitjen e planeve të biznesit familjar. Simulimi lidhur me hulumtimin e ndërmarrjeve dhe zhvillimi i ndërmarrësisë u mundëson hulumtimin e nevojave për kreativitet në ndërmarrësi, të identifikojë dhe të ushtrojë disa shkathtësi dhe të zhvillojëtribute në ndërlidhje me shkathtësi ndërmarrësie.

Edukimi për ndërmarrësi lidhet ngushtë me menaxhimin e kursimeve, shpenzimeve dhe planifikimin për një konsumues të arsyeshëm. Tek nxënësi zhvillon shkathtësitë në vendimmarrje dhe bashkëpunimin me të tjerët.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## Këshillim dhe orientim në karrierë

Zhvillon te nxënësi aftësi për të zbuluar mundësitë e karrierës, me qëllim vendimmarrjeje për shkollimin e mëtejshëm në përcaktimin e profesionit të ardhshëm. Nxënësit informohen mbi tregun e punës dhe planifikimin për orientim profesional.

## Edukim për zhvillim të qëndrueshëm

Kjo fushë kurrikulare, mundëson njohjen dhe orientimin në krijimin e qëndrimeve, botëkuptimeve dhe shprehive për të kuptuar konceptin e qytetarisë globale, profesionale dhe personale. Nxiti qasjen e duhur mbi konceptin e kujdesit ndaj mjedisit, duke ndërtuar qëndrime rreth shoqërisë, etikës, mirëqenies sociale, ekonomike, politike për zhvillim të qëndrueshëm.

### 3. Rezultatet e të nxënit të fushës

Rezultatet e të nxënit për fushën kurrikulare Jeta dhe puna janë hartuar mbi bazën e koncepteve themelore të fushës, që përmbajnë në vete kërkesat që nxënësi duhet t'i arrijë pas përfundimit të çdo shkalle.

Rezultatet e të nxënit përmbajnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat të cilat zhvillohen dhe thellohen sipas gradacionit në progres, duke pasur parasysh zhvillimin fizik dhe psikomotorik të nxënësve. Këto rezultate mundësojnë arritjen e gjashtë kompetencave të përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës duke e theksuar kompetencën kontribues produktiv.

Rezultatet mësimore për SNKA 2, shkallët 3 dhe 4 janë paraqitur në tabelën në vijim:

| SNKA 2  |  |
|---|--|
| Shkalla 3<br>Klasa VI, VII  | Shkalla 4<br>Klasa VIII, IX  |
| <b>I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT, SHKATHTËSITË</b> që zhvillohen te nxënësi/ja përmes: <ul style="list-style-type: none"><li>• Ushtrimit të punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet;</li><li>• Ngritjes së cilësive personale për jetë dhe punë;</li><li>• Përdorimit të teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme;</li><li>• Përdorimit të TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</li><li>• Ushtrimit të zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit;</li><li>• Promovimit të kushteve të sigurta për jetë dhe për punë;</li><li>• Përgatitjes për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme;</li><li>• Komunikimit në / për jetë dhe punë;</li><li>• Edukimit për zhvillim të qëndrueshëm -mbrojtje dhe ruajtje të natyrës dhe mjedisit.</li></ul> |  |
| <b>2</b>  | <b>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b> |
| 1. Zbaton aktivitete individuale dhe në grup në mjedis shkollor dhe në komunitet.   | 1. Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin.                 |



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

|          |  |  |
|----------|--|--|
|          | 2. Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar,   | 2. Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup.   |
|          | 3. Zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambient të tjera jashtëshkollore.                 | 4. Planifikon dhe zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambiente tjera jashtëshkollore.                                |
| <b>2</b> | <b>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë</b>  |  |
|          | 1. Shpjegon dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.                               | 1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për qasje orientimi në karrierë.  |
| <b>2</b> | <b>3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme</b>  |  |
|          | 1. Analizon doracakët për vegla dhe makina të ekonomisë familjare.   | 1. Përdor vegla, pajisje dhe makina punuese bazuar në udhëzime dhe doracakë për përdorim.  |
|          | 2. Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.           | 2. Përshkruan procesin teknologjik të shfrytëzimit të burimeve natyrore të energjisë.  |
| <b>2</b> | <b>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b>  |  |
|          | 1. Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara.                                   | 1. Zbaton njohuri nga TIK për prezantimin e proceseve të caktuara.   |
|          | 2. Aplikon TIK-un në përmbajtje të lëndëve të ndryshme mësimore drejt digjitalizimit në nxënie.                                      | 2. Përdor programe kompjuterike për zbatimin praktik të njësive dhe temave mësimore.   |
| <b>2</b> | <b>5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit</b>  |  |
|          | 1. Shpjegon aspektin etik dhe ekonomik të ekonomisë familjare e në veçanti veprimet kursimtare në familje.                           | 1. Analizon tregun e punës dhe përgatit pilot-plane të biznesit, individualisht apo në grup, dhe i prezanton ato përmes formave të ndryshme të komunikimit       |
| <b>2</b> | <b>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë</b>  |  |
|          | 1. Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë                                | 1. Identifikon dhe parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në vendin ku punon.   |
| <b>2</b> | <b>7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</b>   |  |
|          | 1. Shfaq qëndrime vendimmarrëse në situata të ndryshme duke dhënë arsytim mbi vendimet që merr.                                      | 1. Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke e argumentuar, me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.                                       |
| <b>2</b> | <b>8. Komunikimi në / për jetë dhe punë</b>  |  |
|          | 1. Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim (në medie, internet etj.) | 1. Hulumton dhe përdorë burime të ndryshme të informimit për arsimim, aftësim për tregun e punës me qëllim të përzgjedhjes së opsioneve për orientim në karrierë |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



|  |  |   |
|--|--|---|
| <b>2</b>                                 | <b>9. Zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe mjedisi</b>   |   |
|  | 1. Adreson sfidat e së tashmes dhe të ardhmes në mënyrë konstruktive dhe kreative për të krijuar një shoqëri më të qëndrueshme.  | 1. Zhvillon aktivitete për çështjet e drejtësisë sociale, etikën dhe mirëqenien, duke lidhur me faktorët socialë, ekonomikë dhe ekologjikë. |
|  | 2. Angazhohet për ruajtjen e baraspeshës ekologjike të mjedisit.   | 2. Analizon dhe vlerëson përparësitë e përdorimit të llojeve të ndryshme të energjisë në ruajtjen e mjedisit ku jeton.                      |
| <b>II. Qëndrimet, vlerat dhe besimet</b> |  |   |
|  | <ul style="list-style-type: none"><li>• Respekton veten dhe të tjerët</li><li>• Vetërespekti</li><li>• I përgjegjshëm</li><li>• Tolerant</li><li>• Respektimi i diversitetit</li><li>• I përkushtuar</li><li>• Qëndrim pozitiv</li><li>• Bashkëpunues</li><li>• Respekton kodin e mirësjelljes</li><li>• Respekton kodin e veshjes</li><li>• Respekton rregulloret</li><li>• Gatishmëri</li><li>• I sigurt</li><li>• Kureshtja</li><li>• Pavarësia në mendime dhe veprime</li><li>• Iniciativa dhe interesi në qasje të ndryshme</li><li>• Besimi në forcat vetjake</li><li>• Besimi në përdorimin e teknologjisë</li><li>• Vullneti</li><li>• Gatishmëria për bashkëpunim</li><li>• Qëndrim i hapur ndaj përkrahjes së tjerëve</li><li>• Tolerancë</li><li>• Shprehi dhe shkathtësi gjatë punës teorike dhe praktike</li><li>• Vetëvlerësim, vetëkritik</li><li>• Iniciativa dhe interesi në qasjet e ndryshme</li><li>• Respekt për punën e kryer mirë</li><li>• Respekt për përpjekjet personale dhe ato grupore</li><li>• Respekt për saktësinë</li><li>• Hulumentimi për orientim profesional</li></ul> |   |
| <b>III. Aftësitë dhe shkathtësitë</b>    |  |   |
|  | <ul style="list-style-type: none"><li>• Njih veten dhe të tjerët</li><li>• Kupton veten dhe të tjerët</li><li>• Tregon për veten, familjen dhe mjedisin</li><li>• Identifikon rreziqet e ndryshme</li><li>• Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative</li><li>• Shkëmben përvojat</li><li>• Diskuton</li><li>• Pjesëmarrje aktive</li><li>• Shpjegon</li><li>• Demonstron sjelle, veprime, shprehi</li><li>• Zbaton principet</li><li>• Praktikon ushtrime</li><li>• Ndërton bashkëpunim</li><li>• Komunikim grafik</li><li>• Komunikim elektronik</li></ul>   |   |

| IV. Konceptet specifike  |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkrim</li> <li>• Identifikim</li> <li>• Zbatim</li> <li>• Matje</li> <li>• Vlerësim</li> <li>• Skicim</li> <li>• Prerje</li> <li>• Krijim modelesh</li> <li>• Qasje e problemeve nga perspektiva të ndryshme</li> <li>• Dizajnim (kreativitet)</li> <li>• Hulumtim</li> <li>• Arsyetim</li> </ul> <p>Planifikim</p> |

## 5. Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën kurrikulare *Jeta dhe puna* mund të përdoren metodat e ndryshme të punës me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo fushë, por edhe për shkak të specifikave që mbart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin.

*Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:*

- Diskutimi dhe të nxëniet në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxëniet përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.


Në kuadër të fushës kurrikulare *Jeta dhe puna* një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Njohja e medias (përdorimi i medias për ta kuptuar botën përreth);
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë);
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit;
- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë;
- Puna vullnetare.

Fusha *Jeta dhe puna* duhet realizuar në atë mënyrë që t`u mundësojë nxënësve përvetësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave kryesore të parapara në KKK. Organizimi i mësimit duhet të përqendrohet në atë se çka duhet të dinë dhe çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



Ajo pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, por edhe përmes qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet t'i reflektojnë.

## 6. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe mjaft e rëndësishme e mësimdhënies në shkollën bashkëkohore.

Nxënësit nxënë mjaft gjatë viteve të shkollimit. Sidoqoftë, jo gjithçka që ata nxënë mund të matet me anë të testeve edhe për faktin se, për nxënësit e nivelit fillor, përdorimi i teknikave të ndryshme mundëson vlerësim sa më realist bazuar në karakteristikat e ndryshme të nxënësve.

Fusha kurrikulare *Jeta dhe puna*, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe punës, konceptet dhe praktikimin e sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje të vazhdueshme dhe në mënyrë aktive që njohuritë e mësuara t'i zbatojnë në praktikë në jetën e tyre të përditshme.

Gjithashtu, edhe për lëndët e fushës *Jeta dhe puna*, për shkak të specifikave që ka, do të ishte e vlefshme që, përveç vlerësimit numerik të aplikohej në masë të madhe vlerësimi përshkrues, pasi puna në grup, projektet, aftësitë psiko-motorike, sensore, aftësia e të folurit etj., nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për fushën *Jeta dhe puna* dhe që mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë në vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, që përdoren për vlerësim.

### Buletini i pjesëmarrjes

Përshkruhet si një teknikë vrojtimi që mund të përdoret për të vrojtuar, në grupe të vogla ose gjatë diskutimit. Buletini tregon se cili jep ndihmesë, sa shpesh bashkëpunon, sa të vlefshme janë ndihmesat etj.

### Lista e kontrollit

Është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, njohuri, për të cilat nxënësi do të vëzhgohet. Qëllimi kryesor i listës së kontrollit është të regjistrojë një vlerësim të vazhdueshëm për përparimin e nxënësit, duke dëshmuar se si i përmbush ai detyrat ose objektivat e llojeve të ndryshme. Krahas listës me elementet që do të vrojtohen, jepet edhe një shkallë vlerësuese.

### Portfolio e nxënësit

Është një mjet që mund të përdoret për të treguar modele të punëve të nxënësve, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve.

Portfolio mund të përmbajë, për shembull, vizatime, një projekt, një krijim, plane etj.

*Portfolio ka vlera, për këto arsye:*

- Është një mjet që u jep informacion mësuesit, prindërve dhe nxënësve;
- I jep nxënësit një pasqyrë tërësore të punës së tij;
- Duke e përgatitur vetë dosjen, nxënësi luan rol aktiv në procesin e mësimit dhe të vlerësimit.

## Portfolio elektronike

Vlen të theksohet se tashmë nga zhvillimi i teknologjisë mund të përpilojmë dhe dosje elektronike të cilat mundësojnë që përmes programeve aplikative të vlersojmë nxënësin sistematikisht dhe rezultatet të jenë të kalkuluara në formë automatike.

## 7. Materialet dhe burimet mësimore


Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën kurrikulare *Jeta dhe puna* është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që t'i motivojnë nxënësit dhe të stimulojnë progresin e tyre në mënyrë që të përvetësojnë shprehje dhe shkathtësi të nevojshme për jetë dhe punë në përditshmëri. Meqenëse tekstet shkollore janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të të nxënësve, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet të kufizohet vetëm në tekstet shkollore, por duhet të shfrytëzohen edhe burime të tjera të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizim më të suksesshëm të fushës kurrikulare *Jeta dhe puna* duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune. Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatura mësimore p.sh., rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

Mësimdhënësit mund të sajojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## LËNDËT MËSIMORE DHE ELEMENTET E PROGRAMEVE MËSIMORE

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## Lëndët mësimore dhe elementet e programeve mësimore

Në nivel të shkollës së mesme të ulët , një fushë kurrikulare përfshin një ose më shumë lëndë mësimore. Disa fusha kurrikulare janë edhe lëndë mësimore (*Matematika; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti*). Po ashtu, disa lëndë të fushës mund të jenë pjesë e të dy shkallëve kurrikulare, varësisht nga lloji i gjimnazit.

Tabela në vijim pasqyron fushat kurrikulare dhe lëndët mësimore që mësohen përgjatë shkallëve të kurrikulës në arsimin e mesëm të lartë – gjimnaze ( Klasa VI-IX).

| Fushat e Kurrikulës                  | Lëndët mësimore përgjatë shkallëve të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët (Klasa VI-IX) |  |
|--------------------------------------|---|--|
|                                      | ShK 3<br>(Klasa VI dhe VII)   | ShK 4<br>(Klasa VIII dhe IX)                         |
| Gjuhët dhe komunikimi                | Gjuhë amtare<br>Gjuhë angleze<br>Gjuha e dytë e huaj                                      | Gjuhë amtare<br>Gjuhë angleze<br>Gjuha e dytë e huaj |
| Artet                                | Art muzikor<br>Art figurativ  | Art muzikor<br>Art figurativ                         |
| Matematika                           | Matematikë  | Matematikë   |
| Shkencat                             | Biologji<br>Fizikë<br>Kimi  | Biologji<br>Fizikë<br>Kimi                           |
| Shoqëria dhe mjedisi                 | Histori<br>Gjeografi<br>Edukatë qytetare  | Histori<br>Gjeografi<br>Edukatë qytetare             |
| Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti | Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti  | Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti                 |
| Jeta dhe puna                        | Teknologjia me TIK  | Teknologjia me TIK                                   |

Për secilën lëndë mësimore në nivel klase përgatiten programet mësimore. MASHT-i i përgatit/ miraton programet mësimore. Ato duhet të reflektojnë kërkesat e KK, përkatësisht kërkesat e KB-së, si qëllimet dhe parimet e KK, rezultatet e kompetencave për shkallë, konceptet dhe RN-ët e fushës për shkallë, çështjet ndërkurrikulare dhe metodologjitë e mësimdhënies, nxënies dhe vlerësimit me qasjen e përcaktuar në dokumentet e sipërpërmendura. Në këtë kontekst programi mësimor duhet të përmbajë:


- Rezultatet e të nxënit që nxënësit duhet t'i arrijnë në kuadër të secilës lëndë dhe temë mësimore përgjatë një klase/viti shkollor - mësimor;
- Temat mësimore të lëndëve përkatëse për secilën klasë duke pasur parasysh kohezionin horizontal dhe vërtikal, aktualitetin, zhvillimin shkencor, mundësitë dhe interesat e nxënësve;
- Udhëzimet metodike për realizimin e temave mësimore në kuadër të lëndës përkatëse, arritjes së kompetencave, zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare dhe vlerësimit të nxënësve;



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

Ashtu si për lëndë mësimore në kuadër të fushave të kurrikulës, edhe për pjesën e Kurrikulës me zgjedhje hartohen programet mësimore për lëndët, modulet apo projektet e përzgjedhura nga shkolla. E gjithë puna për këtë proces zhvillohet në bazë të udhëzimeve në kapitullin për kurrikulën me zgjedhje dhe në bazë të akteve nënligjore për kurrikulën me zgjedhje.



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## IV KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Hyrje  
Qëllimi  
Organizimi  
Struktura e Kurrikulës/Programi zgjedhor  
Procedurat për hartimin dhe zgjedhjen e Kurrikulës me Zgjedhje  
Zbatimi dhe vlerësimi

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## 1. Hyrje

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës të arsimit parauniversitar. Për dallim nga fushat e kurrikulës që në KK dhe në KB-të e niveleve formale të arsimit parauniversitar dhe më pas në programet mësimore janë përcaktuar rezultatet e të nxëniet që duhet arrihen nga nxënësit dhe metodologjia e realizimit të tyre, hartimi i programit mësimor dhe realizimi i kurrikulës me zgjedhje mbetet kompetencë e shkollës. *Kurrikula me zgjedhje* në KK dhe KB është pjesë përbërëse e planit mësimor dhe e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Përcaktimi i *Kurrikulës me zgjedhje*, respektivisht hartimi i programit të saj mësimor bëhet në përputhje me mundësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve duke pasur në konsideratë mundësitë kadrovike të shkollës dhe komunës. Gjithashtu për përcaktimin e saj duhet të merren në konsideratë edhe interesat e komunitetit. Vendimi për përcaktimin e *Kurrikulës me zgjedhje* del si rezultatet i një procesi konsultativ, përfshirë nxënësit, prindërit, komunitetin, shkollën dhe komunën. MASHT-i mund të sugjerojë programe të ndryshme që janë me interes për vendin dhe shoqërinë në përgjithësi.

## 2. Qëllimi

Qëllimi i *Kurrikulës me zgjedhje* është që nxënësve t'u orohen mundësi më të mëdha për të përmbushur veten me dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera konform mundësive, nevojave dhe interesave të tyre, drejt zoterimit të kompetencave të përcaktuara me KK, përkatësisht arritjes së rezultateve të të nxëniet për kompetenca për shkallë kurrikulare. Në këtë kontekst *Kurrikula me zgjedhje* nxënësve u mundëson të thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë, të zhvillojnë shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat:

- në fushat e kurrikulës, respektivisht në lëndët mësimore të përcaktuara në dokumentet kurrikulare<sup>5</sup>,
- në lëndë të reja që nuk janë paraparë në dokumentet kurrikulare,
- në tema që kanë lidhje me problematikat shoqërore, kulturore dhe natyrore, dhe
- në temat që janë me interes për nivelin lokal dhe ndërkombëtar.

## 3. Organizimi

*Kurrikula me zgjedhje* mund të organizohet në:

- lëndë mësimore
- modul, dhe
- projekt

**Lënda mësimore me zgjedhje** i referohet organizimit didaktik të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave në një fushë të caktuar që është me interes për nxënësit, komunitetin dhe shoqërinë.

**Moduli mësimor me zgjedhje** i referohet organizimit didaktik të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për një pjesë të një fushe të caktuar që është me interes për nxënësit, komunitetin dhe shoqërinë.

<sup>5</sup> Shkolla edhe për Kurrikulën me zgjedhje, që për bazë ka fushat e kurrikulës apo lëndët mësimore, duhet përgatitur program të veçantë mësimor dhe duhet ta emërtojë sipas përmbajtjes dhe funksionit të programit.

**Projekti mësimor me zgjedhje** i referohet zhvillimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave në një fushë apo në disa fusha që janë me interes për nxënësit, komunitetin dhe shoqërinë, përmes mësimdhënies dhe nxënies hulumtuese, krijuese dhe zgjidhjes së problemeve të caktuara. Për tri llojet e organizimit të mësimin me zgjedhje, shkolla duhet të hartojë programet mësimore apo të adaptojë programe të sugjeruara nga MASHT-i.<sup>6</sup>

## 4. Struktura e Kurrikulës/programit mësimor

*Kurrikula me zgjedhje*, përkatësisht programi mësimor duhet të ketë strukturë të njëjtë me kurrikulat lëndore/programet e lëndëve mësimore të përcaktuara me dokumentet kurrikulare. Në programin e kurrikulës me zgjedhje duhet trajtuar:

- Rëndësinë dhe kohëzgjatjen e mësimin të lëndës, modulit a projektit të zgjedhur, në pjesën e hyrjes,
- Qëllimet e lëndës, modulit apo projektit,
- Rezultatet e të nxënit që nxënësit duhet t'i arrijnë përmes lëndës, modulit a projektit,
- Përmbajtjen mësimore/temat mësimore përkatëse,
- Udhëzimet metodike për realizimin e temave mësimore, arritjes së rezultateve të kompetencave të parapara në shkallë kurrikulare përkatëse, zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare dhe vlerësimit të nxënësve<sup>7</sup>.

## 5. Procedura e përzgjedhjes, hartimit dhe miratimit

Përzgjedhja dhe miratimi i lëndëve mësimore, moduleve apo projekteve që dalin nga *Kurrikula me zgjedhje* rregullohen me akt nën ligjor/ udhëzim administrative të përcaktuar nga MASHT-i. Ndërsa, për hartimin e programit mësimor, MASHT-i harton materiale mbështetëse (udhëzues) për shkollat/mësimdhënësit.

## 6. Zbatimi dhe vlerësimi

Lënda, moduli a projekti në momentin e përzgjedhjes nga nxënësit dhe përcaktimit definitiv nga shkolla, respektivisht komuna bëhet e detyrueshme dhe merr statusin e barabartë me të gjitha lëndët e tjera që janë përcaktuar në dokumentet kurrikulare.

Edhe për realizimin e *Kurrikulës me zgjedhje* duhet të përdoren metodologji të mësimdhënies dhe nxënies që janë në funksion të parimeve të kurrikulës, si parimin e gjithëpërfshirjes, zhvillimit të kompetencave, mësimdhënies së integruar dhe llogaridhënies.<sup>8</sup>

Gjithashtu vlerësimi i nxënësve që ndjekin programet mësimore të lëndëve, moduleve a projekteve që dalin nga *Kurrikula me zgjedhje* bëhet me metodologji dhe procedura si të lëndëve mësimore të përcaktuara në dokumentet kurrikulare, dhe me procedura që përcaktohen me akte nënligjore/ udhëzim administrativ. Dallimi është se lënda, moduli a projekti me zgjedhje nuk është pjesë e vlerësimit të jashtëm por kontribuuese e zhvillimit të kompetencave.


<sup>6</sup> Gjatë një viti shkollor nxënësit mund të marrin një apo dy programe mësimore qoftë lëndë, modul a projekt. Në rastin kur nxënësit marrin dy programe mësimore, njërin e ndjekin nga fillimi i vitit shkollor/mësimor deri në pushimet dimërore dhe tjetrin pas pushimeve dimërore deri në përfundim të vitit shkollor/ mësimor. Procedura e përzgjedhjes dhe e realizimit rregullohet me akte nënligjore/udhëzim administrative.

<sup>7</sup> Pikë orientimi për strukturimin dhe hartimin e planit dhe programit të mësimin me zgjedhje, shkolla/mësimdhënësit të përdorin planet dhe programet mësimore që janë në harmoni me kurrikulën e re.

<sup>8</sup> Për metodologji të mësimdhënies shih kapitullin VI – Metodologjia e përgjithshme – Udhëzime.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



## V PLANI MËSIMOR DHE LËNDËT MËSIMORE TË ARSIMIT TË MESEM TË ULËT

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## 1. Plani mësimor i arsimit parauniversitar

Plani mësimor ndahet për fusha kurrikulare në mënyrë të baraspeshuar, duke pasur parasysh moshën e nxënësve dhe nevojat e tyre zhvillimore. Koha e përcaktuar në këtë plan mësimor nënkupton minimumin e kohës për secilën fushë të kurrikulës nëpër të cilën duhet të kalojnë nxënësit përgjatë shkallëve të kurrikulës, përkatësisht përgjatë arsimit parauniversitar.

Plani mësimor është dokument në të cilin bazohet i gjithë organizimi i procesit mësimor në shkollë, në nivel shkalle kurrikulare apo klase të caktuar. Me të përkufizohen fushat e Kurrikulës, lëndët mësimore dhe koha e nevojshme minimale, që shprehet në përqindje apo në numra orësh për arritjen e rezultateve të të nxënësve për fushë dhe shkallë kurrikulare, të dhëna në Kurrikulën Bërthamë.

Plani mësimor ndahet për fusha kurrikulare në mënyrë të baraspeshuar, duke pasur parasysh moshën e nxënësve dhe nevojat e tyre zhvillimore. Koha e përcaktuar në këtë plan mësimor nënkupton minimumin e kohës mësimore për secilën fushë të kurrikulës nëpër të cilën duhet të kalojnë nxënësit për arritjen e rezultateve të të nxënësve përgjatë shkallëve të kurrikulës, përkatësisht përgjatë arsimit parauniversitar.

Plani mësimor sipas shkallëve kryesore të kurrikulës.

| Fushat e Kurrikulës                       | KSNA 0  | KSNA 1      | KSNA 2 |       | KSNA 3 |                              |                               |                         |                                 |
|---|---|-------------|--------|-------|--------|------------------------------|-------------------------------|-------------------------|---------------------------------|
|   | Shk1  |             | Shk2   | Shk3  | Shk4   | Shk 5 & 6                    |                               |                         |                                 |
|   | Klasa përgatitore   | Klasa 1 & 2 |        |       |        | Gjimnazi Shoqëror – gjuhësor | Gjimnazi i shkencave natyrore | Gjimnazi i specializuar | Arsimi dhe aftësimi profesional |
| Gjuhët dhe komunikimi                     | Nxënësit gjatë javës kalojnë në gjitha fushat kurrikulare | 38.10       | 33.80  | 27.12 | 25     | 30                           | 23.33                         |                         |                                 |
| Artet                                     |   | 9.52        | 8.45   | 6.78  | 6.67   | 5.56                         | 2.22                          |                         |                                 |
| Matematika                                |   | 23.81       | 21.13  | 13.56 | 13.33  | 8.89                         | 13.33                         |                         |                                 |
| Shkencat natyrore                         |   | 4.76        | 8.45   | 16.95 | 20     | 11.11                        | 35.56                         |                         |                                 |
| Shoqëria dhe mjedisi                      |   | 4.76        | 8.45   | 16.95 | 16.67  | 25.56                        | 6.67                          |                         |                                 |
| Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti      |   | 9.52        | 8.45   | 6.78  | 6.67   | 6.67                         | 6.67                          |                         |                                 |
| Jeta dhe puna                             |   | 4.76        | 4.23   | 6.78  | 6.67   | 5.56                         | 5.56                          |                         |                                 |
| Pjesa zgjedhore                           |   | 4.76        | 7.04   | 5.08  | 5      | 6.67                         | 6.67                          |                         |                                 |
| Aktivitete jashtëkurrikulare <sup>1</sup> |   |             |        |       |        |                              |                               |                         |                                 |

<sup>1</sup>Llojet e aktiviteteve jashtëkurrikulare dhe koha mësimore për realizimin e tyre planifikohen në nivel shkolle.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## 2. Plani mësimor dhe lëndët mësimore në shkollën e mesme të ulët

Shkolla gjatë hartimit të planit mësimor për nivel formal (shkallë dhe klasë) duhet të ketë parasysh vazhdimësinë e gjithë planit mësimor parauniversitar për secilën fushë kurrikulare. Shkolla ka lirinë që brenda kohës (përqindjes) së përcaktuar për secilën fushë të planifikojë organizimin e mësimimit si ajo e vlerëson më së miri, gjithnjë duke pasur parasysh rezultatet e të nxënimit për fusha dhe shkallë kurrikulare dhe mundësitë e nxënies.

**Tabela: Plani dhe lëndët mësimore KSNA 2**

| Fushat kurrikulare                   | Lëndët mësimore                      | Shkalla III |           |           | Shkalla IV |           |           |
|--------------------------------------|--------------------------------------|-------------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|
|                                      |                                      | Kl. VI      | Kl. VII   | Gjithsej  | Kl. VIII   | Kl. IX    | Gjithsej  |
| Gjuhët dhe komunikimi                | Gjuhë amëtare                        | 5           | 5         | 10        | 5          | 4         | 9         |
|                                      | Gjuhë e huaj                         | 2           | 2         | 4         | 2          | 2         | 4         |
|                                      | Gjuhë e dytë e huaj                  | 1           | 1         | 2         | 1          | 1         | 2         |
| Artet                                | Art muzikor                          | 1           | 1         | 2         | 1          | 1         | 2         |
|                                      | Art figurativ                        | 1           | 1         | 2         | 1          | 1         | 2         |
| Matematikë                           | Matematikë                           | 4           | 4         | 8         | 4          | 4         | 8         |
| Shkencat natyrore                    | Fizikë                               | 2           | 2         | 4         | 2          | 2         | 4         |
|                                      | Kimi                                 | /           | 2         | 2         | 2          | 2         | 4         |
|                                      | Biologji                             | 2           | 2         | 4         | 2          | 2         | 4         |
| Shoqëria dhe mjedisi                 | Histori                              | 2           | 2         | 4         | 2          | 2         | 4         |
|                                      | Gjeografi                            | 2           | 2         | 4         | 2          | 1         | 3         |
|                                      | Edukatë qytetare                     | 1           | 1         | 2         | 1          | 2         | 3         |
| Edukata fizike, sportet dhe shëndeti | Edukata fizike, sportet dhe shëndeti | 2           | 2         | 4         | 2          | 2         | 4         |
| Jeta dhe puna                        | Jeta dhe puna                        | 2           | 2         | 4         | 2          | 2         | 4         |
| Pjesa zgjedhore                      | Pjesa zgjedhore                      | 2           | 1         | 3         | 1          | 2         | 3         |
| <b>Totali - Orë javore</b>           |                                      | <b>29</b>   | <b>30</b> | <b>59</b> | <b>30</b>  | <b>30</b> | <b>60</b> |

Për secilën lëndë mësimore MASHT-i i përgatit programet mësimore. Ato duhet të reflektojnë kërkesat e KK, përkatësisht kërkesat e KB-së, si qëllimet dhe parimet e KK, rezultatet e kompetencave për shkallë, konceptet dhe RN-ët e fushës për shkallë, çështjet ndërkurrikulare dhe metodologjitë e mësimdhënies, nxënies dhe vlerësimit me qasjen e përcaktuar në dokumentet e sipërpërmendura. Në këtë kontekst programi mësimor duhet të përmbajë:

- Rezultatet e të nxënimit që nxënësit duhet t'i arrijnë në kuadër të secilës lëndë dhe temë mësimore përgjatë një klase/viti shkollor -mësimor;
- Temat mësimore të lëndëve përkatëse për secilën klasë, duke pasur parasysh kohezionin horizontal dhe vërtikal, aktualitetin, zhvillimin shkencor, mundësitë dhe interesat e nxënësve;



- Udhëzimet metodike për realizimin e temave mësimore në kuadër të lëndës përkatëse, arritjes së kompetencave, zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare dhe vlerësimit të nxënësve.

### 3. Autonomia e shkollës

Shkolla është e obliguar që t'u bëjë të mundur gjithë nxënësve të kalojnë minimumin e kohës mësimore të përcaktuar me plan mësimor. Për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë dhe për ata që i tejkalojnë pritjet që janë paraparë me kurrikulë, përkatësisht me program mësimor, shkolla mund të organizojë mësim plotësues dhe shtues mbi minimumin e përcaktuar me plan mësimor. Mbi këtë minimum mund të përcaktojë kohë mësimore (orë mësimore) edhe për aktivitete jashtëkurrikulare.


Për praktikat e shfytëzimit të kohës mësimore mbi minimumin e kohës së përcaktuar me plan mësimor për klasë, shkolla mund të vendos, në bashkëpunim me prindërit, nxënësit, autoritetet lokale të arsimit dhe palët e tjera të interesit, në mënyrë që shfrytëzimi i kësaj kohe mësimore që është në autonomi të shkollës të bëhet në mënyrë inovative dhe fleksibile dhe t'i kontribuojë përkrahjes së nxënësve në zotërimin e kompetencave.

*Koha mësimore, mbi minimumin e përcaktuar me Kurrikulë Bërthamë, mund të përdoret edhe për:*

- aktivitete jashtëkurrikulare;
- aktivitetet shtesë të mësimdhënies dhe nxënies, që mund të ndihmojnë në arritjen e kompetencave specifike (p.sh. projekte, shërbime për bashkësinë, aktivitete artistike dhe sportive);
- përforcimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në fusha të caktuara mësimore;
- adoptimin e temave/kurseve/moduleve opsionale të ofruara prej MASHT;
- zhvillimin e aktiviteteve specifike të shkollës, të cilat i përcaktojnë projektet shkollore (si: mësimdhënia dhe nxënia e gjuhëve, TIK-u,);
- përforcimin e orientimit në karrierë dhe përgatitja për jetë dhe për punë;
- etj.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## VI

### METODOLOGJIA E PËRGJITHSHME - UDHËZIME

Hyrje

Mësimdhënia dhe të nxënit me në qendër nxënësin dhe gjithëpërfshirja

Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave

Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar

Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar

Çështjet/temat ndërkurrikulare

Veprimtaritë/ Aktivitetet jashtëkurrikulare

## a. Hyrje

Metodologjitë mësimore zbatojnë parimet e mësimdhënies që janë përcaktuar në KK. Ato synojnë mësimdhënie efektive që mundësojnë zhvillimin e kompetencave kryesore.

Për arritjen e rezultateve të kompetencave çdo fushë e kurrikulës ose lëndë mësimore ka veçantitë e saja për organizimin e punës mësimore. Pavarësisht nga specifikat e tyre, gjithë procesi mësimor në lëndë të ndryshme ka disa karakteristika të përbashkëta në rrafshin metodologjik. Ai përqendrohet në aspektet në vijim<sup>9</sup>:

- Në mësimdhënie dhe nxënie me në qendër nxënësin dhe gjithëpërfshirja;
- Në mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar;
- Në mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave;
- Në mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar;
- Çështje/tema ndërkurrikulare dhe
- Në çështje jashtëkurrikulare

## b. Mësimdhënia dhe të nxënit me në qendër nxënësin dhe gjithëpërfshirja

Zbatimi i qasjes së mësimdhënies dhe nxënies me në qendër nxënësin kërkon që procesi i planifikimit dhe i organizimit të mësimdhënies dhe nxënies të mbështetet në përvojat individuale të nxënësve, në potencialet, nevojat dhe interesimet e tyre.

Mësimdhënia dhe nxënia me në qendër nxënësin, mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes, i cili merr parasysh dhe adreson stilet e ndryshme të të nxënit, mënyrën dhe shpejtësinë me të cilën mësojnë nxënësit, si dhe aspektet e tjera të diversitetit të nxënësve, duke përfshirë gjininë, moshën, kulturën, prejardhjen shoqërore dhe ekonomike, si dhe nevojat e veçanta të nxënësve. Në këtë kontekst mësimdhënie dhe nxënie me në qendër nxënësin bëhet, ku:

- mësimdhënia çdoherë i përshtatet nxënies së suksesshme të nxënësve;
- krijohet një mjedis i këndshëm e miqësor në klasë me qëllim që të nxitet interesimi dhe motivimi i nxënësve për të nxënë;
- mësuesi gjatë punës/aktivizimit të nxënësve, mbikëqyr, ndihmon dhe lehtëson të nxënit e nxënësve;
- nxënësi është pjesëmarrës aktiv dhe i angazhuar/i përfshirë në aktivitetet që nxisin nxënien dhe interesimin e nxënësve;
- temat e mësimore janë relevante dhe interesante për nxënësit;
- nxënësit inkurajohen të bëhen përgjegjës, të pavarur e reflektiv dhe të vazhdojnë të nxënit gjatë gjithë jetës së tyre;
- mësuesi ndjek/përcjell ndryshimet individuale të nxënësve përmes vrojtimit dhe bashkëveprimit;
- aktivitetet mësimore përshtaten në bazë të nivelit zhvillimor të nxënësit;
- mësimdhënia dhe vlerësimi planifikohen duke pasur parasysh zhvillimin individual dhe stilet e të nxënit të nxënësit;
- ofrohen llojllojshmëri të mundësive të nxënies dhe të metodave të vlerësimit, për të përkrahur stilet e ndryshme të nxënies së nxënësit;
- përdoren burime të ndryshme të nxënit që nxisin pjesëmarrjen, vëzhgimin, pavarësinë, kërkimin dhe kureshtjen e nxënësve;
- vrojtimit dhe vlerësimet e nxënësve përdoren për të planifikuar mësimdhënien e mëtejshme;

<sup>9</sup> Udhëzime specifike për të gjitha aspektet kryesore të këtij kapitulli pasqyrohen në kuadër të udhëzimeve për fushat e kurrikulës, si dhe në udhëzuesit për mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



- o njihen dhe trajtohen në mënyrën e duhur nxënësit e talentuar dhe ata që kanë vështirësi në të nxënë.

Me rëndësi është që mësuesi të shfrytëzojë një gamë të gjerë të metodave mësimore, duke baraspeshuar metodologjinë e përqendruar tek mësuesi me atë të përqendruar në nxënësin, duke iu përshtatur nxënësve dhe rezultateve të të nxënit të përcaktuara/ përzgjedhur për secilën orë mësimi.

Realizimi i mësimdhënies me në qendër nxënësin kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm mes mësuesve për përzgjedhjen e metodateve dhe mjetet mësimore, me qëllim shkëmbimin e përvojave të mira.

Po kështu, puna edukative cilësore e shkollës nënkupton bashkëpunim të rregulltë dhe të vazhdueshëm me prindërit për të përkrahur nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënit dhe të kompetencave kryesore.

## c. Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave

KK-ja promovon mësimdhënien dhe të nxënit që është në funksion të arritjes së kompetencave kryesore dhe adresimit të nevojave të ndryshme të nxënësve.

Mësimdhënia e fokusuar në arritjen në kompetenca, kërkon përzgjedhjen dhe organizimin e përvojave mësimore të cilat integrojnë njohuritë relevante me vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë e nxënësve. Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca duhet nisur nga rezultatet e të nxënit , të cilat na orientojnë se çka nxënësi duhet të dijë, të bëjë, të kuptojë, të vlerësojë dhe të marrë qëndrim me përfundimin e suksesshëm të një shkalle të kurrikulës.

Planifikimi dhe realizimi i mësimdhënies kërkohet që të bëhet i mundshëm duke u mbështetur në rezultatet e nxënit për fusha kurrikulare, përkatësisht për lëndë mësimore, me synim kryesor arritjen e kompetencave të parapara në shkallën përkatëse të kurrikulës, Zbërthimi i tyre duhet të jetë në harmoni të plotë me dinamikën e arritjes së nxënësve dhe zhvillimin e tyre psiko-social.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika, mjete dhe forma të ndryshme të punës me nxënës, si dhe të riorganizojnë përvojat mësimore të nxënësve duke i integruar njohuritë relevante me shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.

*Për realizimin me sukses të mësimdhënies me bazë kompetenca nga mësimdhënësi kërkohet:*

- o Mësimdhënie të integruar, holistike (tërësore), që dukuritë që ndodhin në natyrë dhe shoqëri të kuptohen të ndërlidhura/ndërvarura dhe ashtu siç ndodhin në jetën e përditshme (në funksion të saj mund të jenë, lidhja me jetën, korrelacioni mes lëndëve mësimore dhe fushave të kurrikulës, duke identifikuar çështjet/temat e përbashkëta, pastaj çështjet/temat ndërkurrikulare dhe aktivitete jashtëkurrikulare;
- o Zhvillimi i mësimdhënies dhe të nxënies me bazë situatë jetësore/mësimore.
- o Ndërlidhje e njohurive të reja me përvojat paraprake të nxënësve.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

*Ka qasje dhe strategji të shumta që mundësojnë mësimdhënie dhe nxënie bazuar në arritjen e suksesshme të kompetencave të nxënësit, pa marrë parasysh fushën e kurrikulës a lëndën mësimore. Vlen për t'i veçuar disa qasje të rëndësishme që mbështesin parimet e KK-së, pra edhe qasjen e bazuar në kompetenca:*

- Krijimi i mjedisit të përshtatshëm/miqësor, në klasë dhe në shkollë, në të cilin nxënësit ndihen të mirëpritur dhe të lidhur me njëri-tjetrin, me mësuesin dhe me shkollën e tyre;
- Zhvillimi i mësimëve nëpërmjet qasjeve dhe teknikave të të nxënësit aktiv dhe duke vepruar;
- Zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënies, zgjidhjes së problemeve dhe zhvillimit të të menduarit kritik/ kreativ dhe krijues;
- Të mësuarit me projekte, ekipor dhe hulumtues, me çka ndihmohet zhvillimi i disa aftësive dhe shkathtësive që janë në koherencë me kompetencat e kurrikulës.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca është e lidhur ngushtë edhe me procesin e vlerësimit, me fokus të veçantë me vlerësimin formativ dhe progresiv. Vlerësimi me bazë kompetenca ka të bëjë jo vetëm me performancën sasiore të përmbajtjes së përvetësuar, por edhe me performancën e përgjithshme përfshin cilësinë e performancës, si procedant e nxënies, e performimit dhe vetvlerësimit në kontekstin e nxënies së suksesshme.

Për të vlerësuar kompetencat e nxënësve, është e rëndësishme që secili mësues të përzgjedhë teknika dhe instrumente për vlerësim, të cilat u mundësojnë nxënësve të demonstrojnë e të shpërshfaqin njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e tyre, e jo vetëm njohuritë faktike. Në këtë mënyrë mësuesit sigurojnë informacion për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies, përparimin e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave.

## **d. Mësimdhënia dhe të nxënësit e integruar**

Lëndët mësimore, duke u mësuar të ndara nga njëra-tjetra, ndikojnë që nxënësit të marrin njohuritë, t'i zhvillojnë shkathtësitë dhe qëndrimet në mënyrë të fragmentuar (të shkëputur/parcializuar). Kështu vështirësojnë të kuptuarit proceseve të natyrës dhe të shoqërisë si një tërësi dhe në ndërvarësi. Me qëllim të integritit të këtyre aspekteve, Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, realizohet përmes lëndëve mësimore të integruara në fusha të kurrikulës dhe përmes mësimdhënies e nxënies së bazuar në qasjen e integruar.

Mësimdhënia dhe nxënia e integruar është në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të parapara për shkallë kurrikulare.

Për t'i zbatuar me sukses kërkesat e KK-së dhe të Kurrikulës Bërthamë për KSNA 2, mësuesit përgatitorë dhe fillorë duhet të zbatojnë mësimdhënien dhe të nxënësit e integruar, duke bërë:

- ndërlidhjen/korrelacionin e fushave kurrikulare/lëndëve mësimore, ku përmbajtjet e veçanta dhe të përbashkëta mësimore ndihmojnë njëra-tjetrën në zhvillimin e kompetencave kryesore për shkallë kurrikulare;
- integrimin në procesin e mësimdhënies dhe në nxënies të karakteristikave të përbashkëta të lëndëve të fushës përkatëse (p.sh., të gjuhës amtare me gjuhën angleze) apo të karakteristikave të përbashkëta të fushave kurrikulare (p.sh., të fushës *Shoqëria dhe mjedisi* me fushën *Shkencat natyrore*);

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



- Ndërlidhjen e mësimdhënies me temat/praktikat jetësore, ku gjërat kuptohen natyrshëm se si funksionojnë në natyrë dhe shoqëri
- Ndërlidhjen e mësimdhënies më përvojat e nxënësve, gjë që ndihmon ndërtimin më të lehtë të dijes duke vazhduar mbi atë që nxënësit dijnë dhe bëjnë.
- Trajtimin e çështjeve (temave) ndërkurrikulare përmes secilës fushë kurrikulare duke i ndërlidhur rezultatet e të nxënimit me tema ndërkurrikulare apo përmes projekteve të përbashkëta ndërfushore- ndërlëndore
- Aktivitete me nxënës që të zhvillojnë kompetencat për të gjetur dhe për të përpunuar informata në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, për shfrytëzimin e mësimin elektronik, të teknologjive aktuale dhe të ardhshme në epokën digjitale;
- Aktivitete me nxënës që promovojnë perspektivën e mësimin tërëjetësor (gjatë gjithë jetës), të cilat i ndihmojnë nxënësit që të zhvillojnë kompetencat e tyre për t'u ballafaquar me sfidat dhe mundësitë brenda zhvillimeve në shoqërinë dhe në ekonominë e sotme dhe të ardhshme.

## e. Mësimdhënia dhe të nxënimit e diferencuar

Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar paraqesin një qasje sipas së cilës mësimdhënia, për zhvillimin e kapaciteteve të të gjithë nxënësve, mbështetet në planifikim, në zbatim, në kontroll, në përkrahje dhe në vlerësim të kapaciteteve mendore dhe fizike të nxënësit.

Bazohet në përfilljen e dallimeve ekzistuese ndërmjet kapaciteteve mendore dhe fizike të nxënësve të së njëjtës klasë përkritazi me përmbajtjen që do të mësojnë, ecurinë didaktiko-metodike të të nxënimit si dhe matjet dhe materialet çfarë duan dhe mund të shfrytëzojnë gjatë mësimin.

Mësimdhënia e diferencuar mundëson përshtatjen kohës dhe e shpejtësisë së të nxënimit me veçoritë individuale të secilit nxënës.

Gjithashtu, bëhet edhe përshtatja e vëllimit, llojit dhe shkallës së vështirësisë së përmbajtjeve, detyrave dhe obligimeve me veçoritë individuale të nxënësve.

Mësuesi, për ta organizuar dhe për ta zbatuar në mënyrë të suksesshme mësimdhënien dhe nxënien e diferencuar, duhet të mbështetet në motivet, në aftësitë, në interesimet dhe në stilet e të nxënimit të nxënësit. Këto janë kërkesat kryesore në të cilat mësuesi duhet ta mbështesë mësimdhënien e diferencuar.

*Mësuesit e nivelit të parë të arsimit, për organizimin dhe zbatimin me sukses të mësimdhënies dhe të nxënies së diferencuar duhet të:*

- bëjnë forma të organizimit mësimor, të cilat promovojnë dhe ndihmojnë zhvillimin e motivimit të brendshëm të nxënësve dhe të mekanizmave të vetëkontrollit/organizimit të nxënies;
- përdorin me efikasitet *aktivitetet me nxënës të cilat promovojnë nxënien e organizuar;*
- organizojnë procesin mësimor përmes qasjeve të ndryshme të cilat mundësojnë dhe lehtësojnë hulumtimin dhe identifikimin e përvojave ekzistuese të nxënësve, të njohurive, të pikëpamjeve të tyre dhe të cilat mundësojnë përfshirjen aktive të

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

nxënësve në përmirësimin e gabimeve të mundshme, si dhe përkrahin nxënësit që të riorganizojnë njohuritë e tyre faktike dhe procedurale për arritjen e kompetencës së nxënësit për të nxënë;

- përdorin teknika dhe forma të ndryshme të nxënies bashkëpunuese në procesin mësimor;
- praktikojnë format e ndryshme organizative të mësimdhënies dhe nxënies (aktivitetet në klasë, puna në grupe, puna në çift, nxënia individuale), që fokusohen në aktivitetet që zhvillojnë vetëbesimin, iniciativën, inkurajimin, zgjidhjen e problemave dhe kreativitetin e nxënësve;
- përdorin materiale dhe burime mësimore që u përshtaten mundësive absorbuese të nxënësve;
- organizojnë mësimdhënien dhe nxënien përmes detyrave të diferencuara, ku përmbushja e tyre, kontrolli, vlerësimi dhe shkalla e ndihmës që ofrohet prej mësuesit i përshtatet mundësive të secilit nxënë;
- përdorin teknika të organizimit të mësimit që i përshtaten një detyre të caktuar përmes së cilës zhvillojnë aftësitë e veçanta të nxënësve të favorizuar/përparuar;
- përdorin forma të ndryshme për organizimin e nxënies për nxënësit, të cilët kërkojnë trajtim të veçantë, kanë nevoja të veçanta arsimore, duke përfshirë edhe nxënësit me vështirësi në të nxënë ose me vështirësi në sjellje;
- organizojnë mësimdhënien përmes së cilës ndihmojnë bashkëpunimin dhe përdorimin e formave organizative (p.sh., gjithëpërfshirjen) që i promovojnë mundësitë e barabarta për nxënie, si në sferën e bashkëpunimit mes nxënësve në aktivitetet brenda klasës dhe shkollës, ashtu edhe jashtë saj;
- përdorin teknologji mësimore të ndryshme, të cilat ofrojnë mundësi më të mëdha të organizimit të avancuar të mësimdhënies dhe të nxënies me anën e të cilave procesin mësimor e bëjnë më tërheqës për nxënësit.

## f. Çështje/temat ndërkurrikulare

Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët përfshin hapësirë për mësim përtej kufijve lëndorë në atë mënyrë që fëmijët/nxënësit të mund të ndërtojnë lidhje mes fushave të Kurrikulës dhe lëmenjve të ndryshëm.

*Studimet ndërdisiplinore*, të bazuara në grupimin e përvojave dhe rezultateve të fushave të ndryshme të Kurrikulës dhe *çështjet ndërkurrikulare* duhet të ofrojnë përvoja relevante, sfiduese dhe që sjellin kënaqësi në kontekstin e përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të ndryshme të fëmijëve dhe të të rinjve.

Krijimi i ndërlidhjeve mes fushave kurrikulare krijon mundësi për progres në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve, për njohjen dhe të kuptuarit e koncepteve të reja apo të rishikimit dhe të përforsimit të koncepteve a të shkathtësive nga perspektiva të ndryshme. Gjithashtu,



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



kjo qasje ndihmon që kurrikula të jetë koherente dhe më kuptimplotë nga pikëpamja e nxënësit.

Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare në Kurrikulën Bërthamë të arsimit të mesëm të ulët mund të realizohet nëpërmjet:

- gjetjes së korrelacioneve midis lëndëve/temave apo njësive mësimore me qëllim të realizimit/arritjes së ndonjërës nga kompetencat e KK-së, p.sh., nëse tema mësimore është nga mbrojtja e mjedisit, atë e ndërlidhim edhe me çështjet gjuhësore, letrare, por edhe me matematikë, edukatë qytetare etj. Pra, ka mundësi të shumta për të gjetur këso ndërlidhjesh nëpërmjet të cilave arrijmë disa objektiva mësimore të fushave të ndryshme kurrikulare:
- formës së projekteve individuale apo të kurseve me zgjedhje në të cilat ndërlidhen, duke ndihmuar njëra-tjetrën, tema apo fusha të ndryshme, si, p.sh., projekte në fushën e edukimit qytetar me udhëzim në karrierë etj., të cilat gjithashtu ndihmojnë realizimin e kompetencave të veçanta.

Çështjet ndërkurrikulare janë tema me interes të veçantë për individin dhe për shoqërinë, sa janë aktuale janë edhe të vazhdueshme. Ato sipas politikave kombëtare dhe ndërkombëtare identifikohen dhe përcaktohen si çështje të rëndësishme të cilat duhet trajtuar në mënyrë të veçantë.

Çështjet ndërkurrikulare nuk i takojnë vetëm një lënde a fushe kurrikulare. Ato i integrojnë fushat kurrikulare dhe lëndët mësimore me qëllim të përkrahjes së nxënësve që t'i kuptojnë dhe interpretojnë drejt proceset shoqërore dhe natyrore që ndodhin në shoqëri dhe në natyrë. Për çështjet ndërkurrikulare jepen orientime në kuadër të fushave të kurrikulës, lëndëve mësimore dhe bëhen pjesë e planifikimit mësimor në shkollë.

## Veprimtaritë/ aktivitetet ndërkurrikulare janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizmi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media
- Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

## Edukimi për qytetari demokratike

I referohet, njohjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut përfshirë të drejtat e fëmijëve, çështjet gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, LGBT-ë, parandalimit dhe lufimit të trafikimit, korrupsionit dhe çështje të tjera të ngjashme që cenojnë integritetin e individit në shoqëri, si dhe sundimit të ligjit.

## Edukimi për paqe

I referohet kuptimit të diversiteteve në shoqëri si vlera shoqërore. Përmbajtjet për edukimin për paqe janë toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa etnike, fetare, kulturore, racore, etj., dhe të jetuarit në harmoni me mjedisin natyror; lufta kundër terrorizimit, e drejta humanitare, dinjiteti njerëzor, ndalimi i dhunës, parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve.

### Globalizmi dhe ndërvarësia

I referohet shndërrimit të ekonomive nacionale në ekonomi globale – botërore, bashkëveprimet, kombinimit të aftësive dhe mundësive për të krijuar gjera të përbashkëta, kombinimit të përpjekjeve me të tjerët për të arritur suksese më të mëdha, për të bashkëpunuar dhe zhvilluar qytetërimet, etj. Tema e globalizimit dhe ndërvarësisë përfshijnë përmbajtjet lidhur me çështjet mjedisore, çështjet ekonomike, arsimore, shëndetësore, proceset e integritimit evropian, marrëveshjet ndërkombëtare, çështjet politike dhe agjendat ndërkombëtare, sistemin e rrjeteve të informimit dhe teknologjisë, etj.

### Edukimi për medie

I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave, komunikimin përmes medieve tradicionale dhe digjitale, kritikën ndaj medieve, gjuhën e medieve dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediet dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurtë të tyre etj. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur me mediet tradicionale dhe digjitale, televizionin, radion, filmin, gazetën, revistat, internetin, fotografitë, reklamat dhe lojërat elektronike, etikën në media, etj.

### Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si ndikimi i aktivitetit të njeriut në cilësinë e mjedisit, ngrohjen globale, biodiversitetin, energjinë e ripërtëritshme etj.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale bazuar në konventat ndërkombëtare. Përveç realizimit të së drejtës për mjedis të shëndetshëm ndërlidhet edhe me filozofinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi i brezit të ardhshëm.

### g. Veprimtaritë/aktivitetet jashtëkurrikulare

Veprimtaritë jashtëkurrikulare janë aktivitete të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe lëndëve mësimore, por që e ndihmojnë arritjen e kompetencave për shkallë të kurrikulës. Për secilin nga aktivitetet e mundshme, mësuesi dhe shkolla duhet të përgatisin plan dhe program të qëllimshëm, të orientuar, e jo aktivitete stihike apo të rastit.

*Në arsimin e mesëm të ulët, mësimdhënia dhe nxënia në fushat e ndryshme të kurrikulës do të mbështeten me anë të aktiviteteve jashtëkurrikulare të organizuara për nxënës, si:*


- Vizitat në muze, në parqe, në vende në natyrë dhe në vende historike, në institucione, në galeri, në teatër etj.;
- Festimet për data të veçanta, festa, nga tradita;
- Pjesëmarrja në vendimmarrje në shkollë dhe në format e tjera të demokracisë së shkollës;
- Pjesëmarrja në grupe mësimore, në aktivitete të lira dhe në shoqata;

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

- Diskutimet me mysafirët (d.m.th., me udhëheqësit e bashkësisë, me prindërit, me përfaqësuesit e bizneseve lokale, me politikanë, me njerëz të medias);
- Puna me projekte që fokusohen në tema dhe në çështje specifike të karakterit shumëdimensional që përkojnë me moshën e nxënësve;
- Ekspozitat (d.m.th. artet e bukura, fotografia);
- Shërbimet për bashkësinë (d.m.th. ndihma për personat në nevojë, mbrojtja e mjedisit, forcimi i lidhjeve midis brezave);
- Lojërat, koret, rivistat e shkollës;
- Puna vullnetare.

Rekomandohet që të gjithë nxënësve t'u mundësohet të përfshihen në çështje/veprimtari jashtëkurrikulare, sipas preferencave dhe talentit personal të jenë pjesë e një grupi në aktivitete të ndryshme: ekipe sporti, grup muzikor, ansambël vallëzimi, kor, ansambël teatri, grup për ofrimin e mbështetjes për bashkësinë.



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## VII Vlerësimi – udhëzime të përgjithshme

Hyrje  
Qëllimet e vlerësimit  
Parimet themelore të vlerësimit  
Llojet e vlerësimit  
Vlerësimi i brendshëm dhe Vlerësimi i jashtëm

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## 1. Hyrje

Sistemi i vlerësimit i definuar me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë, mbështetet në dokumentet dhe rezultatet e të nxënit që janë pikë referimi se çka duhet të vlerësohet, si dhe kur duhet të vlerësohet, procedurat dhe bartësit e vlerësimit për secilin lloj të vlerësimit dhe për secilin nivel të shkollimit.

Vlerësimi njohurive dhe aftësive të nxënësit si proces realizohet në funksion të mësimdhënies dhe të nxënies. Vlerësimi lidhet me tërësinë e instrumenteve, teknikave, metodave dhe praktikave që përdorin mësimdhënësit për të testuar, për të kontrolluar dhe për të matur nivelin dhe cilësinë e njohurive, aftësive dhe të performancës së nxënësve.

Realizimi i vlerësimit bëhet përmes qëllimeve, parimeve dhe llojeve të vlerësimit.

## 2. Qëllimet e vlerësimit

Përmes sistemit të vlerësimit, sigurohen informacione të vazhdueshme për cilësinë e të nxënit të nxënësve, mësimdhënien dhe përshtatshmërinë e kurrikulës. Mbi bazën e këtyre informacioneve merren vendime dhe planifikohen veprime në përkrahje të nxënësve për zotërim të kompetencave dhe përmirësim e avancim të procesit të mësimdhënies dhe të vlerësimi. Në këtë kontekst mundësohet realizimi i qëllimit kryesor të vlerësimit, të përcaktuar në KK - **Mbështetja e të nxënit të nxënësve**. Bazuar në këtë qëllim përcaktohen qëllime specifike sipas llojeve të vlerësimit dhe realizohet i gjithë procesi i vlerësimit.

Vlerësimi i nxënësve bazohet në rezultatet e të nxënit për kompetenca, fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore të përcaktuara për shkallën e pestë dhe të gjashtë të kurrikulës, si më poshtë:

| Dokumentet kurrikulare         | Rezultatet e të nxënit   |
|--------------------------------|--|
| KORNIZA E KURRIKULËS E KOSOVËS | Rezultatet e të nxënit të kompetencave në përfundim të arsimit parauniversitar.  |
| KURRIKULA BËRTHAMË II          | Rezultatet e të nxënit për kompetenca dhe fusha kurrikulare për të dy shkallët e nivelit të tretë të arsimit - shkallën e tretë. |
| PLANET DHE PROGRAMET LËNDORE   | Rezultatet e të nxënit sipas lëndëve (për secilën klasë, duke filluar nga klasa e 6-të, deri në klasën e 9-të).                  |

Vlerësimi me bazë kompetencat ka të bëjë jo vetëm me performancën sasiore të përmbajtjes së përvetësuar por edhe me performancën e përgjithshme përfshin cilësinë e performancës, si, proceduat e nxënies, e performimit dhe vetëvlerësimit në kontekstin e nxënies së suksesshme. Për të vlerësuar kompetencat e nxënësve, është e rëndësishme që secili mësimdhënës të përzgjedhë teknika dhe instrumente për vlerësim, të cilat u mundësojnë nxënësve të demonstrojnë e të shfaqin njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e tyre, e jo vetëm njohuritë faktike. Në këtë mënyrë mësuesit sigurojnë informacion për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies, përparimin e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave.

## 3. Parimet e vlerësimit

Vlerësimi i nxënësve edhe në këtë nivel të arsimit, bazohet në parimet e vlerësimit të përcaktuara në KK:

**Vlefshmëria.** Vlerësimi duhet të sigurojë se kërkesat dhe kriteret e vlerësimit të jenë të lidhura me rezultatet e të nxënit për klasën dhe shkallën e kurrikulës, të përdoren matje dhe burime të shumta

për të dhënë gjykimet dhe se vlerësimi mbulon shtrirjen dhe thellësinë e programit mësimor.

**Transparenca.** Vlerësimi duhet të sigurojë se kriteret, metodat dhe procedurat e vlerësimit janë të njohura për nxënës dhe për të gjithë akterët e përfshirë në procesin e vlerësimit. Informacioni për nxënësin lidhur me rezultatet e arritura, informatat kthyesë dhe mundësitë e përparimit të jetë i qartë, i saktë dhe të jepet me kohë.

**Besueshmëria.** Vlerësimi duhet të sigurojë se gjykimet për përparimin e nxënësit bazohen në instrumente, lloje të ndryshme të vlerësimit dhe burime të ndryshme të informacionit. Në këtë proces ofrohen dëshmi për të argumentuar cilësinë e vlerësimit dhe për t'u siguruar se nëse përsëritet vlerësimi atëherë rezultatet do të jenë të njëta.

**Paanshmëria.** Vlerësimi duhet të sigurojë se respektohen kërkesat e kodit etik të vlerësimit, respektohen procedurat e vlerësimit ndaj çdo nxënësi apo grupi të nxënësve, përdoren instrumente të ndryshme të vlerësimit që i mundësojnë secilit nxënës të shfaqë performancën e tij/saj dhe ofrohet mbështetja e duhur në të nxënët e nxënësve drejt zotërimit të kompetencave.

#### 4. Llojet e vlerësimeve

Nxënësit e arsimit të mesëm të lartë kalojnë nëpër dy lloje të vlerësimit:

- Vlerësim të brendshëm, dhe
- Vlerësim të jashtëm.

##### 4.1. Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel klase /shkollë nga mësimitdhënësi/et e lëndëve mësimore përkatëse dhe sipas përshkrimit të procedurave e kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore.

Vlerësimi i brendshëm u mundëson nxënësve të shprehin njohuritë e reja dhe të tregojnë nivelin e zotërimit të kompetencave, duke përfshirë:

- Gjerësinë dhe thellësinë e tyre;
- Gatishmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënët;
- Aftësinë për t'i zbatuar ato në situata dhe rrethana të reja.

Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm është mbështetja e të nxënët të nxënësve për zotërim të kompetencave të shkallës së pestë dhe të gjashtë. Kjo arrihet duke kombinuar vlerësimin formativ (për nxënie) me vlerësimin përmbledhës (i të nxënët).

Përmes vlerësimit formativ (për nxënie), mësimitdhënësi/vlerësuesi mbikëqyr përparimin e nxënësit gjatë procesit të nxënët, mbledh informacion për marrjen e vendimeve për të ofruar mbështetje nevojshme për të nxënët e nxënësve.

Ndërsa, me ndihmën e vlerësimit përmbledhës, mësimitdhënësi/vlerësuesi përcakton arritjet e nxënësit në përfundim të një detyre të caktuar, teme mësimore, kapitulli, periudhe mësimore etj., për të vendosur notat dhe për të certifikuar nxënësit për nxënie të mëtejshme. Vlerësimi përmbledhës përdoret edhe për të gjykuar efektivitetin e të nxënët ose të programit mësimor.

##### 4.1.1. Llojet e vlerësimit të brendshëm

*Korniza e Kurrikulës përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm të cilat janë të vlefshëm edhe për realizimin e KB:*

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

Korniza e kurrikulës për secilin nivel të arsimit ka përcaktuar periudhat e realizimit të secilit lloj të vlerësimit, bartësit/përgjegjësit e vlerësimit, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve. Për arsimin e mesëm të ulët, këto aspekte pasqyrohen në tabelën në vijim.

| Llojet e vlerësimit dhe periudha e realizimit  | Bartësit  | Qëllimet kryesore sipas llojeve të vlerësimit  | Dokumentimi/ evidentimi i arritjeve në vlerësim  |
|--|---|--|--|
| <b>Vlerësim i vazhdueshëm</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bëhet gjatë procesit të të nxënësve (<i>vlerësimi formativ</i>), dhe</li> <li>- Në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike apo periudhe të mësimin (<i>vlerësimi përmbledhës</i>)</li> </ul> | Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse   | <p>Mbështetja e të nxënësve të nxënësve;<br/>Informimi dhe raportimi</p> <p>Vendosja e notës;<br/>Informimi dhe raportimi;</p> <p>Planifikimi për mbështetjen e vazhdueshme të nxënësve të nxënësve.</p>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Evidencimi në notesin e punës së mësimdhënësit;</li> <li>- Evidencimi në libër të klasës i notave për periudhat e caktuara të vitit mësimor/ dhe apo ditarin elektronik;</li> <li>- Portfolio e nxënësit</li> </ul> |
| <b>Vlerësim përfundimtar</b><br>Bëhet në fund të vitit mësimor/ dhe vitit shkollor.  | Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse   | <p>Vendosja e notës përfundimtare në fund të vitit mësimor/ shkollor.<sup>2</sup><br/>Informimi dhe raportimi</p> <p>Planifikimi për mbështetjen e të nxënësve të nxënësve në vitin vijues.</p>  | Notat përfundimtare evidencohen në librin e klasës, në librin amë/ dhe/apo në ditarin elektronik, si dhe në dëftesën për klasë (në fund të klasave VI, VII, VIII dhe IX).  |
| <b>Vlerësim për shkallë<sup>3</sup></b><br>Realizohet në fund të çdo shkalle kurrikulare, përkatësisht në fund të klasës së VII-të dhe IX-të   | Ekipi profesional/ këshilli i mësimdhënësve të cilët kanë realizuar programin mësimor brenda një shkalle kurrikulare <sup>4</sup> | <p>Verifikimi i nivelit të arritjes së rezultateve të të nxënësve dhe zotërimi i kompetencave kryesore në nivel të një shkalle dhe fushe kurrikulare.<br/>Planifikimi për mbështetjen e të nxënësve të nxënësve në vitin vijues;<br/>Informim dhe raportim për prindërit dhe për institucionet arsimore;</p> | <p>Evidencimi përshkruar në librin e klasës – në faqet e veçanta për vlerësimin përmblyllës në fund të çdo shkalle të kurrikulës<sup>5</sup>.</p> <p>Në raportet përmbledhëse të aktiveve profesionale dhe këshillave të klasës</p>                          |

<sup>2</sup> Nota përfundimtare e një lëndë mësimore reflekton nivelin e performancës së nxënësit gjatë një viti shkollor. Nota përfundimtare formohet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzimin administrativ për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së re.

<sup>3</sup> Është vlerësim i standardizuar dhe bëhet në dy mënyra: (a) Me teste të përgatitura nga autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga MASHT dhe të menaxhuara nga shkolla, dhe (b) Me teste të përgatitura dhe të menaxhuara nga vetë autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga MASHT ose ndonjë institucion tjetër i përcaktuar nga MASHT-i. Rezultatet e këtij vlerësimi analizohen në nivel shkolle dhe krahasohen me evidencat e vëna në dispozicion nga mësimdhënësit që e mbulojnë fushën kurrikulare për të dëshmuar progresin e secilit nxënës, secilës klasë dhe shkollës në përgjithësi. Evidencat duhet të jenë të dokumentuara në portfoliot e nxënësve dhe të prezantohen edhe në raportin vjetor të shkollës. Vlerësimi për shkallën e 3-të, përkatësisht klasën IX ndërlidhet me vlerësimin e jashtëm.

<sup>4</sup> Vlerësimi i brendshëm për shkallë organizohet me bazë në shkollë dhe administrohet nga kryesuesit e organeve profesionale të shkollës së kurrikulës si dhe përkrahjet nga organet udhëheqëse në shkollë dhe nga Drejtoritë Komunale të Arsimit.

<sup>5</sup> Përshkrimi i vlerësimit në fund të shkollës mbështetet në evidencat dhe në mesataren e arritjeve në testin e standardizuar. Përshkrimi i vlerësimit në fund të shkollës përcaktohet me akte nënligjore/udhëzim administrativ).



### 4.2. Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i jashtëm për KSNA 2 bëhet në fund të klasës së nëntë (IX) dhe bëhet me qëllim matjen e nivelit të arritjes së kompetencave dhe me qëllim të certifikimit për mundësi vazhdimi të shkollimit të mesëm të lartë. Ky vlerësim organizohet nga autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga MASHT.

Vlerësimi në këtë nivel mund të bëhet edhe për qëllime të tjera, varësisht nga qëllimi mund të autorizohen edhe institucione të tjera arsimore nga MASHT-i.

*Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet edhe për këto qëllime:*

- vendimmarrjeje e politikëbërjes në fusha të ndryshme të arsimit;
- hulumtimi dhe zhvillimi;
- inspektimi dhe verifikimi i cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle dhe komune.

Vlerësimet e standardizuara shtetërore janë të përqendruara në matjen e nivelit të zotërimit të kompetencave kryesore të parapara në kurrikulë për secilin nivel të arsimit.

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



## Aneks: Fjalorth i termave për mësimdhënës<sup>10</sup>

| KONCEPTI                               | SHPJEGIMI  | KONCEPTET EKVIVALENTE         |
|--|--|-------------------------------|
| <b>Aftësitë për jetë</b>               | Aftësitë për jetë janë aftësi psiko-sociale, për sjellje adaptive dhe pozitive që u mundësojnë individëve për t'u marrë në mënyrë efektive me kërkesat dhe sfidat e jetës së përditshme. Ato grupohen në tri kategori të gjera të aftësive: aftësitë njohëse për analizimin dhe përdorimin e informacionit, aftësitë personale për të menaxhuar dhe udhëhequr veten, dhe aftësitë ndërpersonale për të komunikuar dhe ndërvepruar në mënyrë efektive me të tjerët. |                               |
| <b>Aktivitetet përmirësuese</b>        | Mundësi dhe përvoja mësimore që ofrohen me qëllim të sigurimit të ndihmës për nxënësit që të tejkalojnë vështirësitë në të nxënë në mënyrë efektive.   |                               |
| <b>Aktivitetet ekstra-kurrikulare</b>  | Aktivitete të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve dhe fushave mësimore formale, por që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave.  | Aktivitetet jashtëkurrikulare |
| <b>Arsimi</b>                          | Veprimtari themelore e institucioneve arsimore që siguron krijimin dhe shndërrimin e njohurive; përsosjen e kompetencave gjatë gjithë jetës; zhvillimin vetjak; zhvillimin dhe shndërrimin e kulturës. Rezultat i nxënies së qëllimshme, të planifikuar dhe të organizuar në mënyrë formale dhe joformale.   |                               |
| <b>Arsimi dhe aftësimi profesional</b> | Arsimi dhe aftësimi për t'iu mundësuar nxënësve që të fitojnë shkathhtësi për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara, përveç arritjes së kompetencave kryesore të përcaktuara përmes kornizës së kurrikulës.   |                               |
| <b>Arsimi i detyrueshëm</b>            | Arsimi i detyrueshëm në Kosovë është i rregulluar me ligj, përfshin arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (KSNA 1 dhe 2).  |                               |
| <b>Arsimi fillor</b>                   | Niveli i parë i arsimt prej pesë vitesh kohëzgjatje. Ky nivel përfshin edhe klasën përgatitore që e zgjat ciklin në gjashtë vite (KSNA 1).   |                               |
| <b>Arsimi formal</b>                   | Arsim i qëllimshëm, i institucionalizuar, i planifikuar, i strukturuar në mënyrë hierarkike, që fillon me arsimin parashkollor dhe vazhdon deri në arsimin pasuniversitar. Rezultatet dhe kualifikimet e fituara në arsimin formal njihen me certifikata dhe diploma.  |                               |
| <b>Arsimi gjithëpërfshirës</b>         | Arsimi gjithëpërfshirës është proces që adreson dhe u përgjigjet nevojave të ndryshme të të gjithë nxënësve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në të nxënë dhe duke reduktuar përjashtimin në të dhe përmes tij.  |                               |
| <b>Arsimi informal</b>                 | Përvetësimi dhe zhvillimi i dijeve, shkathhtësive dhe qëndrimeve jashtë mjediseve arsimore formale ose joformale gjatë përvojave të përditshme në mënyrë jo sistematike dhe të paplanifikuara.   |                               |

<sup>10</sup> Termat që nuk janë relevantë për mësimdhënësit mund të hiqen.


# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

|   |   |                      |
|---|---|----------------------|
| <b>Arsimi joformal</b>                    | <p>Çfarëdo aktiviteti i organizuar dhe i qëndrueshëm që nuk korrespondon saktësisht me përkufizimin e arsimit formal.</p> <p>Prandaj arsimi joformal mund të mbahet brenda dhe jashtë institucioneve arsimore dhe iu shërben personave të të gjitha moshave.</p> <p>Programet e arsimit joformal nuk përcjellin detyrimisht sistemin e 'përshkallëzuar' dhe mund të jenë të ndryshme në kohëzgjatje. Për këtë lloj arsimimi mund të jepen ose të mos jepen certifikata për suksesin e arritur në mësim.</p> |                      |
| <b>Arsimi i mesëm i ulët</b>              | Niveli i parë i arsimit të mesëm (katërvjeçar në Kosovë) (KSNA 2).  |                      |
| <b>Arsimi i mesëm i lartë</b>             | Niveli i dytë i arsimit të mesëm (KSNA 3).  |                      |
| <b>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</b> | Procesi i zhvillimit të njohurive të nxënësve, i të kuptuarit, i shkathtësive dhe atributëve të nevojshme për të punuar dhe jetuar në një mënyrë që mbron mirëqenien mjedisore, sociale dhe ekonomike, si në të tashmen dhe për brezat e ardhshëm.  |                      |
| <b>Autonomia e shkollës</b>               | E drejtë e garantuar që i jepet shkollës për të vendosur për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle, vlerësimin, menaxhimin e burimeve njerëzore në dispozicion të saj dhe për menaxhimin e burimeve financiare. Të gjitha këto ndërlidhen me llogaridhënien.   |                      |
| <b>Burimi i të mësuarit</b>               | Referenca dhe përkrahje për mësimin e nxënësve, përfshirë tekste shkollore, softverët arsimorë, vegla eksperimentale, atlase, fjalorë, ushtrimore, etj.   |                      |
| <b>Çështjet ndërkurrikulare</b>           | Përmbajtje e rëndësishme kurrikulare që nuk i përket krejtësisht vetëm një lënde apo fushe të kurrikulës ekskluzivisht mësimore, por që mësohet në disa lëndë. Shembuj të zakonshëm janë edukimi për paqe, të drejtat e njeriut dhe edukata qytetare, çështjet gjinore, shkathtësitë e komunikimit, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, edukimi ndërkulturor etj.  | Temat të ndërlidhura |
| <b>Dija</b>                               | Tërësia e njohurive pak a shumë sistematike, të përvetësuara në një fushë të caktuar; gjithçka që dihet për botën që na rrethon.  |                      |
| <b>Ekonomi dhe shoqëri e dijes</b>        | Shoqëri dhe ekonomi në të cilën dija bëhet burimi kryesor i zhvillimit dhe përparimit.  |                      |
| <b>Edukimi për ndërmarrësi</b>            | Në kuptimin e ngushtë: pajisja e fëmijëve dhe të rinjve më shkathtësi ndërmarrëse siç janë iniciativa, vendimmarrja, ndërmarrja e riskut, udhëheqja, shkathtësi menaxheriale dhe organizative.<br>Në kuptim më të gjerë: përgatitja e fëmijëve dhe të rinjve që të marrin role ndërmarrëse në ekonomi, d.m.th. të krijojnë bizneset/ ndërmarrjet e tyre.  |                      |
| <b>Edukimi shoku – shokun</b>             | Proceset e mësimin të bazuara në këmbimin e informatave, dijes dhe përvojave mes shokëve në të cilat ata veprojnë si persona burimorë lehtësues të mësimin dhe/ose mentorë.   | Mësimi nga shokët    |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



|                                  |  |  |
|----------------------------------|--|--|
| <b>Fushë kurrikulare</b>         | Një bashkësi lëndësh që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave të nxënësit.  | Fushë kurrikulare  |
| <b>Klasë bashkëvepruese</b>      | Mjedisi mësimor në nivel klase që bazohet në shkëmbime të vazhdueshme mes mësimdhënësve dhe nxënësve në kontekstin e aktiviteteve të bazuara në kërkim, zgjidhje të problemeve dhe punë konkrete.  |  |
| <b>Kompetenca</b>                | Aftësi të gjera për t'i zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, rutinat, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse.  | Harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit. |
| <b>Kompetencat kryesore</b>      | Kompetenca që konsiderohen nga sistemi i arsimit dhe aftësimi si të rëndësishme për të nxënësit e secilit individ të shoqërisë.  | Kompetencat gjenerike, transversale apo gjithëpërfshirës   |
| <b>Konceptet themelore</b>       | Konceptet themelore paraqesin tërësi kuptimore, të cilat janë pjesë përbërëse të mendimeve. Konceptet përvetësohen dhe rrënjosen tek nxënësit gjatë tërë jetës. Konceptet i referohen një konteksti të caktuar dhe orientojnë përgatitjen e përmbajtjeve, rezultateve të të nxënësit dhe sigurojnë lidhjen ndërmjet lëndëve mësimore brenda një fushe kurrikulare. |  |
| <b>Korniza Kurrikulare</b>       | Kornizë kurrikulare është dokumenti themelor në të cilin përshkruhen orientimet dhe udhëzimet kryesore për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar (qëllimet e arsimit, kompetencat kyçe, rezultatet e të nxënësit sipas niveleve etj.).   |  |
| <b>Kurrikula</b>                 | Përvoja e të nxënësit gjithëpërfshirës e planifikuar në bazë të qëllimeve, vlerave, iniciativave, burimeve dhe aktiviteteve në rregullimet formale dhe joformale.  |  |
| <b>Kurrikula Bërthamë</b>        | Kërkesat e përbashkëta për të gjithë nxënësit në aspektin e kompetencave kryesore, lëndët e përbashkëta dhe orientimet e përgjithshme.   |  |
| <b>Kurrikula me bazë shkolle</b> | Pjesa e kurrikulës që përgatitet dhe zbatohet në nivel shkolle.  |  |
| <b>Kurrikula efektive</b>        | Ajo që nxënësit në të vërtetë e mësojnë në aspektin e dijes, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave.   | <b>Kurrikula e realizuar</b>   |
| <b>Kurrikula formale</b>         | Mundësitë dhe përvojat mësimore që iu ofrohen nxënësve në kontekstin e arsimit formal. Kurrikula formale shërben si bazë për certifikata dhe dhënien e diplomave të pranueshme nga shoqëria.   | <b>Kurrikula e paraparë/zyrtare/e obliguar</b>   |
| <b>Kurrikula e fshehur</b>       | Besimet, qëndrimet dhe shkathtësitë që nxënësit i kanë apo i zhvillojnë përmes përvojave të tyre personale. Kurrikula e fshehur mund të jetë ose të mos jetë në pajtueshmëri me kurrikulën zyrtare/të obligueshëm.   |  |
| <b>Kurrikula me zgjedhje</b>     | Fusha mësimore/lëndët të cilat nxënësit mund t'i zgjedhin në pajtueshmëri me interesat, talentet dhe nevojat e tyre. Pjesa zgjedhore e kurrikulës që përfaqëson lëndet dhe aktivitetet kurrikulare të vendosura në nivelin e shkollës.   | <b>Kurrikula me bazë shkolle</b>   |


# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

|  |   |                                      |
|--|---|--------------------------------------|
| <b>Lënda</b>   | Degë e dijes e organizuar në mënyrë të qëllimshme, si një disiplinë e veçantë e të nxënësve që mësohet në një ose disa nivele arsimore dhe krijon kushte për ndërtimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyçe nga nxënësit   |                                      |
| <b>Lëndë bartëse</b>                                 | Një lëndë që duke u bazuar në fushëveprimin dhe strukturën e saj është më afër të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të caktuara të mësimin dhe mundëson zhvillimin e kompetencave të caktuara tek nxënësit.   |                                      |
| <b>Llogaridhënia</b>                                 | Koncepti i qeverisjes etike (duke përfshirë qeverisjen etike të shkollës) që bazohet në njohjen dhe marrjen e përgjegjësisë për vendimet, veprimet dhe pasojat e tyre dhe ndërlidhet me pritjet për dhënien e llogarisë para palëve me interes.   |                                      |
| <b>Metodologjia e vlerësimit</b>                     | Strategjitë dhe aktivitetet e zbatuara, zakonisht nga mësimdhënësit (në vlerësimin e brendshëm) apo nga agjenci të specializuara (në vlerësimin e jashtëm), për të matur arritshmërinë ose performancën e nxënësit.   |                                      |
| <b>Mësimdhënia</b>                                   | Proces i planifikimit, i organizimit dhe i udhëheqjes së situatave të të nxënësve (formale ose joformale) nga mësuesi duke përdorur një gamë të gjerë metodash që ju përshtaten stileve të nxënësve të nxënësve.  |                                      |
| <b>Mësimdhënia në bllok</b>                          | Mënyrë fleksibile për caktimin e orëve të mësimin duke përcaktuar periudha më kompakte të kohës për lëndët/njësitë mësimore.  |                                      |
| <b>Mësimdhënia e diferencuar</b>                     | Mësimdhënia e diferencuar nënkupton krijimin e programeve dhe materiale të shumëfishta ashtu që nxënësit me aftësi, interesa apo nevojat të ndryshme mësimore të përjetojnë në mënyrë të barabartë rrugët e duhura për të absorbuar, përdorur, zhvilluar dhe prezantuar konceptet si pjesë e procesit mësimor të përditshëm. Lu mundëson nxënësve të marrin përgjegjësi më të madhe dhe pronësi mbi mësimin e tyre dhe ofron mundësi për mësimdhënien përmes shokut dhe nxënien në bashkëpunim. |                                      |
| <b>Mësimi elektronik</b>                             | Mësimi që bazohet në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit me qëllim të avancimit të qasjes në informata, e po ashtu edhe përdorimi efektiv dhe i përgjegjshëm i tyre në kontekstin (e zakonshëm) të aktiviteteve në distancë dhe rrjet.   |                                      |
| <b>Mësimdhënia e zgjeruar dhe koha për të mësuar</b> | Ndarja e një kohe më të madhe për mësimdhënie dhe mësimnxënie të fituar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të caktuara me qëllim që të nxitet mësimi i thellë dhe i qëndrueshëm.  |                                      |
| <b>Mësimi holistik dhe i gjithanshëm</b>             | Mësimi që integron aspektet akademike me zhvillimin e nxënësve duke u përpjekur të trajtojë fenomenet si tërësi duke theksuar ndërlidhjen e dimensioneve dhe proceseve natyrore, shoqërore dhe personale.   | Shiko po ashtu "Mësimin e integruar" |
| <b>Mësimnxënia</b>                                   | Procesi i fitimit, absorbimit dhe zhvillimit të dijeve, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të reja janë të integruar në strukturat para-ekzistuese, ndërsa gjithashtu përbëjnë një bazë për përvetësime të reja.  |                                      |

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



|   |  |   |
|---|--|---|
| <b>Mësimdhënia e integruar dhe të mësuarit</b>    | Mësimi që reflekton dhe vë në pah lidhjet dhe ndërlidhjet në jetën individuale dhe shoqërore (aktivitetet njerëzore), natyrë dhe dije.   | Mësimi holistik dhe i gjithanshëm         |
| <b>Mësimdhënia dhe mësimnxënia bashkëvepruese</b> | Filozofia dhe praktika e përfshirjes së nxënësve për ta përcaktuar dhe ndërtuar përvojën e tyre mësimore duke marrë parasysh nevojat e tyre, interesat, dijen paraprake dhe kontekstin.  |   |
| <b>Mësimi i bazuar në shërbim</b>                 | Mësim që ndodh si rezultat i angazhimit të nxënësit në ofrimin e ndonjë shërbimi të organizuar, zakonisht në bashkësi lokale apo më gjerë.   | Mësim i bazuar në shërbime për bashkësinë |
| <b>Mësimi domethënës</b>                          | Për dallim nga mësimi përmendësh, shpie drejt zhvillimit të rjetave konceptuale (d.m.th. hartave konceptuale) që mund të aplikohen në situata të ndryshme dhe që mundësojnë kreativitetin dhe zgjidhjen e problemeve. Në lidhje me pikëpamjet konstruktiviste, po ashtu i referohet mësimit që ka kuptim për nxënësit (d.m.th. është i ndërlidhur me përvojat e tyre personale dhe është i orientuar në praktikë dhe punë konkrete). |   |
| <b>Mësimi tërëjetësor</b>                         | Pajisja e nxënësve me kompetencat e nevojshme për të qenë nxënës të suksesshëm gjatë tërë jetës.   |   |
| <b>Mësimi i qëndrueshëm</b>                       | Mësimi i ndërlidhur dhe në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë, ekonomisë dhe mjedisit.  |   |
| <b>Mësimdhënia</b>                                | Aktivitetet që realizohet me qëllim të nxitjes së mësimit tek nxënësit duke përdorur një gamë të gjerë metodash që iu përshtaten stileve të mësimit të nxënësve.   |   |
| <b>Mësimdhënia shoku-shokun</b>                   | Praktika në të cilën nxënësit marrin rolin e mësimdhënësit në një mjedis shkollor me qëllim të ndarjes së dijes dhe shkathtësive të tyre me nxënësit tjerë.  |   |
| <b>Mjedisi për mësimin holistik</b>               | Organizimi i mësimit që fton nxënësit të bëjnë përdorimin e njëkohshëm të aftësive intelektuale, emocionale dhe motorike të tyre.  |   |
| <b>Mjedisi miqësor për fëmijët</b>                | Ambiente të të mësuarit të cilat janë miqësore, të bazuara në të drejta, gjithëpërfshirje dhe që janë të shëndetshme e mbrojtëse për të gjithë fëmijët.  |   |
| <b>Mundësitë për nxënie</b>                       | Situata dhe procese që sigurojnë kushtet dhe mjedisin për nxitjen e të mësuarit tek nxënësit.  |   |
| <b>Ndarja e kohës</b>                             | Koha e caktuar për mësimdhënie dhe nxënie e një lënde të veçantë apo fushe mësimore gjatë një viti dhe jave shkollore, kohën për realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare.  |   |
| <b>Nxënës në qendër</b>                           | Filozofia dhe praktika e organizimit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit nga perspektiva e nevojave, interesave dhe aftësive të nxënësve.   |   |
| <b>Përmbajtja mësimore</b>                        | Tërësia e dijeve, informacionit, fakteve, situatave, veprimtarive etj., të grupuara në një lëndë ose fushë të nxënësit, që shërbejnë si bazë për formimin dhe zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave.   | Përmbajtja                                |



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

|   |  |   |
|---|--|---|
| <b>Përvoja mësimore</b>                                     | Situatat dhe proceset përmes të cilave nxënësit i fitojnë/zhvillojnë dijet, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.  |   |
| <b>Programi mësimor</b>                                     | Dokument që përshkruan rezultatet dhe përmbajtjet mësimore, metodologjinë përkatëse për mësimdhënie dhe vlerësim, për një lëndë të veçantë.  | Programi i mëimit në/<br>për një lëndë të caktuar |
| <b>Progresioni i mëimit të qëndrueshëm</b>                  | Mësimi që bazohet në integrimin efektiv të mëtimeve të mëparshme në sistemet e reja të dijes, shkathtësive dhe qëndrimeve.   |   |
| <b>Qëndrimet</b>  | Pozicionimi i brendshëm drejt njerëzve, fakteve, fenomeneve, veprimeve, besimeve dhe situatave; gatishmëria e brendshme për të vepruar.  | Gatishmëria                                       |
| <b>Rezultatet mësimore</b>                                  | Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijnë të besojnë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit. Rezultatet janë shprehur në kornizën e kurrikulës në një varg domenesh, përfshirë dijen, të kuptuarit, shkathtësitë dhe kompetencat, vlerat dhe qëndrimet. | Rezultatet<br>Kompetencat<br>Arritjet             |
| <b>Sistemi i kurrikulës</b>                                 | Tërësia e dispozitave dhe dokumenteve të kurrikulës përmes të cilave u jipen udhëzime mësimdhënësve dhe palëve tjera për kurrikulën zyrtare dhe zbatimin e saj.  |   |
| <b>Standardi</b>  | Nivel i arritjes apo suksesit që pritet të arrihet prej nxënësve.  |   |
| <b>Struktura e kurrikulës</b>                               | Mënyra se si është organizuar kurrikula.   |   |
| <b>Shkallët kryesore të kurrikulës</b>                      | Janë nënivele formale të arsimit që ndërlidhen me fazat e zhvillimit të fëmijëve dhe organizimin e procesit të mësimdhënies, nxënies dhe vlerësimit.   |   |
| <b>Shkathtësia</b>  | Aftësia për ta zbatuar dijen për të kryer një detyrë të veçantë sipas një standardi të qëndrueshëm (dimensioni operacional/procedural i dijes).  |   |
| <b>Vlerat</b>   | Atribute që njerëzit i çmojnë si parime udhëzuese dhe referenca kryesore për qëndrimet dhe sjelljet e tyre.  |   |
| <b>Vetëvlerësimi</b>  | Vetëvlerësimi i nxënësit për arritjet dhe vështirësitë e tij në mësim. Është vlerësimi që bën nxënësi për progresin e tij bazuar në njohuritë e reja dhe kompetencat.  |   |
| <b>Vlerësimi</b>  | Procesi i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjykimeve për arritshmërinë ose performancën e nxënësve.   |   |
| <b>Vlerësimi me bazë klase/ Vlerësimi nga mësimdhënësit</b> | Vlerësimi që kryhet rregullisht nga mësimdhënësit në klasë si pjesë e aktiviteteve dhe strategjive të tyre të mëimit. Ofron informacion të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm sa i përket arritshmërisë së nxënësve dhe vështirësive në mësim.  |   |
| <b>Vlerësimi diagnostikues</b>                              | Vlerësim që identifikon nivelet e arritjeve të nxënësve, për të orientuar mësimin drejt plotësimit nevojave të tyre për nxënie.  |   |



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

|                                |   |                        |
|--------------------------------|---|------------------------|
| <b>Vlerësimi formativ</b>      | Vlerësim që parimisht është i bazuar në klasë dhe realizohet nga mësuesi me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të përparojnë në mësim gjatë tërë një periudhe të caktuar kohore. E parashihet mësimin si proces e jo vetëm si rezultat (shiko po ashtu vlerësimin për nxënie), me të cilin është i ndërlidhur. |                        |
| <b>Vlerësimi i jashtëm</b>     | Vlerësim që kryhet nga agjenci të specializuara për vlerësim apo bazohet në procedurat dhe instrumentet e ofruara nga ato.  |                        |
| <b>Vlerësimi i nxënies</b>     | Mbledhja e dëshmive valide, të besueshme dhe krahasueshme për të vlerësuar progresin e nxënësve në nxënie (d.m.th. arritshmërinë e tyre në fusha të ndryshme të kurrikulës /lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave kryesore).  | Vlerësimi përfundimtar |
| <b>Vlerësimi për të nxënë</b>  | Vlerësim i kryer gjatë gjithë procesit mësimor me qëllim nxitjen e procesit të të nxënë. Ky vlerësim formues e sheh të nxënë si proces e jo vetëm si rezultat.  | Vlerësimi formativ     |
| <b>Vlerësimi selektiv</b>      | Vlerësim që ka për qëllim grupimin e nxënësve në pajtim me kritere të caktuara të suksesit (p.sh. përzgjedhjen e nxënësve të talentuar për orët e shkencës ose arteve; përzgjedhjen e nxënësve që do të pranohen në shkolla të ndryshme të arsimit të mesëm të lartë).  |                        |
| <b>Vlerësimi sumativ</b>       | Vlerësimi që përmbledh përparimin dhe arritshmërinë e rezultateve mësimore nga/të nxënësit në një kohë të caktuar.  |                        |
| <b>Vlerësimi shoku-shokun</b>  | Vlerësimi i nxënësve për punën e nxënësve të tjerë (mund të jetë edhe formativ edhe sumativ).   |                        |
| <b>Vlerësimi parashikues</b>   | Vlerësimi që synon të parashikojë sukseset dhe vështirësitë potenciale në zhvillimin e nxënësve me qëllim që të sugjerohen programe efektive për përparimin e tyre e poashtu edhe veprime të duhura plotësuese në rast të mangësive (të pritura) në mësim.  |                        |
| <b>Zhvillimi i qëndrueshëm</b> | Zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.   |                        |

### Bibliografia

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Prishtinë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2011). *Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2007). *Strategjia e Arsimit Parauniversitar e Kosovës 2007 - 2017* Prishtinë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2010). *Plani strategjik për arsimin e Kosovës 2011 - 2016* Prishtinë.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Botimi për edukatorët parashkollorë në institucionet parashkollorë, grupmosha 0-3 vjeç dhe 3-5 vjeç.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Botimi për edukatorët parafillore në institucionet parashkollorë dhe në shkollë; grupmosha 5-6 vjeç; klasa parafillore, shkalla 1 e Kurrikulës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Udhëzues për mësimdhënësit □ Shkolla fillore, mosha 6-10 vjeç, klasat 1 – 5, shkallët 1 dhe 2 të Kurrikulës, niveli 1 sipas SNKA.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Botimi për mësimdhënëses/e. Arsimi i mesëm i ulët, mosha 11- 14 vjeç, klasat 6-9, shkallët 3 dhe 4 të Kurrikulës, niveli 2 sipas SNKA.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Botimi për mësimdhënëses/e. Shkolla e mesme e lartë Gjimnazet / Shkollat profesionale, mosha 15-17 vjeç, klasat 10-12, shkallët 5 dhe 6 të Kurrikulës, niveli 3 sipas SNKA.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Udhëzues për drejtorët e institucioneve parashkollorë. Mosha parashkollorë 0-5 vjeç.


Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Udhëzues për drejtorët e shkollave, Edukimi para-fi llor, mosha 5-6 vjeç, shkalla 1 e Kurrikulës. Arsimi fillor, mosha 6-10 vjeç, klasat 1-5, shkallët 1 dhe 2 të Kurrikulës, niveli 1 sipas SNKA. Arsimi i mesëm i ulët, mosha 11-14 vjeç, klasat 6-9, shkallët 3 dhe 4 të Kurrikulës, niveli 2 sipas SNKA.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Udhëzues për drejtorët e shkollave. Shkolla e mesme e lartë Gjimnazet / Shkollat profesionale, mosha 15-17 vjeç, klasat 10-12, shkallët 5 dhe 6 të Kurrikulës, niveli 3 sipas SNKA.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për Kurrikulën Zgjedhore*. Prishtinë

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESEM TË ULËT TË KOSOVËS



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzues për mentorim të mësimdhënësve nga drejtorët e shkollave*. Prishtinë

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2003). *Plani dhe Programi Mësimor 1*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2004). *Plani dhe Programi Mësimor 2*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2005). *Plani dhe Programi Mësimor 3*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2005). *Plani dhe Programi Mësimor 4*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2005). *Plani dhe Programi Mësimor 5*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2003). *Plani dhe Programi Mësimor 6*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2004). *Plani dhe Programi Mësimor 7*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2005). *Plani dhe Programi Mësimor 8*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2002). *Plani dhe Programi Mësimor 9*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2005). *Plani dhe Programi Mësimor 9*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2003). *Plani dhe Programi Mësimor 10*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2004). *Plani dhe Programi Mësimor 11*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2005). *Plani dhe Programi Mësimor 12*.  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2005). *Plani dhe Programi Mësimor 13*.

UDHËZIMET ADMINISTRATIVE  
KURRIKULAT E SHQIPËRISË  
KURRIKULAT E KOSOVËS  
KURRIKULA E FINLANDËS  
KURRIKULA E BRITANISË SË MADHE

Sternberg, R. & Subotnik, R., eds. (2006). *Optimizing Student Success with the Other Three Rs: Reasoning, Resilience, and Responsibility*. Greenëich, CT: Information Age Publishing.

Wagner, T., Kegan, R., Lahey, L., Lemons, R., Garnier, J., Helsing, D., Howell, A., Rasmussen, H. (2006). *Change Leadership: A Practical Guide to Transforming Our Schools*. San Francisco: Jossey Bass.

Perkins, D. "Integrating Thinking and Learning Skills across the Curriculum." In Jacobs, H. (1989). *Interdisciplinary Curriculum: Design and Implementation*.

Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development.

Tucker, M.S. & Coddling, J.B. (2002/1998).

Council of Europe official document, Daniel Coste (ed.), Marisa Cavalli, Alexandru CriĐan, Piet-Hein van de Ven, *A European Reference Document for Languages of Education?* Council of Europe, Language Policy Division, Strasbourg, 2007, 88 pp.

## Kontribuesit që morën pjesë në rishikimin e Kurrikulës Bërthamë

### Udhëheqës të procesit për rishikim:

Kabineti i Ministrit, MASHT

Departamenti për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, MASHT

Divizionit për Planprograme dhe Tekste Shkollore, MASHT

### Falënderojmë për kontributin dhe mbështetjen gjatë këtij procesi:

Zyrtarët e MASHT

Hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës

Profesorët universitarë

Ekspertët nga Projekti i Binjakëzimit

Ekspertët nga GIZ CDBE

Ekspertët vendorë

### Falënderim i veçantë

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë falënderon të gjithë udhëheqësit e procesit dhe kontribuesit tjerë, vendorë e ndërkombëtarë, të cilët hartuan Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2011. Puna e tyre e rëndësishme shërbeu si bazë për rishikim e Kornizës Kurrikulare dhe përgatitjen e Kurrikulave Bërthamë, të cilat u pilotuan në 95 shkolla të Kosovës. Rishikimi dhe finalizimi i dokumenteve kurrikulare nuk do të ishte i mundur pa kontributin e tyre të çmueshëm.*

# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

## Lista e kontaktit

Lista e mëposhtme e kontaktit është paraqitur me qëllim që të jemi më afër përdoruesve të këtij materiali dhe të ofrojmë sqarime plotësuese e përgjigje në pyetjet eventuale, për dokumentin në tërësi apo për fusha të caktuara të kurrikulës.

| Nr. 1 | Emri dhe mbiemri           | Pozita  | Fusha                                | Email adresa   |
|-------|----------------------------|---|--------------------------------------|--|
| 1     | Agim Bërdyna               | Zv. Ministër, MASHT   | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:agim.berdyna@rks-gov.net">agim.berdyna@rks-gov.net</a>   |
| 2     | Alush Istogu               | U.d. Sekretar i përgjithshëm i MASHT                                  | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:alush.istogu@rks-gov.net">alush.istogu@rks-gov.net</a>   |
| 3     | Osman Buleshkaj            | Këshilltar i jashtëm për Kurrikula                                    | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:obuleshkaj@gmail.com">obuleshkaj@gmail.com</a>   |
| 4     | Mustafë Kadriu             | U.d. Drejtor i Departamentit për zhvillimin e arsimit parauniversitar | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:mustaf.kadriu@rks-gov.net">mustaf.kadriu@rks-gov.net</a>   |
| 5     | Shqipe Gashi               | Koordinatore – KSNA 1   | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:shqipe.z.gashi@rks-gov.net">shqipe.z.gashi@rks-gov.net</a>   |
| 6     | Labëri Luzha               | Zv. Koordinatore – KSNA 1   | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:laberi.luzha@rks-gov.net">laberi.luzha@rks-gov.net</a>   |
| 7     | Ismet Potera               | Koordinator – KSNA 2  | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:ismet.poter@rks-gov.net">ismet.poter@rks-gov.net</a>   |
| 8     | Shejnaze Elezi             | Zv. Koordinatore – KSNA 2   | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:shejnaze.elezi@rks-gov.net">shejnaze.elezi@rks-gov.net</a>   |
| 9     | Selim Mehmeti              | Koordinator – KSNA 3  | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:selim.mehmeti@rks-gov.net">selim.mehmeti@rks-gov.net</a><br><a href="mailto:selimmehmeti@hotmail.com">selimmehmeti@hotmail.com</a> |
| 10    | Radica Berishaj            | Zv. Koordinatore – KSNA 3   | Aspektet e përgjithshme të KK        | <a href="mailto:radica.berishaj@rks-gov.net">radica.berishaj@rks-gov.net</a>   |
| 11    | Feime Llapashtica-Lipscomb | Koordinatore  | Gjuhët dhe komunikimi                | <a href="mailto:feime.llapashtica@rks-gov.net">feime.llapashtica@rks-gov.net</a>   |
| 12    | Nizafete Kutllovci-Bardhi  | Zv. Koordinatore  | Gjuhët dhe komunikimi                | <a href="mailto:nizafete.bardhi@rks-gov.net">nizafete.bardhi@rks-gov.net</a>   |
| 13    | Besa Luzha                 | Koordinatore  | Artet                                | <a href="mailto:besa.luzha@gmail.com">besa.luzha@gmail.com</a>   |
| 14    | Haki Xhakli                | Zv. Koordinator   | Artet                                | <a href="mailto:hakixhakli@gmail.com">hakixhakli@gmail.com</a>   |
| 15    | Mustafë Kadriu             | Koordinator   | Matematika                           | <a href="mailto:mustaf.kadriu@rks-gov.net">mustaf.kadriu@rks-gov.net</a>   |
| 16    | Fatmir Elezi               | Zv. Koordinator   | Matematika                           | <a href="mailto:fatmir.elezi@rks-gov.net">fatmir.elezi@rks-gov.net</a>   |
| 17    | Rexhep Kastrati            | Koordinator   | Shkencat natyrore                    | <a href="mailto:rexhep.kastrati@rks-gov.net">rexhep.kastrati@rks-gov.net</a>   |
| 18    | Mirinda Dehari-Zeka        | Zv. Koordinatore  | Shkencat natyrore                    | <a href="mailto:mirlinda.zeka@rks-gov.net">mirlinda.zeka@rks-gov.net</a>   |
| 19    | Igballe Cakaj              | Anëtare   | Shkencat natyrore                    |  |
| 20    | Arbër Salihu               | Koordinator   | Shoqëria dhe mjedisi                 | <a href="mailto:arber.salihu@rks-gov.net">arber.salihu@rks-gov.net</a>   |
| 21    | Besa Halimi-Zagragja       | Zv. Koordinatore  | Shoqëria dhe mjedisi                 | <a href="mailto:besa.h.zagragja@rks-gov.net">besa.h.zagragja@rks-gov.net</a>   |
| 22    | Lulavere Kadriu-Behlui     | Koordinatore  | Edukata fizike, sportet dhe shëndeti | <a href="mailto:lulavere.behlui@rks-gov.net">lulavere.behlui@rks-gov.net</a>   |
| 23    | Leonora Shala              | Zv. koordinatore  | Edukata fizike, sportet dhe shëndeti | <a href="mailto:leonora.shala@rks-gov.net">leonora.shala@rks-gov.net</a>   |
| 24    | Agim Bytyqi                | Koordinator   | Jeta dhe puna                        | <a href="mailto:agim.a.bytyqi@rks-gov.net">agim.a.bytyqi@rks-gov.net</a><br><a href="mailto:agimbytyqigov@gmail.com">agimbytyqigov@gmail.com</a>   |
| 25    | Ryve Prekorogja            | Zv. Koordinatore  | Jeta dhe puna                        | <a href="mailto:ryve.prekorogja@rs-gov.net">ryve.prekorogja@rs-gov.net</a>   |
| 26    | Shyhrete Reçica            | Koordinatore  | Kurrikula me zgjedhje                | <a href="mailto:shyhrete.reqica@rks-gov.net">shyhrete.reqica@rks-gov.net</a>   |
| 27    | Lirije Gosalci             | Zv. Koordinatore  | Kurrikula me zgjedhje                | <a href="mailto:lirije.gosalci@rks-gov.net">lirije.gosalci@rks-gov.net</a>   |



# KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

373.3.016(496.51)

373.5.016(496.51)

Kurrikula e Kosovës ; kurrikula bërthamë e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës : (klasa VI, VII, VIII dhe IX) / Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë. - (E rishikuar). – Prishtinë : MASHT, 2016. – 123 f. : ilustr. ; 28 cm.

Fjalorth i termave për mësimdhënës : 112-120. - Bibliografia : f. 121-122

**ISBN 978-9951-16-106-0**